



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 50

Tiranë – E mërkurë, 12 mars 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 13/2025, datë 27.2.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 5.2.2025, të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, ‘Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit’”, i ndryshuar.....
Dekret i Presidentit nr. 97, datë 10.3.2025	Për shpallje ligji.....
Ligj nr. 14/2025, datë 27.2.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 5.2.2025, të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë’”, i ndryshuar.....
Dekret i Presidentit nr. 98, datë 10.3.2025	Për shpallje ligji.....
Dekret i Presidentit nr. 88, datë 6.3.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare
Dekret i Presidentit nr. 89, datë 6.3.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare
Dekret i Presidentit nr. 96, datë 7.3.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 6.3.2025	Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe planit të veprimit 2025–2030.....
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 13, datë 7.3.2025	Për disa ndryshime dhe një shtesë në udhëzimin nr. 16, datë 8.7.2019, “Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”.....

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 204, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës.....	5683
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 205, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë..	5686
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 206, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	5687
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 207, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Moldavisë.....	5688
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 208, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar.....	5690
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 209, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë..	5691
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 210, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë.....	5692
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 211, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	5692
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 212, datë 4.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	5693
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 223, datë 6.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	5694
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 224, datë 6.3.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	5695
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Ministrinë e Drejtësisë.....	5696
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Ministrinë e Drejtësisë.....	5696

	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Ministrinë e Drejtësisë.....	5697
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Ministrinë e Drejtësisë.....	5698
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.....	5698
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 17.1.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 520, datë 30.12.2023 dhe nr. 521, datë 27.12.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-667 (94), datë 9.4.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5699
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 10.2.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025.....	5729
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 14.2.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “EB Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	5731
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 14.2.2025	Mbi dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	5733
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 14.2.2025	Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024, “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë”.....	5734
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 113/9, datë 6.3.2025	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, shëtitëtorja Drilon–Tushemisht”	5735
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Mulla.....	5739

**LIGJ**
Nr. 13/2025

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË
5.2.2025, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË
LIGJIN NR. 8668, DATË 23.10.2000, ‘PËR
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË
ME PASAPORTË PËR JASHTË
SHTETIT’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 5.2.2025, të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, ‘Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit’”, i ndryshuar.

Miraturar në datën 27.2.2025.

Shpallur me dekretin nr. 97, datë 10.3.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 97, datë 10.3.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 13/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 5.2.2025, të Këshillit të Ministrave, ‘Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, ‘Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 14/2025

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË
5.2.2025, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË
LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, ‘PËR
LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË
SHTETASVE SHQIPTARË’”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 5.2.2025, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë’”, i ndryshuar.

Miraturar në datën 27.2.2025.

Shpallur me dekretin nr. 98, datë 10.3.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 98, datë 10.3.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 14/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 5.2.2025 të Këshillit të Ministrave, ‘Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 88, datë 6.3.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Driton Nasuf Xhoxhaj
2. Engyl Remzi Pallush

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 89, datë 6.3.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ardit Ramazan Nuredini
2. Ayşen Fahri Aksoy (Vardar)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 96, datë 7.3.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Besar Besnik Guxhufi
2. Etnik Besnik Brruti
3. Erion Mehmet Aliji
4. Gent Kamer Elezaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM**Nr. 144, datë 6.3.2025****PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË
POLITIKAVE PËR SIGURINË DHE
SHËNDETIN NË PUNË DHE PLANIT
TË VEPRIMIT 2025–2030**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin

në punë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe planit të veprimit 2025–2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 371, datë 18.5.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016–2020, dhe planit të veprimit të zbatimit të tij”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, të përmendura në dokumentin e politikave dhe planin e veprimit, për ndjekjen dhe zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Dokumenti i Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe plani i veprimit 2025–2030

KAPITULLI 1 POLITIKAT E SIGURISË DHE SHËNDETTIT NË PUNË

Zhvillimi ekonomik, social dhe i tregut të punës

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt aderimit në Bashkimin Evropian ka nisur më 24 korrik 2014, kur dhe mori zyrtarisht statusin e vendit kandidat. Çdo vit, Komisioni Evropian nxjerr raporte progresi duke bërë kështu një vlerësim gjithëpërfshirës të përparimeve të Shqipërisë. Në mars të vitit 2020, Këshilli i BE-së vendosi nisjen e negociatave të anëtarësimit, proces ky që pati dhe momentin kulmor, atë të mbajtjes së konferencës së parë përruruese në korrik 2022.

Fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP) është një pjesë kryesore përbërëse e legjislacionit

shqiptar të punës, i cili, në përgjithësi, është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare të punës (SNP-të) dhe legjislacionin e BE-së. Pas hyrjes në fuqi më 2010-n, ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i është nënshtruar një sërë përshtatjesh për t’u harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian (BE-së) dhe për të përmbushur SNP-të. Raport progresi i Komisionit të BE-së për vitet 2020 dhe 2021 e vlerëson pozitivisht progresin e Shqipërisë në kuadrin ligjor, duke evidentuar miratimin e legjislacionit që transponon Direktivën Kuadër të BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë. Raport progresi i BE-së, për vitet 2022 dhe 2023, thekson nevojën për forcimin e kapacitetit institucional për zbatimin efikas, në përputhje me legjislacionin e SSHP-së.

Ndërsa Shqipëria nis negociatat me BE-në, po zhvillohet procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit, duke përfshirë këtu kapitullin 19, i cili përqendrohet në politikat sociale dhe punësimin.

Tendencat ekonomike

Ekonomia e Shqipërisë ka treguar rritje të qëndrueshme përgjatë viteve, pavarësisht tkurrjes prej 3.31% më 2020-n si pasojë e goditjes nga tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemisë së COVID-it më 2020-n. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë u rrit me shpejtësi për të arritur nivelin e 7,629 euro më 2023, një rritje domethënëse nga niveli prej 4,677 euro më 2020.¹ Megjithatë, niveli i ashtuquajtur “në rrezik varfërie” në Shqipëri, në vitin 2022, arriti tek 20.6% duke pësuar një rënie prej 1.4 pikë për qind nga një vit më parë, duke mbetur më i lartë se mesatarja e BE-së prej 16.5%.²

Në vitin 2023, ekonomia shqiptare, krahasuar me vitin 2022, shënoi rritje në terma nominalë 10.24% dhe në terma realë (në volum) prej 3.94%. Në vitin 2022, rritja e PBB-së në terma realë është 4.83%, krahasuar me vitin 2021.

Për sa i përket strukturës së PBB-së, sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2023 vazhdojnë ta zënë shërbimet, gjithsej, me 47.96%, duke shënuar një rritje në terma realë me 8.26%. Industria dhe Ndërtimi përbëjnë 23.03% të PBB-së, të cilat u rritën në terma realë përkatësisht: industria me -2.37% dhe ndërtimi me 8.48%. Bujqësia, gjuetia,

¹ Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2025–2027, i rishikuar (VKM-ja nr. 399, datë 19.6.2024).

²<https://www.instat.gov.al/media/13063/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-silc2022.pdf>



pyjet dhe peshkimi përbëjnë 16.22% të PBB-së dhe kanë shënuar një rënie prej -1.82% në terma realë.³

Tendencat demografike

Shqipëria po përballet me sfida demografike të karakterizuara nga tkurje dhe moshim i popullatës, e shoqëruar me emigrim të vazhdueshëm, duke sjellë kështu pasoja të konsiderueshme në dinamikën e tregut të punës. Që prej nisjes së pandemisë, Shqipëria ka njohur një rënie mesatare vjetore të popullatës, dhe shenjat tregojnë se kjo tendencë do të vazhdojë të jetë e tillë edhe në të ardhmen.⁴

Mosha mediane arriti në 38.8 vjeç më 2023-shin nga 35.2 më 2016-n, duke theksuar një trajektore moshe drejt plakjes. Një tendencë e dukshme plakjeje vërehet në piramidat e popullsisë nga viti 2011 deri në vitin 2023. Shqipëria gjatë kësaj periudhe është karakterizuar nga norma të ulëta të lindshmërisë dhe trendi në rënie, kombinuar me emigracionin e popullsisë në moshë riprodhuese solli ngushtimin e bazës së piramidës së popullsisë. Lindshmëria nën nivelin e zëvendësimit prej vitit 2001, rritja e jetëgjatësisë, si dhe migracioni mbeten faktorët kryesorë të plakjes së popullsisë. Të dhënat e CENS 2023 tregojnë se një në pesë individë (19.7%) janë 65 vjeç e lart, krahasuar me një në nëntë individë (11.3%) në CENSIN e vitit 2011 dhe 7.5% në CENSIN e 2001.⁵

Punësimi

Për sa i përket punësimit, viti 2023 shënjoj ndryshime të rëndësishme dhe dinamike të forcës së punës, të lidhura me transformimet demografike dhe sektoriale. Me një hov të qartë, forca totale e punës u rrit në rreth 1.33 milionë njerëz ose 67.2% për qind të popullatës, duke shënjuar kështu një rritje të konsiderueshme të shifrave të regjistruara më 2016-n me rreth 1.16 milionë njerëz apo 55.9% të popullatës me moshë 15–64 vjeç të punësuar në vitin 2016.⁶ Kjo rritje në punësim njohu pjesëmarrje në rritje të të dyja gjinive me një përbërje të forcës punëtore prej të cilave 53.9% burra dhe 46.1% gra, duke evidentuar kështu një hendek gjinor në punësim, prej 7.8 pikë përqindje. Ndërkohë, në vitin 2023 rezulton se 72.9% e meshkujve 15–64 vjeç janë të punësuar, 11.1% janë të papunë dhe 18.0% janë jashtë forcave të punës dhe 61.8% e femrave 15–64

vjeç janë të punësuar, 11.3% janë të papuna dhe 30.4% janë jashtë forcave të punës.

Duke u thelluar më tej në përbërjen e forcës punëtore, 67.2% e individëve me moshë 15–64 vjeç ishin aktivisht të angazhuar në punësim, duke shënuar kështu një rritje të qartë nga statistikat e 2016-s. Të dhënat tregojnë një rritje të qartë në masën që zënë punëmarrësit, me një përqindje prej 67.2% të forcës së punës më 2023-shin krahasuar me 41.2% më 2016-n, duke treguar kështu një ndryshim drejt strukturave më të formalizuara të punësimit.

Edhe në fushën profesionale u vunë re disa lëvizje të rëndësishme. Analiza e punësimit sipas grup-profesioneve shfaq strukturën e punësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Në vitin 2023, punonjësit e kualifikuar në bujqësi dhe në tregti, përbëjnë 43.6% të të punësuarve. Ndjekin grupet: “Menaxherë, profesionistë dhe teknikë” dhe “Nëpunës dhe punonjës të shitjeve dhe shërbimeve”, të cilët përbëjnë përkatësisht 21.4% dhe 19.7% të të punësuarve.

Duke e analizuar tregun e punës në këndvështrimin gjinor, në vitin 2023, vihet re se femrat kanë 1.4 herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes. Vlerësimet e marra nga AFP-ja tregojnë se 27.2% e femrave të punësuar dhe 16.3% e meshkujve të punësuar janë punëtorë pa pagesë të familjes.

Në vitin 2023, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 70.539 lekë. Kjo pagë është llogaritur me të dhënat e listë-pagesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi dhe mbulon të gjithë sektorët e ekonomisë dhe kontribuesit, shtetas shqiptarë e të huaj, për të cilët ndërmarrja deklaron pagë mujore bruto. Krahasuar me vitin 2016, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit nga 45.845 lekë në 70.539 lekë, ose me 53.8%. Hendeku gjinor në paga është 6.2%. Pra meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 6.2% më të lartë sesa femrat. Krahasuar me vitin 2016, ku hendeku gjinor në paga ka qenë 6%, rezulton se nuk ka ndryshim të konsiderueshëm.⁷

³ <https://www.instat.gov.al/media/14053/prodhimi-i-bre-ndshem-bruto-2022-final-dhe-2023-gjysm%C3%ABfinal.pdf>.

⁴ IMF raporti vendor, nr. 22/362.

⁵ <https://www.instat.gov.al/media/13787/cens-2023.pdf>.

⁶ INSTAT, baza statistikore e të dhënave, tregu i punës, Anketa e Forcës së Punës 2016 dhe 2023.

⁷ <https://www.instat.gov.al/media/1695/labour-market-2016.pdf>



Gjatë vitit 2023, janë 31.1% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2023, paga minimale zyrtare është 40.000 lekë, ndërsa në vitin 2016 paga minimale zyrtare ka qenë 22.000 lekë, duke pësuar një rritje prej 81.8%.

Për ta përmbledhur, panorama e punësimit të 2023-shit karakterizohet nga ndryshime dinamike në demografinë e forcës së punës, në strukturat e punës dhe dinamikat sektoriale, duke theksuar kështu natyrën shumëdimensionale të tregjeve bashkëkohore të punës dhe nevojën urgjente për politika dhe ndërhyrje përshtatëse.

Punësimi informal

Në Shqipëri, sektori informal vazhdon të jetë i madh, duke e kaluar mesataren e BE-së për sa u përket statistikave të punësimit. Brenda kësaj ekonomie informale, “pagat në dorë” luajnë një rol të rëndësishëm, duke zënë kështu një pjesë të konsiderueshme të punësimit informal. Kjo praktikë zbatohet duke raportuar një pagë më të ulët për të minimizuar detyrimet ndaj tatimeve dhe sigurimeve shoqërore, ndërsa pjesa e mbetur paguhet shpesh nën dorë e në dorë, duke reflektuar praktikën e punës së padeklaruar.⁸

Sipas vlerësimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, një shifër prej 56.7% e totalit të punësimit në vitin 2019 gjendej nën ombrellën e punësimit informal. Në këtë forcë pune informale mbizotërojnë punëtorët e vetëpunësuar me një shifër prej 51%, ku gratë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme, duke përfaqësuar kështu 49% të punëmarrësve pa pagesë në biznesin e familjes. Sektorët të cilët janë veçanërisht vulnerabël ndaj informalitetit janë bujqësia, tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimi, ku dhe nivelet e punësimit informal njohin përqindje të larta, si mbi 84%.⁹

Ndërsa INSTAT-i, për vitin 2023, raportoi se shkalla e punësimit informal në sektorin jobujqësor ishte 26.2%, shifër kjo 5.7 pikë përqindje më e ulët se 31.9% më 2016-n¹⁰.

Struktura e ndërmarrjeve

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve ofron një vëzhgim më në thellësi të përbërjes së ndërmarrjeve

në Shqipëri. Struktura e Ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrjet mikro me 1–9 të punësuar, që në vitin 2022 janë 106,132 ndërmarrje.¹¹

Për sa i përket vitit 2022, nga 113,460 ndërmarrje në total, 113,279 ndërmarrje i përkasin kategorisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) ose 99.8% e ndërmarrjeve aktive. Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), që sipas përkufizimit të së cilës punësojnë deri në 250 individë, kolektivisht zënë 82% të numrit total të të punësuarve.¹²

- Ndërmarrje mikro (1–9 të punësuar), janë 106,132 ndërmarrje dhe kanë 206,598 të punësuar;

- Ndërmarrjet e vogla (10–49 të punësuar), janë 5,842 ndërmarrje dhe kanë 115,007 të punësuar;

- Ndërmarrjet e mesme (50–249 të punësuar), janë 1,306 ndërmarrje dhe kanë 128,026 të punësuar.

- NVM-të (1–249 të punësuar), janë së bashku 113,279 ndërmarrje dhe kanë 449,631 të punësuar;

- Ndërmarrjet e mëdha (250+ të punësuar), janë 181 ndërmarrje dhe kanë 98,311 të punësuar.

Gjithsej, janë në total 113,460 ndërmarrje dhe kanë 547,942 të punësuar.

Brenda sektorit të NVM-ve, pjesa më dominuese përbëhet nga ndërmarrjet mikro me (1–9 të punësuar), të cilat së bashku punësojnë 128,026 persona. Kompanitë me mbi 50–249 punonjës përbëjnë 1.1% të totalit të ndërmarrjeve aktive dhe përbëjnë 23.3% të totalit të punësimit.¹³

Një vëzhgim më i detajuar tregon se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve me më pak se 50 punonjës përqendrohen në sektorë, si tregtia dhe akomodimi, dhe shërbimet ushqimore. Nga ana tjetër, industria përpunuese shfaqet si sektor dominues mes ndërmarrjeve me më shumë se 50 punonjës.

Sistemi institucional i sigurisë dhe shëndetit në punë

Kuadri Institucional i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) në Shqipëri është një sistem shumëdimensional, i cili përfshin organizma të ndryshëm qeveritarë, partnerë social dhe aktorë të tjerë të jashtëm. Në qendër të sistemit janë institucionet qendrore qeveritare, përfshirë këtu ministrinë dhe agjencitë, të cilat kanë për detyrë të mbikëqyrin rregulloret dhe politikat e SSHP-së. Në

⁸ IMF Raport vendor, nr. 22/362, faqe 67.

⁹ ILO. Vëzhgim i ekonomisë informale në Shqipëri, 2019.

¹⁰ Botim i INSTAT-it, tregu i punës, Anketa e Forcës së Punës, 2016 dhe 2023.

¹¹ Burimi: Të dhënat janë në NACE Rev 2, INSTAT.

¹² AL_Albania-Economic-Outlook-2023.pdf

¹³ <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2024/tregu-i-pun%C3%ABs-2023/>



vitin 2024, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) mori rolin kyç në çështjet e SSHP-së, duke zënë vendin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE-së) (2017 deri 2024) dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (para vitit 2017), të cilat janë marrë në periudhat respektive me çështjet e punës dhe të SSHP-së.

Transferimi i përgjegjësi nga MFE-ja tek MEKI e çon përpara zhvillimin dhe zbatimin e politikave të punësimit, duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe duke nxitur dialogun me partnerët socialë. Në këtë aspekt, Sektori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ngritur në prill të vitit 2023, e zhvillon veprimtarinë e tij brenda Drejtorisë së Marrëdhënieve të Punës, Sigurisë dhe Shëndetit.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka funksionuar në mënyrë autonome që prej vitit 2006, ngarkuar me kryerjen e detyrës kryesore të zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe SSHP-në. Me angazhimin e plotë për të garantuar zbatimin e legjislacionit të punës, ai përqendrohet në parandalimin e aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale dhe në promovimin e një mjedisi pune më të sigurt e të shëndetshëm. Qartësisht ky inspektorat ka një forcë pune të qëndrueshme e me përvojë të gjatë në fushën e SSHP-së, gjë e cila është plotësuar edhe më tej me ndihmën e nismave të vazhdueshme të trajnimit përmes projekteve të ndryshme me financime donatorësh.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) luan një rol kyç në hartimin e politikave, që lidhen me shëndetin në punë. Ajo drejton, organizon dhe bashkërendon punën, si dhe nëpërmjet strukturave të saj, kryen detyra kryesore në fushën e shëndetit të punëmarrësve dhe mjekësisë së punës, në përputhje me përcaktimet e nenit 39, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) (i cili funksionon në mënyrë autonome) inspekton zbatimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Aktualisht, ISHSH, i cili kontrollon zbatimin e legjislacionit të shëndetit në fuqi apo që vepron si institucion ligjzbatues, është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të MSHMS-së dhe është në reformim e sipër.

Instituti i Shëndetit Publik shërben si një qendër për çështjet që lidhen me shëndetin, përfshirë këtu shëndetin në punë.

Misioni i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), si qendra kombëtare në fushën e shëndetit publik, konsiston në zhvillimin dhe zbatimin e masave monitoruese dhe kontrolluese për sëmundjet, dëmtimet, paafësitë, dhe faktorët dëmtues shëndetësorë të mjedisit, si dhe në promovimin e shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me organizata /agjenci kombëtare e ndërkombëtare. Në mënyrë më të detajuar, misioni i ISHP-së, mes të tjerash, përfshin:

- Monitorimin e gjendjes shëndetësore të popullatës në mënyrë që të identifikohen në kohë dhe të zgjidhen shkencërisht problemet shëndetësore të hasura;

- Identifikimin dhe monitorimin e faktorëve përcaktues të rrezikut shëndetësor;

- Ndërmarrjen dhe rritjen e shkallës së informimit të popullatës, edukimit dhe ndërgjegjësimit të saj mbi problemet shëndetësore;

- Trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve të shëndetit publik dhe mbështetja profesionale ndaj tyre;

- Kërkimin shkencor për të ofruar zgjidhje novatore për problemet shëndetësore dhe për të zhvilluar politika shëndetësore.

ISHP-ja mirëmban dhe menaxhon një bazë të dhënash për monitorimin e faktorëve përcaktues të rrezikut shëndetësor në mjedisin e punës, së bashku me hartëzimin e tyre të mëtejshëm (programi GIS). Përmes Sektorit të Shëndetit në Punë, ISHP-ja monitoron gjendjen shëndetësore të punëmarrësve dhe mjediset e punës, dhe harton dhe zbaton programe kërkimore në fusha të shëndetit në punë. Të gjitha veprimtaritë e sipërpërmendura bazohen në analizat dhe punën e laboratorëve të Departamentit të Mjedisit dhe Shëndetit, i cili përfshin, gjithashtu, Laboratorin e Toksikologjisë Klinike.

Ndër të tjera, ligji nr. 10237/2010, përcakton përveç ministrive drejtpërdrejt përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, si ministria përgjegjëse për punën dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë edhe “Autoritete të tjera shtetërore përgjegjëse”, si: ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen, punët e brendshme, drejtësisë, energjetikën, punët publike, transportin, telekomunikacionin dhe Shërbimi Informativ Shtetëror, të cilat duhet të bashkërendojnë punën dhe të kontrollojnë



veprimtaritë e sigurisë dhe të shëndetit në punë, brenda veprimtarive dhe ndërmarrjeve, të cilat janë në juridiksionin e tyre, nëpërmjet strukturave dhe shërbimeve mbrojtëse dhe parandaluese që ato kanë për këto çështje.

Gjithashtu, hetimi administrativ, regjistrimi i aksidenteve në punë dhe i sëmundjeve profesionale, që ndodhin brenda veprimtarisë dhe ndërmarrjeve, të cilat janë në juridiksionin e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, kryhen nga strukturat dhe shërbimet e tyre. Këto autoritete të tjera shtetërore përgjegjëse, hartojnë rregulloret sipas fushës së veprimtarisë së tyre, për përcaktimin e procedurave dhe të strukturave për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këto entitete qeveritare, si dhe entitete të tjera, kontribuojnë në zbatimin e rregulloreve të SSHP-së dhe për nxitjen e kulturës parandaluese.

Universiteti i Mjekësisë formon (diplomon) mjekë të përgjithshëm, mjekë të specializuar të mjekësisë familjare, si dhe mjekë të specialiteteve të tjera. Universiteti i Mjekësisë funksionon sipas ligjit të arsimit të lartë.

Këshilli Kombëtar i Punës, ngritur më 2003-shin, shërben si një platformë trepalëshe e nivelit të lartë, që nxit dialogun mes përfaqësuesve të qeverisë, përfaqësuesve të organizatave punëmarrëse dhe punëdhënëse. Në strukturën e Këshillit Kombëtar të Punës, ngrihen gjashtë Komisione të Specializuara Trepalëshe të Përherëshme, ku njëri prej tyre është Komisioni për SSHP-në. Qëllimi i Komisionit për SSHP-në është që të shqyrtojë çështje që i përkasin fushave të veta të kompetencës dhe të transmetojë mendimet dhe përfundimet e konsultimeve të KKP-së, me qëllim orientimin dhe zbatimin e politikave shtetërore, hartimin e projektligjeve dhe projektpropozimeve të Këshillit të Ministrave dhe zgjidhjen/trajtimin e çështjeve që janë evidentuar për konsultim dhe opinion nga KKP-ja.

Partnerët socialë, me organizatat e tyre përfaqësuese në Këshillin Kombëtar të Punës, si “*Business Albania*”, një organizatë ombrellë për punëdhënësit/bizneset dhe dy konfederatat sindikale, si “Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë” (BSPSH) dhe “Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë” (KSSH), si organizata ombrellë për punëmarrësit, janë të angazhuara në mënyrë aktive në hartimin e politikave dhe marrin pjesë në nisma të financuara nga donatorë, duke

kontribuar kështu në formulimin dhe zbatimin e strategjisë për SSHP-në. Organizata të tjera, të cilat nuk janë pjesë e konfederatave të sipërpërmendura, japin, gjithashtu, kontributin e tyre në rolin që kanë si partnerë socialë, si anëtarë të Këshillit Kombëtar të Punës.

Inspektorati Qendror është institucioni i ngarkuar për përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjëshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë, i cili përcakton dhe miraton rregulla të përgjithshme, bazë, për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve. Në ushtrim të detyrave të tij për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së legjislacionit për inspektimin, Inspektorati Qendror bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore.

Aktorët e jashtëm, si: Organizata Ndërko-mbëtare e Punës (ONP/ILO), Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe agjenci të tjera të BE-së për SSHP-në luajnë një rol thelbësor në mbështetje të nismave SSHP përmes projekteve për asistencë teknike dhe shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave.

Organizatat e Shoqërisë Civile dhe nisma të tyre kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësisë dhe të përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve për SSHP-në. Roli i tyre në edukim, kërkim dhe mbështetje publike, e intensifikon panoramën e përgjithshme të SSHP-së, duke i pozicionuar ata si partnerë të rëndësishëm për formësimin e politikave dhe praktikave në të ardhmen.

Vështrim i përgjithshëm i situatës në Shqipëri për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Dokumenti i mëparshëm politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2016–2020 përmbante objektiva ambiciozë, megjithatë arritja e disa rezultateve u ndikua nga faktorë përtej kontrollit të sistemit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Pavarësisht se zbatimi i dokumentit politik pati ecuri domethënëse, disa rezultate nuk i përmbushën synimet e përcaktuara në atë kohë. Për të përpiluar këtë dokument politik u krye dhe një vlerësim tërësor për të nxjerrë në pah nivelin e realizimit të objektivave bazuar në fakte dhe për të dhënë rekomandime të qarta dhe racionale për zhvillimin SSHP-së për periudhën 2025–2030.



Referimi te Strategjia Kombëtare Shqiptare për Punësim dhe Aftësim 2023–2030, ku ministria e cila është përgjegjëse për punësimin dhe marrëdhëniet e punës angazhohet për hartimin e dokumentit politik ndërsektorial për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, Programin Vendor të Punës së Denjë 2023–2026, të nënshkruar nga partnerët socialë (BSPSH, KSSH, BA), MEKI dhe ONP/ILO, konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i zbatimit të dokumentit politik të mëparshëm për SSHP-në 2016–2020 dhe konsultimet vijuese me palët dhanë ndihmesën e tyre në formësimin e një dokumenti politik të mbështetur në parimet e përvijuara në Kuadrin e Strategjisë së BE-së për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2021–2027, Standardeve Ndërkombëtare të Punës dhe të Strategjisë Globale të ONP/ILO për Sigurinë e Shëndetin në Punë 2024–2030.

Kuadri Strategjik i BE-së për SSHP-në 2021–2027, shpallur në shtyllën evropiane të planit të veprimit për të drejtat sociale parashtrohet prioritetet dhe veprimet kryesore që nevojiten për përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë së punëmarrësve përgjatë viteve të ardhshme, duke marrë parasysh kontekstin post-pandemik, tranzicionin e gjelbër dhe digjital, sfidat ekonomike dhe demografike dhe nocionin e ndryshuar të mjedisit tradicional të vendit të punës. Kuadri strategjik për vitet e ardhshme përqendrohet në tri objektiva ndërsektoriale:

- parashikimin dhe menaxhimin e ndryshimit në botën e re të punës që vjen si rezultat i tranzicionit të gjelbër, digjital dhe demografik;

- përmirësimin e parandalimit të aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale;

- rritjen e gatishmërisë për çdo krizë të mundshme shëndetësore në të ardhmen.

Siç dhe thuhet në Kuadrin Strategjik të BE-së për SSHP-në, zbatimi i këtyre objektivave duhet të mbështetet tek: i. dialogu social; ii. forcimi i bazës së të dhënave; iii. forcimi i zbatueshmërisë; dhe iv. rritja e ndërgjegjësimit.

Rezoluta e ONP/ILOe miratuar në Konferencën e 110-të Ndërkombëtare të Punës e formalizoi të drejtën e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm, si një të drejtë themelore në Deklaratën e ONP/ILO për Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë 1998 dhe është e integruar në Strategjinë Globale të ONP/ILO për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024–2030. Për rrjedhojë, vendet në mbarë botën i kanë orientuar përpjekjet e

tyre drejt përmbushjes së këtij qëllimi, duke iu përmbajtur parimeve të parashtruara në dy Konventat Themelore përkatësisht Konventa nr. 155, për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Konventa nr. 187, lidhur me Kuadrin Promovues për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Si rezultat, përshtatja e institucioneve dhe politikave për sigurinë dhe shëndetin në punë me parimet e këtyre konventave mbetet një sfidë e së tashmes dhe së ardhmes për të gjitha vendet.

Për të realizuar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune si e drejtë themelore dhe për t'u bërë ballë sfidave të sotshme dhe të ardhshme nevojitet forcimi i institucioneve përgjegjëse për hartimin, ngritjen dhe zbatimin e kuadrit normativ. Ngritja e kuadrit normativ kombëtar, bërja prioritet e qasjes parandaluese dhe përdorimi i dialogut social si mekanizëm zbatues janë elemente themelore për t'i hapur rrugë promovimit të një mjedisi pune të sigurt e të shëndetshëm, duke reduktuar në këtë mënyrë numrin e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale.

Pavarësisht përpjekjeve të ndërmarra për të harmonizuar legjislacionin shqiptar me Direktivat e BE-së dhe SNP-të, vazhdojnë të ekzistojnë boshllëqe të dukshme, veçanërisht në transpozimin e konventave apo udhëzimeve “*soft law*” që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë. Nevoja e ngutshme për të finalizuar transpozimin e direktivave të BE-së, për të ratifikuar konventat më të rëndësishme të ONP/ILO dhe për të formuluar dokumentet plotësuese janë quajtur si objektiva kyç për periudhën 2025–2030.

Përmbushja e objektivave të dëshiruara kërkon ngritjen e një sistemi të gjerë monitorimi për të gjurmuar zbatimin e standardeve të SSHP-së në vendin e punës, përfshirë këtu një sistem informacioni për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale. Për më tepër, është i domosdoshëm të kryhet hetimi i kujdesshëm i shkaqeve të ngjarjeve të tilla. Këto përpjekje orientojnë veprimet e institucioneve kryesore dhe mundësojnë zbatimin e masave parandaluese në nivel mjedisi pune.

Trajtimi i çështjes së sëmundjeve profesionale përbën një tjetër sfidë të rëndësishme si pasojë e vështirësive për t'i zbuluar këto sëmundje në kohë, për shkak të periudhave të zgjatura të “gjendjes pasive/ latente” dhe mungesës së një ndërlidhjeje të qartë me historikun e punësimit të punëmarrësit në fjalë. Për këtë arsye, nevoja është urgjente për



sisteme të forta njohjeje dhe raportimi për sëmundjet profesionale. Duke evidentuar rëndësinë e situatës, anketa e organizuar bashkërisht nga OBSH-ja dhe ONP/ILO ka gjetur se në rang global, mbi 81% e vdekjeve që lidhen me punën i atribuohen sëmundjeve që lidhen me punën.¹⁴ Përlllogaritjet e kohëve të fundit të kryera nga ONP/ILO nxjerrin në pah një shkallë edhe më të lartë, me 88.7% të vdekjeve që lidhen me punën si pasojë e drejtpërdrejtë e sëmundjeve profesionale¹⁵. Në këtë mënyrë, bërja prioritet e njohjes dhe ngritjes së sistemeve të besueshme të raportimit është mjaft e rëndësishme për zhvillimin e SSHP-së në vend.

Në lidhje me sistemin e inspektimit, specialistët e inspektoratit të punës kanë marrë pjesë në një sërë trajnimesh, kryesisht përmes përfshirjes në projekte rajonale. Megjithatë, aktualisht nuk ka një kurrikul apo program zyrtar për trajnim fillestar apo periodik të inspektorëve, në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Është e rëndësishme që ky vakum të trajtohet nga Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë për 2025–2030-n. Për sa i përket shëndetit në punë, ekziston një kurrikul bazë e hartuar për stafin mjekësor për të adresuar sëmundjet profesionale. Ndërkohë, ka mungesë inspektorësh të shëndetësisë me formim mjekësor dhe të mjekëve të punës, gjë që ndikon negativisht te cilësia e inspektimeve të aspekteve shëndetësore që lidhen me SSHP-në dhe zbatimin e rregulloreve. Këto çështje theksojnë rëndësinë e adresimit të mungesës në trajnim dhe certifikim në fushën e SSHP-së. Duke u mbështetur kryesisht në organizmat rregullatorë dhe zbatues nuk arrihen përmirësimet e dëshiruara, qoftë si pasojë e kufizimeve në burime financiare dhe njerëzore apo mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme për të monitoruar vazhdimisht dhe për të përmirësuar standardet e SSHP-së në vendin e punës. Thjesht formulimi i nevojës për profesionistë brenda kompanive bazuar në nivelin e riskut dhe masës së forcës së punës, pa marrë parasysh nëse kualifikimet përputhen me kërkesat e detyrës që kanë, rrezikon të japë rezultate të kufizuara ose të pakënaqshme. Për këtë arsye, brenda kuadrit rregullator, del si praktikë e vlerësuar pozitivisht dhe përqafuar nga shumë vende me potencial për t'u zbatuar në vend,

ajo e ofrimit të mekanizmave certifikues për profesionistët e SSHP-së të bazuar në kritere të përcaktuara paraprakisht.

KAPITULLI 2 VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Qëllimi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i këtij dokumenti politik është orientimi i vendit drejt respektimit dhe përmbushjes të së drejtës themelore për një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm, dhe për rrjedhojë përmirësimin e produktivitetit dhe forcimin e ekonomisë në vend. Ky dokument politik synon të përmirësojë mjedisin e punës dhe kështu të ulë shpeshësinë e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale përmes zbatimit të një qasjeje parandaluese, sistematike dhe të mirëbashkërenduar për të menaxhuar shërbimet e sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe për të kultivuar kulturën e shëndetit dhe sigurisë parandaluese.

Në qendër të këtij dokumenti politik është bashkëpunimi dhe bashkërendimi me të gjitha ministritë e linjës, agjencitë qeveritare, punëdhënësit, punëmarrës dhe organizatat e tyre përfaqësuese, dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. Përpjekja e përbashkët garanton shfrytëzimin e burimeve publike, minimizon kostot e zbatueshmërisë për punëdhënësit, dhe nxit qëndrueshmërinë e këtyre veprimeve.

Për të realizuar këtë objektiv madhor, dokumenti politik i propozuar mbështetet në tri shtylla themelore:

Shtylla A: Përshtatja e institucioneve dhe politikave të SSHP-së me sfidat aktuale dhe ato të ardhshme;

Shtylla B: Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për kushte pune të denja;

Shtylla C: Kthimi në prioritet dhe rritja e ndërgjegjësimit për SSHP-në për të garantuar kushtet e punës së denjë.

Modeli i ndërhyrjes dhe rezultatet e pritshme
Nga qëllimi i përgjithshëm mund të identifikojmë katër rezultate kryesore:

¹⁴ Përlllogaritje të përbashkëta OBSH–ONP/ILO të peshës që zë puna në aksidentet dhe dëmtimet në punë, 2000–2016: raport global monitorimi.

¹⁵ ONP/ILO, mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm pune për të gjithë. Përmbushja e së drejtës themelore për një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm në mbarë botën, Raport Prezantues i ONP/ILO: 27–30 nëntor 2023 Sidnej, Australi.



- Realizimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si një e drejtë themelore;

- Përmirësimi i mjedisit të punës, duke zbatuar një qasje parandaluese, sistematike dhe të mirëbashkërenduar për të administruar shërbimet e sigurisë dhe shëndetit në punë;

- Reduktimi i shkallës së aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale;

- Promovimi i kulturës parandaluese të sigurisë dhe shëndetit.

Duke marrë parasysh instrumentet vijuese:

- Rezolutën e miratuar nga Konferenca e 110-të Ndërkombëtare e Punës, në lidhje me përfshirjen e mjedisit të sigurt dhe të shëndetshëm të punës në Deklaratën e ONP/ILO për Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë 1998, si të drejtë themelore.

- Konventat Themelore të ONP/ILO për SSHP-në (konventat 155 dhe 187)

- Strategjia Globale e ONP/ILO për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024–2030;

- Përpjekjet dhe politikat kombëtare të orientuara drejt realizimit të një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune, si PVPD 2023–26, Dokumenti Strategjik i Shqipërisë për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2016–2020, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030;

- Kuadrin e ri Strategjik të BE-së për SSHP-në 2021–2027;

- Direktivën e Këshillit të BE-së 89/391/EEC, të 12 qershorit 1989, për prezantimin e masave për të nxitur përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në punë, e cila ishte një gur i rëndësishëm kilometrik në përmirësim të sigurisë dhe shëndetit në punë. Ajo garanton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në të gjithë Evropën ndërsa vendeve anëtare u lejohej të vendosin apo kenë masa më të repta.

Duke marrë në konsideratë supozimet e mëposhtme:

Supozimi 1: që forcimi i institucioneve dhe përmirësimi i kuadrit normativ do të sjellë praktika më të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë;

Supozimi 2: që sistemet efektive të monitorimit dhe raportimit do të lehtësojnë identifikimin, dhe si rrjedhojë zvogëlimin e rreziqeve dhe risqeve në vendin e punës;

Supozimi 3: që mekanizmat e certifikimit të profesionistëve për SSHP-në në kontekste të ndryshme do të garantojë kompetencën dhe

efektshmërinë në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë;

Supozimi 4: që rritja e ndërgjegjësimit dhe e të kuptuarit të të drejtave të sigurisë dhe shëndetit në punë do të sjellë respektim dhe zbatim në shkallë të gjerë të masave parandaluese.

Është e mundur të identifikohen rrugët e mëposhtme të ndryshimit:

- Forcimi i institucioneve dhe kuadrit normativ → zbatim i përmirësuar i politikave SSHP → mjedis më të sigurt dhe më të shëndetshëm në punë;

- Sisteme monitorimi dhe mbledhje informacioni → kuptim më të qartë të rreziqeve në vendin e punës → zbatim të masave parandaluese → shkallë të reduktuar aksidentesh dhe sëmundjesh profesionale;

- Sisteme njohjeje dhe raportimi për sëmundjet profesionale → rritje të shkallës së zbulimit dhe të ndërgjegjësimit → zbatim të masave parandaluese → shkallë të reduktuar sëmundjesh profesionale;

- Mekanizma certifikimi për profesionistët e SSHP-së → rritje të kompetencave dhe efikasitetit në adresimin e çështjeve të sigurisë në vendin e punës → mjedis më të sigurt dhe të shëndetshëm në punë.

Rezultatet e pritshme

- Kapacitet i përmirësuar i institucioneve përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë;

- Kuadër i përmirësuar normativ për sigurinë dhe shëndetin në punë;

- Sisteme monitoruese funksionale për pasojat në mjedisin e punës;

- Sisteme të përmirësuara njohjeje dhe raportimi për sëmundjet profesionale;

- Mekanizma certifikimi për profesionistët e SSHP-së.

Rezultate afatshkurtra

- Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit dhe e të kuptuarit të të drejtave dhe parimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë;

- Përmirësimi në mbledhjen e të dhënave dhe në raportimin e aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale;

- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të SSHP-së përmes mekanizmave të certifikimit.

Rezultate afatmesme

- Reduktimi i shkallës së aksidenteve në punë;

- Reduktimi i shkallës së sëmundjeve profesionale;



- Përmirësimi në respektimin e rregulloreve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Rezultate afatgjata:

- Realizimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si e drejtë themelore në nivel global;

- Ulja e konsiderueshme e vdekjeve dhe dëmtimeve në punë.

Shtylla A: Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë me sfidat aktuale dhe ato të ardhshme

Shtylla strategjike A synon të adresojë panoramën dinamike të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke siguruar që kuadri rregullator dhe struktura institucionale të mbeten të përgjegjshme dhe rezistente ndaj sfidave aktuale dhe të së ardhmes. Kjo shtyllë pranon që bota e punës, së bashku me kërcënimet aktuale dhe ato të reja që lidhen me rreziqet për sigurinë dhe shëndetin, është një fushë në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të ndryshimeve teknologjike dhe ekonomike, ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike. Teoria e ndryshimit mbi të cilën ngrihet shtylla A parashikon se duke krijuar institucione dhe politika të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të përmbushur sfidat e së tashmes dhe së ardhmes, mund të arrihen përmirësime të konsiderueshme në fushën e SSHP-së, gjë që krijon një mjedis më të sigurt dhe të shëndetshëm në punë, rritje të produktivitetit, të mirëqenies së punëmarrësve dhe të qëndrueshmërisë së këtyre arritjeve. Kjo teori sugjeron tri rrugë të mundshme:

1. *Përmirësim të kuadrit ligjor*: Duke forcuar kuadrin ligjor të SSHP-së, përmes përafrimit me standardet e BE-së dhe ato të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, institucionet përkatëse duhet t'i japin përparësi sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës me përmirësimin e zbatimit të rregulloreve dhe standardeve. Kjo pritet të sjellë ulje të numrit të aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale.

2. *Përmirësim të sistemeve të hetimit dhe raportimit të aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale*: Duke përmirësuar sistemet e hetimit dhe raportimit të rasteve të aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale, institucionet përgjegjëse mund të identifikojnë shkaqet dhe faktorët

kontribues të këtyre rasteve, duke mundësuar kështu hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve të mirësnuara për të parandaluar përsëritjen e rasteve të tilla. Kjo pritet të sjellë uljen e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së aksidenteve në vendin e punës dhe të sëmundjeve profesionale.

3. *Profesionistë kompetentë në SSHP*: Ngritja e sistemit për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e ekspertëve dhe shërbimeve të SSHP-së siguron disponueshmërinë e profesionistëve të kualifikuar, të pajisur me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të menaxhuar rreziqet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Kjo pritet të përmirësojë identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve në vendin e punës dhe të përmirësojë performancën e përgjithshme të sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

1.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor të SSHP-së

Përmirësimi i kuadrit ligjor të SSHP-së kërkon ngritjen e Këshillit Ndërmnistror për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (KNSSHP), siç e parashikon ligji për SSHP-në. Ky këshill do të bashkërendojë bashkëpunimin e aktorëve kryesorë në këtë fushë. Njohja e mungesës së një nisme të përbashkët si pengesë e madhe në zbatimin e dokumentit politik të mëparshëm thekson nevojën për një mekanizëm të konsoliduar të monitorimit dhe vlerësimit. Ky mekanizëm, mundësuar nga angazhimi aktiv i të gjithë aktorëve, siguron një zbatim efektiv të dokumentit politik të SSHP-së.

Për më tepër, ngritja e KNSSHP-së, në përputhje me ligjin nr. 10237 (2010)¹⁶ dhe duke marrë parasysh pjesëmarrjen e organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve, është faktor kyç për bashkëpunim ndërinstitucional efikas, në monitorimin e zbatimit të politikave SSHP, dhe në sigurimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së aktorëve trepalësh. Mungesa e mekanizmave të përcaktuar për koordinim dhe monitorim dhe personel të kualifikuar në të gjitha ministratë dhe institucionet përkatëse pengon bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacionit në mënyrë efektive. Duke krijuar një organ qendror bashkërendues, aktorët mund t'i harmonizojnë më mirë veprimet, mund të shpërndajnë më mirë burimet financiare dhe të shkëmbejnë informacion jetik për të përmirësuar situatën e sigurisë dhe shëndetit në punë në rang vendi.

¹⁶ Shqipëri, ligji nr. 10237, datë 18 shkurt 2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".



Në këtë kuptim, që KNSSHP-ja të funksionojë siç duhet, përveç përgatitjeve të nevojshme në lidhje me rregullat për ngritjen e tij, përcaktimit të agjendës dhe përfaqësuesve të tij, duhet të ngrihet dhe një rrjet koordinatorësh të SSHP-së në institucionet e përfaqësuara në këtë Këshill, duke përfshirë këtu dhe zyrën e Kryeministrit. Për më tepër, për institucionet e përfaqësuara, përfshirja e përfaqësuesve të punëmarrësve dhe punëdhënësve në këtë Këshill Ndërmintoror është thelbësor pasi kështu u jepet zë këtyre aktorëve, duke mundësuar ngritjen e kërkesave dhe arritjen e zgjidhjeve konkrete të cilat janë më pranë realitetit të botës së punës duke lehtësuar zbatimin e vendimeve.

Një tjetër veprimtari strukturuese e KNSSHP-së e parashikuar nga ky dokument ka të bëjë me trajnimin e anëtarëve të tij në fushën e dialogut social dhe çështjeve që lidhen me SSHP-në për të përmbushur më mirë mandatin e tyre.

Për më tepër, në kontekstin e harmonizimit të kuadrit rregullator të vendit për procesin e anëtarësimit në BE, merr vlerë të konsiderueshme kryerja e analizës së mangësive. Kjo analizë mundëson identifikimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe përditësimin e dokumenteve të rëndësishme në këtë aspekt. Zbatimi i shpejtë i legjislacionit dhe i ndryshimeve institucionale është i domosdoshëm për forcimin e sistemit të SSHP-së, duke përfshirë transpozimin e direktivave të BE-së që lidhen me SSHP-në ende të papërfunduara.

Plotësimi i veprimtarive rregullatore, miratimi i udhëzimeve jodetyruese të SSHP-së me burime BE-në dhe organizma të tjera ndërkombëtare mund të shërbejë si shtojcë efikase për kuadrin rregullator, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të qeverisjes së SSHP-së.

Më tej, përparimi në procesin e ratifikimit të konventave të ONP/ILO është një hap i rëndësishëm në respektimin e standardeve ndërkombëtare të SSHP-së, veçanërisht Konventa nr. 161 e ONP/ILO për Shërbimet e Shëndetit në Punë dhe Konventa nr. 188 e ONP/ILO për Punën në Peshkim. Të tilla veprime tregojnë angazhim në përmirësimin e mjedisit të punës, në lidhje me SSHP-në dhe përfshirjen e një sektori të rëndësishëm të ekonomisë, i cili ka ende nevojë për kontroll të detajuar dhe mbrojtje më të madhe, siç është sektori i peshkimit, duke reduktuar kështu shpeshimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Së fundi, ratifikimi dhe zbatimi i Konventës nr. 189 të ONP/ILO promovon një sistem më përfshirës pune, rrit standardet dhe garanton mbrojtje më të gjerë për punëmarrësit shtëpiakë, të cilët shpesh punojnë në mjedise informale pune me pak ose aspak standarde funksionale të SSHP-së.

1.2 Përmirësimi i sistemeve të hetimit, deklarimit dhe raportimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale

Ngritja e një sistemi të konsoliduar për hetimin dhe raportimin e aksidenteve në punë është i domosdoshëm për të ruajtur sigurinë në vendin e punës dhe për të parandaluar aksidentet në të ardhmen. Aktualisht, efektiviteti i sistemit ekzistues të raportimit dhe regjistrimit has pengesa të ndryshme. Megjithatë, këto sfida mund të kapërcehen duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm strategjikë:

Vënia në zbatim e metodologjisë ESAW: Zbatimi i Statistikave Evropiane për Aksidentet në Punë (ESAW) ofron qasje të standardizuar të mbledhjes së të dhënave për aksidentet në vendin e punës. Me vënien në zbatim të kësaj metodologjie, organizatat mund të sigurojnë qëndrueshmërinë e mbledhjes së të dhënave dhe krahasueshmërinë e tyre, në lidhje me aksidentet në punë të cilat raportohen nga vende të ndryshme.

Ngritja e mekanizmit për mbledhje të standardizuar të të dhënave: Ky hap ka të bëjë me krijimin e një procesi të strukturuar për mbledhjen e të dhënave për aksidentet në vendin e punës. Për ngritjen e një mekanizmi të tillë nevojitet që një institucion të ngarkohet me detyrën e zhvillimit dhe monitorimit të procesit, familjarizimin me metodën ESAW, hartimin e protokollit për mbledhjen e të dhënave, ngritjen e kanaleve raportuese, trajnimin e personelit të nevojshëm, zbatimin e masave për sigurimin e cilësisë dhe monitorimin, dhe vlerësimin e mekanizmit të mbledhjes së të dhënave.

Zhvillimi i Regjistrat Kombëtar të Aksidenteve në Vendin e Punës: Krijimi i një regjistri kombëtar të dedikuar për aksidentet në punë, që përputhet me kërkesat e ESAW dhe që standardizon regjistrimin e centralizuar të të dhënave për aksidentet në punë. Ky regjister shërben si një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse që mundëson analiza të thelluara tendencash, evidenton faktorët e rrezikut dhe shërben si bazë arsyetimi për vendimmarrjet për politikatat e orientuara drejt përmirësimit të sigurisë në vendin e punës.



Ngritja e kapaciteteve: Ngritja e kapaciteteve të institucioneve më kryesore, përfshirë agjencitë qeveritare, punëmarrësit, punëdhënësit dhe organizatat e tyre, dhe profesionistët në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, është thelbësor për optimizimin e protokollit të menaxhimit dhe regjistrimit të aksidenteve. Programet e konsoliduara të trajnimit të përshtatur për të kultivuar ekspertizën dhe për të rritur aftësitë në teknikat e hetimit të aksidenteve, në metodologjitë dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave, në analizim dhe raportim, do t'u vijnë në ndihmë aktorëve për të përmbushur përgjegjësitë e tyre, me qëllim rritjen e sigurisë në vendin e punës.

Përpjekjet për të përmirësuar sistemin e deklarimit dhe raportimit për sëmundjet profesionale janë të ndërlidhura dhe synojnë të nxisin menaxhimin dhe parandalimin e rreziqeve ndaj shëndetit në punë. Megjithatë, zbatimi i kuadrit aktual të deklarimit, dhe raportimit për sëmundjet profesionale, paraqet mangësi, veçanërisht në funksionimin e kabineteve të sëmundjeve profesionale dhe trajnimin e mjekëve në fushën e mjekësisë së punës dhe sëmundjeve profesionale. Kjo mangësi rezulton në identifikimin e paplotë të sëmundjeve profesionale dhe për rrjedhojë dëmton përpjekjet për monitorimin e tyre, pavarësisht se vendi ka miratuar një listë gjithëpërfshirëse të sëmundjeve profesionale. Bazuar te këto sfida, ky dokument politik përmbledh hapat e mëposhtëm:

Së pari, ngritjen e një grupi pune për të rishikuar sistemin e deklarimit dhe raportimit për sëmundjet profesionale. Ky grup do të identifikojë mangësitë ekzistuese dhe do të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore për të përmirësuar (kontrollin periodik të) shëndetit në punë dhe diagnostifikimin e sëmundjeve profesionale. Këto ndryshime ligjore do të shërbejnë si kuadër për zbatimin e përmirësimeve të mëtejshme.

Së dyti, hartimi i programeve të përshtatshme që synojnë formimin e profesionistëve në fushën e mjekësisë së punës / sëmundjeve profesionale është thelbësor për të siguruar që ata të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të identifikuar, diagnostikuar dhe menaxhuar sëmundjet profesionale në mënyrë efektive. Duke zhvilluar kurrikula/plane mësimore të përditësuara në mjekësinë e punës dhe sëmundjeve profesionale, si dhe duke krijuar një program zhvillimi profesional apo specializimi me kohë të plotë në përputhje me

standardet e BE-së, ekspertiza e profesionistëve të kontrollit periodik të shëndetit në punë apo mjekësor në këtë fushë do të përmirësohet ndjeshëm.

Së treti, krijimi i regjistrit kombëtar për sëmundjet profesionale në përputhje me metodologjinë e Statistikave Evropiane të Sëmundjeve Profesionale (EODS) do të luajë një rol kyç në lehtësimin e mbledhjes dhe analizimin e të dhënave. Harmonizimi i regjistrit me standardet e BE-së do të sigurojë përputhshmërinë në mbarë vendin dhe do të mundësonte gjenerimin e statistikave më të sakta, të cilat janë thelbësore për shqyrtimin e tendencave dhe për të zhvilluar strategji të mirësynuara parandalimi.

Së fundi, formulimi i udhëzimeve gjithëpërfshirëse dhe materialeve ndërgjegjësuese për punëdhënësit në lidhje me sëmundjet profesionale e plotëson ciklin e përmirësimit. Duke i edukuar punëdhënësit për nivelet e rreziqshmërisë që lidhen me rreziqet në vendin e punës dhe duke ofruar orientime për masat parandaluese, nxitet qasja proaktive për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke kontribuar në uljen e shpeshtësisë së sëmundjeve profesionale.

Këto nisma të ndërlidhura funksionojnë në mënyrë sinergjike për të forcuar sistemin e hetimit dhe raportimit të aksidenteve në vendin e punës, si dhe të deklarimit dhe raportimit të sëmundjeve profesionale, duke çuar në përmirësimin e parandalimit, diagnostikimit dhe menaxhimit të rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Për të siguruar që këto masa të punojnë në mënyrë sinergjike, është thelbësore të zbatohet një sistem i integruar i shkëmbimit të informacionit dhe një sistem ligjzbatues që garanton respektimin e ligjit duke dekurajuar shkeljet e tij. Për këtë arsye duhet të lidhet sistemi i informacionit mjekësor me sistemin për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për të mundësuar kështu shkëmbimin e informacionit. Për më tepër duhet të ngrihet një regjister kombëtar i centralizuar për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale (RKASP), në përputhje me kriteret e informacionit të përcaktuara nga ESAW dhe EODS.

Për sa i përket zbatimit, është me rëndësi hartimi dhe forcimi i masave në bashkërendim me nismat aktuale të qeverisë shqiptare për reformimin e inspektorateve. Këtu përfshihen rekomandimi i



veprimeve zbatuese më të rrepta për të zvogëluar nivelin e raportimit të ulët, veçanërisht të sëmundjeve profesionale.

1.3 Ngritja e sistemit për trajnimin, certifikimin e ekspertëve dhe licencimin e shërbimeve të SSHP-së

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të SSHP-së dhe ekspertizës së profesionistëve brenda kompanive është faktor themelor për kultivimin dhe garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune dhe rritjen e produktivitetit. Mjedisi i sigurt dhe i shëndetshëm i punës ka një efekt të madh në mirëqenien e forcës së punës dhe qëndrueshmërinë e mjedisit të punës. Praktikrat e përmirësuara të SSHP-së ulin kostot operacionale dhe fenomenin e mungesës në punë, duke ngritur produktivitetin organizativ dhe reputacionin e kompanisë. Për të trajtuar këtë çështje duhet të ndërmerren disa hapa:

Të formulohen kritere të qarta: Vënia në zbatim e rregulloreve dhe udhëzimeve që parashikojnë standardet minimale për shërbimet lidhur me SSHP-në brenda njësive të bizneseve. Këto kërkesa mund të mbulojnë aspekte si vlerësimi i rrezikshmërisë, identifikimi i rreziqeve, trajnime për sigurinë, dhe përgatitja në raste emergjencash.

Të zhvillohen programe të standardizuara trajnimi: Zhvillimi i programeve të standardizuara të trajnimit për profesionistët e SSHP-së për të siguruar uniformitetin dhe cilësinë në kompani dhe industri të ndryshme. Këto programe duhet të mbulojnë parimet themelore të SSHP-së, legjislacionin, rregulloret respektive, strategjitë e menaxhimit të rrezikut dhe aftësitë praktike për sigurinë në vendin e punës, sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Të formulohen dhe zbatohen masa të kontrollit të performancës së shërbimeve të SSHP: Prezantimi i mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së shërbimeve të SSHP-së brenda kompanive. Kjo mund të kërkojë inspektime, auditime dhe vlerësime periodike që kryhen nga profesionistë të kualifikuar ose organe rregullatore për të garantuar respektimin e standardeve dhe rregulloreve të përcaktuara më herët.

Të ngrihet sistemi i certifikimit dhe licencimit: Është e rëndësishme ngritja e sistemit të certifikimit për profesionistët e SSHP-së për të verifikuar ekspertizën dhe kompetencat e tyre, si dhe të

licencimit për shërbimet e ofruara në këtë fushë. Kjo mund të kërkojë certifikimin për profesionistët e SSHP nga një trupë certifikuese e personit, e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al>), për fushën e profesionistëve të sigurisë dhe shëndetit në punë, apo plotësimin e kërkesave të veçanta për licencimin e shërbimeve.

Zhvillim të vazhdueshëm profesional: Promovimin e kulturës për të nxënuar dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm për ekspertët e SSHP-së për të siguruar përditësimin e tyre me informacionet më të fundit, përparimet e kohës, praktikrat më të mira dhe ndryshimet rregullatore në fushën në fjalë. Kjo mund të kërkojë pjesëmarrje në seminare, konferenca, kurse virtuale ose programe trajnimi të specializuara.

Promovim të kulturës së sigurisë: Promovimi i kulturës së sigurisë brenda njësive të biznesit duke promovuar rritjen e ndërgjegjësimit, angazhimit dhe pjesëmarrjes në të gjitha nivelet e organizatës. Për këtë nevojitet komunikim i rregullt për politikrat dhe procedurat e sigurisë, nxitje e reagimit nga ana e punëmarrësit dhe përfshirje në nismat e sigurisë, si dhe njohja dhe shpërblimi për kontributin për ta mbajtur mjedisin e punës të sigurt e të shëndetshëm.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit: Promovimi dhe lehtësimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive mes profesionistëve të SSHP-së, njësive të bizneseve, shoqatave industriale, agjencive qeveritare dhe aktorëve të tjerë. Kjo mund të kërkojë ngritjen e rrjeteve, forumeve apo platformave për shkëmbimin e informacionit, praktikave më të mira dhe mësimet të nxjerra në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Vënia në zbatim të këtyre ndryshimeve për të gjithë profesionistët dhe në të gjitha shërbimet ekzistuese të sigurisë dhe shëndetit në punë sjell ndryshime të konsiderueshme në kualifikimet e profesionistëve dhe në mënyrën se si funksionojnë shërbimet, gjë që mund të kërkojë aplikimin e një strategjie të mirëstrukturuar dhe të ndarë në faza për të mos vënë në rrezik vazhdimësinë e kësaj veprimtarie të një rëndësie të madhe për SSHP-në. Në këtë kuptim, këto ndryshime fillimisht do të zbatohen në një sektor specifik, që do të përcaktohet nga KNSSHP-ja dhe më pas do të shtrihet në sektorët e tjerë ekonomikë. Kjo qasje do të mundësojë, si fillim, përqendrimin në një sektor parësor për SSHP-në dhe përmirësimin e sistemit



kur të shtrihet në sektorë të tjerë me mësimet e nxjerra nga faza fillestare.

Ky dokument politik përcakton hapat e mëposhtëm për të përmirësuar sistemin aktual ndërsa kontribuon gjithashtu në produktivitetin, eficiencën dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme.

Identifikimi i mangësive ekzistuese: Hapi i parë ka të bëjë me vlerësimin gjithëpërfshirës për të identifikuar mangësitë më kryesore në cilësinë e shërbimeve në SSHP-së dhe ekspertëve brenda njësive të biznesit. Kjo nënkupton nxjerrjen e pikave të dobëta, si mungesa e protokolleve të standardizuara të trajnimit për SSHP-në, e procedurave për certifikimin dhe të kuadrit të licencimit.

Kryerja e analizës krahasimore: Për të trajtuar këto mangësi siç duhet, duhet kryer një analizë e detajuar krahasimore e sistemeve të ngritura dhe praktikave më të mira të zbatuara në vende të tjera. Kjo analizë shërben si bazë për vënien në zbatim të strategjive të suksesshme dhe përshtatjen e tyre për t'u harmonizuar më mirë me nevojat specifike të vendit.

Ngritja e kuadrit për trajnimin, certifikimin dhe licencimin: Duke u bazuar te mësimet e nxjerra nga analiza krahasimore, merr rëndësi themelore ngritja e një kuadri rregullator të konsoliduar për trajnimin dhe certifikimin e ekspertëve të SSHP-së, si dhe formulimi i kriterëve për licencimin e shërbimeve të SSHP-së. Për këtë nevojitet zhvillimi i programeve të strukturuar të trajnimit të përshtatura për nevojat e ndryshme të profesionistëve të SSHP-së dhe zbatimi i një procesi rigoroz certifikimi nga një organizëm i certifikimit të personave, i miratuar.

Për sa i përket licencimit të shërbimeve, është me rëndësi të përcaktohen kriteret bazë për të operuar si shërbimi sigurisë dhe shëndetit, si dhe treguesit e performancës për ta ruajtur cilësinë e këtij shërbimi.

Miratimi i reformave ligjore: Për të institucionalizuar trajnimin, certifikimin e ekspertëve dhe licencimin e shërbimeve të SSHP-së nevojitet miratimi i reformave ligjore. Këto reforma do të përcaktojnë kriteret e qarta për certifikimin dhe licencimin, rivlerësimin e certifikimeve aktuale për profesionistët e SSHP, duke garantuar respektim të standardeve dhe duke promovuar kulturën e ligaridhënies brenda sektorit të SSHP-së.

Shtylla B: Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për kushte pune të denjë

Përpjekjet për të forcuar qeverisjen dhe menaxhimin e institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë janë kyçe për promovimin e kushteve të punës së denjë dhe për mbrojtjen e shëndetit dhe të të drejtave të punëmarrësve, për nxitjen e produktivitetit ekonomik, për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe etike, dhe për të ruajtur përgjegjësinë sociale. Teoria e ndryshimit mbi të cilën mbështetet shtylla B parashikon se forcimi i institucioneve politikëbërëse dhe ligjzbatuese të cilat merren me SSHP-në, përmes kapaciteteve të zhvilluara, infrastrukturës së përmirësuar, reformave në politika dhe angazhimit të aktorëve të rëndësishëm, do të krijojë një kontroll rregullator më efikas ndaj SSHP-së dhe një rrjet institucional për një mjedis më të sigurt dhe të shëndetshëm pune, rritje të produktivitetit, të mirëqenies së punëmarrësve dhe të qëndrueshmërisë.

Në lidhje me këtë shtyllë, ky dokument politik parashikon hapat e mëposhtme:

Forcimi i kapaciteteve të institucioneve politikëbërëse dhe ligjzbatuese: Kjo kërkon zhvillimin e kapaciteteve të njësive kyçe si Sektori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, njësive respektive në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe pranë Institutit të Shëndetit Publik. Duke investuar në burime, trajnime dhe infrastrukturë, këto njësi mund të monitorojnë dhe rregullojnë me efikasitet standardet e sigurisë në vendin e punës, me qëllimin final atë të ruajtjes së mirëqenies së punëmarrësve në industrinë e ndryshme.

Kapacitete të zhvilluara të institucioneve ligjzbatuese Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik: Nismat që synojnë forcimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) dhe Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) janë tejet të rëndësishme. Duke i pajisur këto institucione me kapacitetet e nevojshme, përfshirë mjete të avancuara monitorimi dhe trajnime të specializuara për inspektorët, atëherë dhe kontrolli i zbatimit të rregulloreve të SSHP-së mund të bëhet



më rigoroz dhe më gjithëpërfshirës, në veçanti për sa i përket njohjes së sëmundjeve profesionale.

Përmirësimi i dialogut social në fushën e SSHP-së: Promovimi i dialogut social mes aktorëve në fushën e SSHP-së është mjaft i rëndësishëm. Mundësimi i angazhimit konstruktiv mes punëdhënësve, punëmarrësve dhe autoriteteve qeveritare nxit qasjen bashkëpunuese për të identifikuar dhe trajtuar rreziqet në vendin e punës, për të promovuar një mjedis pune më të sigurt e më të qëndrueshëm për të gjithë.

2.1 Forcimi i kapaciteteve të institucioneve politikëbërëse dhe zbatuese

*Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit:
Sektori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë*

Për sa i përket MEKI-t, Sektori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë është një njësi thelbësore në zhvillimin e politikave dhe ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme në fushën e SSHP-së.

Si një sektor i ngritur rishtazi e që ende është në proces strukturimi, ky sektor ka nevojë për më shumë burime njerëzore dhe materiale për të përmbushur detyrat që ka. Në lidhje me politikën, është i nevojshëm përmirësimi i sistemeve të mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave mes institucioneve që janë pjesë përbërëse e sistemit kombëtar të SSHP-së, veçanërisht në lidhje me rreziqet në vendin e punës, aksidentet e punës, sëmundjet profesionale, si dhe trajnimi i personelit aktual dhe të ardhshëm, me tematikë që lidhen me SSHP-në.

Për sa u përket politikave, forcimi i kësaj strukture është i domosdoshëm për të përmbushur detyrimet brenda procesit të integritetit evropian të Shqipërisë, detyrimet brenda kuadrit të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP/ILO) dhe Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), dhe për të përmirësuar sistemet e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave mes institucioneve që janë pjesë përbërëse e sistemit kombëtar të SSHP-së, veçanërisht në lidhje me rreziqet në vendin e punës, aksidentet e punës dhe sëmundjet profesionale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Drejtoria e Shëndetit dhe Mjekësisë së Punës

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor kanë nevojë për përmirësim

thelbësore në qasjen ndaj sigurisë dhe shëndetit në punë. Aktualisht, struktura e posaçme brenda MSHMS-së përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të forcohet. Mungesa e vëmendjes ndaj kësaj strukture ka sjellë problematika me kujtesën institucionale dhe vëmendjen e fragmentuar brenda shërbimeve të kujdesit parësor.

Për të adresuar mangësitë është mjaft e rëndësishme forcimi i strukturës së dedikuar përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë brenda MSHMS-së. Kjo do të siguronte një qasje të përqendruar për adresimin e problematikave të shëndetit në punë dhe për ruajtjen e vijueshmërisë në politika dhe programe. Forcimi i kësaj strukture do të kërkonte përpjekje të mirë-syruara për të ndërtuar kapacitetet dhe ekspertizën lidhur me shëndetin në punë.

MSHMS-ja është pa dyshim një tjetër organ kryesor për çështjet e SSHP-së, por veprimet që lidhen me shëndetin në punë janë adresuar brenda fushës së veprimit të veprimeve të tjera të kujdesit shëndetësor, duke mos marrë kështu vëmendjen e duhur. Në mënyrë të ngjashme veprimet e kujdesit shëndetësor parësor janë kryer nga mjeku i familjes, i cili duke qenë se është trajnuar gjerësisht, nuk ka njohuri të thelluara për shëndetin në punë dhe nuk e bën lidhjen shkak-pasojë midis një sëmundjeje dhe agjentëve dhe rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet punëmarrësi. Qasja tejet e përgjithshme rezultoi në shpërbërjen e strukturave të mëparshme të cilat kategorizonin sëmundjet profesionale, si për shembull Shërbimi Kombëtar për Sëmundjet Profesionale pranë Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza (QSUNT) dhe njësitë e shëndetit në punë.

Pasojat e kësaj situate çuan në përfshirjen në trajnime jo vetëm të zyrtarëve publikë të cilët punonin në institucione, por edhe të mjekëve të familjes dhe mjekëve të tjerë specialistë të cilët punonin në fushën e mjekësisë së punës. Vlen të përmendet se nuk ka një kurs të dedikuar për këtë çështje dhe tematika trajtohet në mënyrë transversale gjatë kursit të specializimit të mjekut të familjes.

Ky skenar pati pasoja në kategorizimin e sëmundjeve si sëmundje profesionale dhe në mënyrën se si kjo çështje u adresua duke ndikuar kështu negativisht në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit të marrë, në vëzhgimin



epidemiologjik dhe në hartimin e politikave dhe planeve të veprimit.

Si hap i parë drejt ndryshimit të këtij skenari, nevojitet me urgjencë forcimi i strukturës brenda MSHMS-së, e ngjashme me atë të ngritur pranë MEKI-t, si Sektori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Ky sektor do të jetë pika e kontaktit për adresimin e këtyre çështjeve, për hartimin e politikave dhe zbatimin e planeve të veprimit për shëndetin në punë.

Si hap i dytë, është e nevojshme ringritja e strukturave përgjegjëse për deklarimin e sëmundjeve profesionale pranë QSUNT-së, si dhe e njësive të shëndetit në punë/kabineteve të sëmundjeve profesionale pranë spitaleve rajonale, për të siguruar që punëmarrësit kanë akses në shërbimet e shëndetit në punë në të pesë rajonet e përcaktuara nga MSHMS-ja.

Veprimet për të riaktivizuar strukturat organizative duhet të shoqërohen nga veprime që synojnë edukimin, trajnimin dhe kualifikimin e profesionistëve të shëndetësisë. Në këtë kuptim, është e nevojshme të zbatohet një program trajnimi për nëpunësit publikë të institucioneve që mbulojnë fushën e shëndetit në punë, bazuar në një vlerësim të nevojave që kanë për trajnim. Nga ana tjetër, mjekut të familjes duhet t'i ofrohen njohuritë e nevojshme lidhur me sëmundjet profesionale duke përfshirë disiplinën specifike për shëndetin në punë në kurrikulën e trajnimit, e në këtë mënyrë duke përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi këtë çështje. Këta hapa duhet të shtrihen edhe te profesionistët e tjerë në mjekësi, të cilët aktualisht janë të angazhuar me SSHP-në, si dhe t'u ofrohet profesionistëve të ardhshëm njohuri më të përparura në këtë temë. Në këtë aspekt, ky dokument politik parashikon ofrimin e trajnimeve rëfreskuese për shëndetin në punë, si dhe bashkërendim me universitetet për të ngritur një program për shëndetin në punë për specializantët.

Fuqizimi i institucioneve do të përfshijë dhe Institutin e Shëndetit Publik duke forcuar kapacitetet e tij për vlerësimin e rreziqeve ndaj shëndetit në punë dhe për kryerjen e monitorimit në shkallë të gjerë për shëndetin në punë. Në lidhje me këtë, është e nevojshme të ngrihet laborator i toksikologjisë dhe të pajiset me instrumente matëse specifike për mjedisin e punës.

Një tjetër çështje kyçe për zbatimin me sukses të politikave publike është përmirësimi i sistemit të

mbledhjes dhe shkëmbimit të informacionit, me veprime që synojnë zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit Digjital të të Dhënave për Shëndetin në Punë. Më tej do të vijohet me trajnimin e mjekëve të punës në ndërmarrje dhe specialistëve për dokumentet shëndetësore me qëllim krijimin e të dhënave të sakta, informacionit të cilësishëm, si dhe në lidhje me procedurat e monitorimit shëndetësor me në fokus shëndetin në punë. Ky sistem i ndërlidhur do ta qartësojë procesin edhe për mjekët e punës dhe për mënyrën se si ata menaxhojnë dhe analizojnë të dhënat e pacientit në mënyrë efikase dhe se si t'i monitorojnë më mirë rreziqet në vendin e punës dhe tendencat në çështje që kanë të bëjnë me shëndetin në punë. Krijimi i një sistemi digjital të të dhënave për shëndetin në punë do të jetë një databazë që mund të përfshijë të dhëna mbi kushtet e punës, rreziqet në vendin e punës, të dhënat e pacientit, apo dhe masat parandaluese.

Në këtë aspekt, u jepet prioritet nismave të ndryshme për të rritur kapacitetet dhe për të përmirësuar rezultatet:

Riaktivizim i njësive të shëndetit në punë / kabineteve të sëmundjeve profesionale: Njësitë rajonale për shëndetin në punë në pesë spitalet rajonale dhe një spital tretësor/terciar QSUNT-ja luajnë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor përfshirë dhe shëndetin në punë. Duke riaktivizuar Njësitë e Shëndetit në Punë/kabinetet e sëmundjeve profesionale, do të mundësohet akses i punëmarrësve në këto shërbime. Kjo nismë synon të promovojë diagnostikimin e hershëm dhe parandalimin e sëmundjeve profesionale te punëmarrësit.

Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit digjital të të dhënave për shëndetin në punë: Vënia në zbatim e sistemit digjital të të dhënave për shëndetin në punë do ta qartësojë dhe bëjë më efikas procesin e menaxhimit dhe analizës së të dhënave të pacientit për mjekët e punës. Ky sistem do ta lehtësojë diagnostikimin efikas të sëmundjeve profesionale duke çuar në ndërhyrjen dhe trajtimin në kohë të problemit. Për më tepër, do të mundësojë monitorimin e rreziqeve dhe tendencave në mjedisin e punës për çështje të shëndetit në punë duke i ardhur në ndihmë politikë-bërjes bazuar në të dhëna.

Fuqizimi i Institutit të Shëndetit Publik: ISHP-jaka rëndësi jetike për të formuluar rekomandime politikash të bazuara në të dhëna dhe të cilat janë të



mundshme për t'u zbatuar. Kjo ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve për të vlerësuar në mënyrë rigorozë rreziqet dhe nivelin e rrezikshmërisë në vendin e punës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e punëmarrësve. Aktualisht, ISHP-së i mungojnë kapacitetet në infrastrukturë dhe në staf të kualifikuar për të kryer monitorime që lidhen me shëndetin në punë.

Zhvillimi i programeve të trajnimit dhe kurseve për SSHP-në: Për të adresuar mungesat në ekspertë të kualifikuar në shëndetin e punës, përfshirë dhe mjekë pune, duhen zhvilluar dhe zbatuar programe trajnimi dhe kursesh për SSHP-në. Këto kurse duhet të kenë kurrikula të tilla që t'i pajisin profesionistët me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të adresuar siç duhet sfidat aktuale dhe reja për shëndetin në punë. Theks i veçantë i duhet vënë trajnimit dhe përvojës praktike për t'u siguruar se ekspertët përkatën më së miri dhe certifikohen zyrtarisht për të përmbushur rolet e tyre.

2.2 Rritje e kapaciteteve të institucioneve zbatuese

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)

Në bashkërendim me nismën e qeverisë shqiptare për reformimin e inspektorateve, nevojiten të ndërmerren veprimet të ndryshme për të garantuar përputhjen e inspektimit të punës me kërkesat e Konventës nr. 81 të ONP/ILO për Inspektimin e Punës dhe të Konventës nr. 129 të ONP/ILO për Inspektimin e Punës në Bujqësi, si dhe për të forcuar efikasitetin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH).

Për të zbatuar këtë objektiv, duhet të ndërmerren disa hapa të cilat kërkojnë vëmendje dhe investim në fushat e mëposhtme:

Analizë e kuadrit ligjor: Kryerja, në bashkëpunim me strukturat politikëbërëse pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), e analizimit gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor që përcakton funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e ISHPSHSH-së. Kjo analizë duhet të përfshijë vlerësimin e masave ndëshkuese, veçanërisht sistemin e penaltiteve për shkelje duke përcaktuar në këtë mënyrë natyrën dhe ashpërsinë e sanksioneve. Nxitja e bashkëpunimit me inspektoratet e tjera është i rëndësishëm për të shmangur mbivendosjet, për të garantuar shkëmbimin e saktë të informacionit dhe për të

mundësuar inspektime të përbashkëta apo referime të kompanive me rrezikshmëri të lartë. Për më tepër, nevojitet zgjerimi i qëllimit të njoftimit të aksidentit për të përfshirë të gjitha aksidentet në punë, dhe të shoqëruara me masa sanksionuese për mosraportim të tyre. Të tilla të dhëna janë tejet të rëndësishme për hartimin e masave parandaluese dhe të aktiviteteve inspektuese.

Ngritja e mekanizmit raportues: Një nga sfidat kryesore në të ardhmen është ngritja e mekanizmit raportues për t'u zhvilluar dhe vënë në zbatim bazuar në sa më poshtë:

- Vlerësimin e platformave aktuale digjitale që përdoren nga ISHPSHSH-ja duke marrë parasysh të gjithë treguesit periodikë të inspektimit. ISHPSHSH që prej vitit 2014 është përdorues i sistemit (unik) *online* të inspektimit “*e-Inspektimi*”, ku pjesë e tij është edhe kontrolli për sigurinë dhe shëndetin në punë. Procedura e inspektimit, realizohet nëpërmjet dokumenteve standarde dhe listave të verifikimit që përdor aktualisht inspektorati i punës. Mbi bazën e listës së verifikimit konstatohen përputhshmëritë shkeljet për të cilat sistemi “*e-Inspektimi*”, lejon këshillimin dhe marrjen e masave, deri në mbylljen e çështjes me vendim përfundimtar. Sistemi “*e-Inspektimi*”, siguron gjenerimin e raporteve për treguesit periodikë të inspektimit, nr. e inspektimeve, shkeljet dhe masat e marra.

- Përcaktimin e nevojave për informacion apo raportim periodik për institucione/role jashtë ISHPSHSH-së, sipas përgjegjësive dhe kompetencave respektive ligjore;

- Zhvillimin e raporteve me të dhëna periodike, me indikatorë inspektimi për palët e treta. Është e rëndësishme që njoftimet, informacioni dhe të dhënat të kontrollohen në mënyrë të kryqëzuar mes inspektorateve, institucioneve prej të cilave ato varen apo nga palët e treta, për të kryer analiza, studime, raportime në institucionet ndërkombëtare apo për të dhëna statistikore.

Rivlerësimin e praktikës së hetimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale: Përmirësimi i mëtejshëm i praktikës së hetimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, në bashkëpunim me homologët e ISHSH-së dhe punëdhënësit është një tjetër sfidë që kërkon angazhimin e këtij institucioni.

Për më tepër, hartimi, rivlerësimi dhe përditësimi i disa akteve e dokumenteve si: plani i veprimit për hetimin e aksidenteve në punë për punëdhënësit dhe



inspektorët e punës; struktura për “Protokollin – aksident në punë” dhe udhëzime të përditësuara për punëdhënësit dhe inspektorët e punës; të dhënat për aksidentet në punë, regjistruar në regjistrin elektronik që mirëmbahet nga ISHPSHSH-ja, janë masat që duhen ndërmarrë me qëllim përmirësimin e praktikës së hetimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Sistemi i rekrutimit dhe trajnimit: Pavarësisht ndryshimeve të parashikuara në ligjin për inspektimin, gjatë procesit të rekrutimit të inspektorëve të rinj, mbetet një sfidë vendosja e një rekrutimi dhe trajnimi të fortë për inspektorët e ISSHP-së, bazuar në një vlerësim të plotë të nevojave për trajnim. Aktualisht ka mangësi në trajnime të strukturuar për inspektorët e ISHPSHSH-së, përfshirë kriteret për rekrutimin, aftësitë e nevojshme, standardet minimale të trajnimit dhe nevojat dhe kriteret për trajnim të vazhdueshëm. Përmirësimi i kushteve të punës për personelin është i domosdoshëm për të zvogëluar rrezikun e “rrjedhjes së trurit” dhe sfidat potenciale që hasen në rekrutimin e inspektorëve të rinj.

Digjitalizimi dhe sistemi i inspektimit online: Zhvillim i mëtejshëm i platformës së e-inspektimit dhe përsheptimi i digjitalizimit të proceseve të ISHPSHSH-së. Aktualisht, sistemi “e-Inspektimi” ka të zhvilluar modulën e riskut sipas metodologjisë së hartuar nga Inspektorati Qendror, dhe ju është prezantuar të gjithë Inspektorateteve shtetërore. Edhe pse platforma është aktualisht funksionale dhe janë në përdorim një matricë inspektimesh e mjetesh dhe metodologji të përparura për vlerësimin e riskut, nevojiten përmirësime të vazhdueshme të këtij sistemi. Në 2–3 vitet në vijim, duhet të vendoset theksi në përmirësimet e sistemit, të moduleve raportuese dhe analizuese në lidhje me SSHP-në, dhe në integrimin në sistem të kriterëve ESAW dhe EODS për mbledhje dhe regjistrim në kohë dhe me saktësi të të dhënave.

Pjesëmarrje në veprimtaritë ndërkombëtare: Rritje e përfshirjes në veprimtaritë ndërkombëtare të inspektimit të punës, si përgatitje për anëtarësimin në Komitetin e Lartë të Inspektimit të Punës (KLIP/SLIC). Aktualisht, pjesëmarrja e ISHPSHSH-së në veprimtaritë ndërkombëtare është e pamjaftueshme për shkëmbim efikas informacioni dhe zhvillim profesional. Pjesëmarrja në veprimtari dhe anëtarësimi potencial në KLIP/SLIC do të ishin mundësi të çmuara për të

zhvilluar punën e ISHPSHSH-së përmes bashkëpunimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira me inspektoratet e tjera të punës. Përveç kësaj, në kuadër të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, do të rriten mundësitë po ashtu edhe detyrimet për anëtarësim dhe pjesëmarrje në veprimtaritë e organizuara nga institucionet evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Ashtu si inspektimi i punës, inspektimi shëndetësor duhet të përshtatet me strukturën e re të inspektimit të miratuar në vend. Megjithatë, më shumë se sa të ndërmarrë hapa si ata që u parashtruan për ISHPSHSH-në, inspektimi shëndetësor duhet të pajiset me mjete dhe trajnime për të trajtuar çështje që lidhen me sëmundjet profesionale dhe mbi të gjitha, për të adresuar masat e nevojshme parandaluese.

ISHSH-ja luan një rol jetësor në garantimin e sigurisë dhe shëndetit publik. Për të rritur performancën e tij nevojitet rritja e kapaciteteve. Forcimi i kapaciteteve të ISHSH-së përqendrohet kryesisht tek aspektet e higijenës, që kanë nevojë për rritje të burimeve dhe të mbështetjes për monitorimin dhe përmirësimin e monitorimit shëndetësor.

Për sa u përket masave trajnuese, ato duhet të fokusohen në ofrimin e trajnimit dhe mbështetjes së mëtejshme të inspektorëve, veçanërisht në fushën e shëndetit në punë, dhe në konsolidimin e formimit mjekësor të inspektorëve, në dhënien e njohurive të specializuara që do t’u mundësojë kryerjen e inspektimeve të plota dhe zbatimin me rigorozitet të rregulloreve.

2.3 Përmirësimi i dialogut social në sigurinë dhe shëndetin në punë

Promovimi i dialogut social në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë është thelbësor për garantimin e mirëqenies së punëmarrësve dhe të mjedisit të sigurt të punës. Përveç ngritjes së KNSSHP-së, me përfshirjen e përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve, është e domosdoshme të trajtohen me kujdes sektorët ekonomikë ku mbizotërojnë aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, veçanërisht në sektorë të rëndë si ndërtimi, bujqësia, minierat dhe transporti. Përveç rrezikshmërisë së lartë të veprimtarive të tyre, këta sektorë shpesh paraqesin probleme të veçanta në lidhje me marrëdhëniet e punës. Ngritja e komiteteve tematike sektoriale



trepalëshe për SSHP-në, struktura të përkohshme pranë Komitetit Ndërmintor, përbëjnë forume të rëndësishme diskutimi për adresimin e kërkesave të sjella në vëmendjen e Komitetit Ndërmintor.

Për të promovuar natyrën kapilare të diskutimit, përveç komiteve sektoriale, është shumë e rëndësishme të forcohen përfaqësimet dhe këshillat e SSHP-së në nivel biznesi. Në kushtet kur kërkohet ngritja e këshillave sipas rregullores, veprimet duhet të përqendrohen në analizën kritike të mënyrës se si zgjidhen përfaqësuesit dhe të efikasitetit të veprimeve të ndërmarra që promovojnë, nëse është e nevojshme, përshtatjet rregullatore apo ligjore për të përmirësuar performancën e tyre dhe efikasitetin e tyre. Në kushtet kur nuk nevojitet një këshillë tillë, është e nevojshme të promovohet procesi i caktimit të përfaqësuesve të punëtorëve të emëruar dhe të zbatohen veprimet që përforcojnë njohuritë e këtyre punëmarrësve për SSHP-në.

Në këtë kontekst, ky dokument politik synon të zhvillojë veprimet e mëposhtme për të përmirësuar dialogun social për SSHP-në:

Komitete trepalëshe për sektor: Ngritja e komiteve sektoriale trepalëshe për SSHP-në për të trajtuar sfidat unike me të cilat përballen sektorë të ndryshëm. Këto komitete duhet të informojnë procesin vendim-marrës të Këshillit Ndërmintor për SSHP-në dhe të fokusohen në sektorët me shpeshtësinë më të madhe aksidenteve apo me raste të nënraportimit, siç janë ndërtimi, bujqësia, minierat dhe transporti. Duke synuar industri specifike, këto komitete mund të përshtatin ndërhyrjet dhe rregulloret e tyre sipas nevojave dhe rrethanave specifike të secilit sektor.

Masa organizative të përfaqësimit të SSHP-së në kategori të ndryshme biznesi: Përmirësimi dhe monitorimi i procesit për caktimin e përfaqësuesve të punëmarrësve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Duhet vlerësuar nëse kuadri ligjor aktual siguron dhe mundëson siç duhet përfaqësimin e punëmarrësve në të gjitha llojet e kompanive, kur nuk ka këshilla SSHP-je. Amendimii rregullave për ta thjeshtuar pjesëmarrjen në këshillat për SSHP do të lehtësojë funksionimin e tyre, veçanërisht në kompanitë e mëdha ku këto komitete janë të mandatuara por jo gjithmonë funksionojnë siç duhet, apo nuk janë të integruara plotësisht në kulturën e vendit të punës siç parashikohet nga Kodi i Punës.

Ngritja e kapaciteteve: Zhvillimi i moduleve gjithëpërfshirëse të trajnimit për dialogun social dhe praktikën më të mira lidhur me SSHP-në, të përshtatura për sindikatat, punëmarrësit, punëdhënësit dhe aktorët e tjerë. Këto module duhet të hartohen për të fuqizuar trajnerët, për të mundësuar përhapjen e njohurive dhe aftësive në nivelin bazë. Pajisja e trajnerëve me mjetet dhe njohuritë e nevojshme bën të mundur efektin kaskadë për të prekur audienca më të gjera dhe promovon kulturën e sigurisë dhe bashkëpunimit në vendin e punës.

Shtylla C: Kthimi në prioritet dhe rritja e ndërgjegjësimit për SSHP-në për të garantuar kushtet e punës së denjë

Në përpjekje për të garantuar kushte të punës së denjë dhe për ta kthyer sigurinë dhe shëndetin në punë në prioritet nevojitet në qasje shumëdimensionale. Në qendër të kësaj nisme është promovimi i *kulturës parandaluese* përmes përhapjes së informacionit dhe rritjes së ndërgjegjësimit. Duke i pajisur punëmarrësit, punëdhënësit dhe përfaqësuesit e tyre me njohuri për rreziqet potenciale dhe protokollat e sigurisë, ata aftësohen për të zvogëluar rreziqet dhe nivelin e rreziqshmërisë dhe për të garantuar mirëqenien e tyre në vendin e punës. Për më tepër, bërja prioritet e edukimit për SSHP-në në të gjitha nivelet, nga punëmarrësit fillestarë te drejtuesit e lartë, është pikë kyçe dhe që lidhet ngushtësisht me veprimtaritë dhe rezultatet e biznesit.

Ky dokument politik nuk kufizohet vetëm te mjedisi i biznesit. Duke integruar parimet e SSHP-së në kurrikulat e arsimit dhe në programet e trajnimit profesional, është e mundur të promovohet kultura e përgjegjësisë dhe e llogaridhënies, ku çdo individ e kupton rolin që ka për të mbajtur mjedisin të punës të sigurt dhe të shëndetshëm. Përpjekjet e bashkërenduara për të rritur ndërgjegjësimin dhe për ta bërë prioritet edukimin për SSHP-në mund të çojnë në një të ardhme ku çdo punëmarrës mund të punojë në vende pune ku u jepet përparësi sigurisë dhe mirëqenies së tyre.

Teoria e ndryshimit në themel të kolonës C parashikon që nëse rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive për SSHP-në mes punëmarrësve, punëdhënësve dhe popullatës së gjerë kthehen në përparësi, mund të arrihen përmirësime të konsiderueshme në sigurinë dhe shëndetin në punë.



Rrugët e mundshme për arritjen e këtij objektivi janë:

Promovim i kulturës parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë përmes përhapjes së informacionit dhe rritjes së ndërgjegjësimit. Duke i pajisur individët me njohuri për rreziqet potenciale dhe protokollet e sigurisë, ata aftësohen për të zvogëluar rrezikshmërinë dhe për të garantuar mirëqenien e tyre në vendin e punës. Gjithashtu, vëmendje do t'u kushtohet edhe rreziqeve ergonomike dhe psikosociale. Kjo qasje parandaluese e sponon fokusin nga masat reaktive në parandalimin proaktiv, duke kontribuar në kushte pune më të sigurta për të gjithë.

Kthimi i edukimit për SSHP-në përparësi në të gjitha nivelet. Duke integruar parimet e SSHP-së dhe informacionin që lidhet me të në kurrikulat/programet mësimore të arsimit të mesëm të lartë, arsimit profesional dhe programet e formimit profesional, çdo individ e kupton rolin që ka për ta mbajtur mjedisin e punës të sigurt e të shëndetshëm, gjë që çon në një kulturë përgjegjësie dhe llogaridhënieje.

3.1 Promovim i kulturës parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nëpërmjet përhapjes së informacionit dhe rritjes së ndërgjegjësimit

Promovimi i kulturës parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë është një nga shtyllat e Konventës nr. 187 të ONP/ILO, si dhe zbatimi në nivel kombëtar i qasjes së menaxhimit të sistemit për sigurinë dhe shëndetin në punë, që ka si synim të ruajë mirëqenien e punëmarrësve dhe që e materializon mjedisin e sigurt e të shëndetshëm të punës si një e drejtë themelore.¹⁷ Nismat për përhapjen e informacionit në shkallë të gjerë dhe për rritjen e ndërgjegjësimit synojnë të rrënjosin qasjen proaktive ndaj sigurisë dhe shëndetit në punë. Zhvillimi i një portali për SSHP-në apo një faqeje në internet me lidhëza që u ofrojnë aktorëve kryesorë informacion lehtësisht të përdorshëm për SSHP-në përfaqëson një masë të rëndësishme në këtë aspekt.

Këto aktivitete për të krijuar kulturën për SSHP-në pasohen nga një plan komunikimi, që përfshin si aktorë kryesorë në përhapjen e mesazhit përfaqësues nga masmedia apo gazetarë të pavarur.

Dy grupeve duhet t'u jepet vëmendje e veçantë: ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe punëmarrësve të vetëpunësuar. Për grupin e parë, zhvillimi i instrumenteve për të mbështetur menaxhimin e SSHP-së, si mjetet e vlerësimit të riskut, instrumentet EU-OSHA OiRa, janë mjaft të vlefshme për t'i ndihmuar këto ndërmarrje të respektojnë kërkesave ligjore dhe të përmirësojnë kushtet në vendin e punës. Veprimet për grupin e dytë do të përqendrohen në përkthimin dhe përshtatjen e informacioneve të nevojshme për profesione të caktuara, siç janë Fletët Ndërkombëtare të të Dhënave për Rreziqet në Profesione¹⁸ të krijuara nga ONP/ILO, të cilat duhet të përshtaten me profesionet dhe kërkesat rregullatore në vend.

Të gjitha këto masa do të shoqërohen me organizimin e veprimtarive, duke e përshtatur kalendarin me ato që tashmë kryhen në Shqipëri, duke iu referuar datave me rëndësi për SSHP-në, por edhe duke zhvilluar veprimtari me institucione të arsimit parauniversitar.

Veprimtaritë e parashikuara në këtë dokument politik i mund të përmbledhen si:

Zhvillimin e një plani komunikimi për SSHP-në: Për këtë nevojitet një qasje e bashkërenduar. Ky plan (përfshirë këtu edhe krijimin e një portali për SSHP-në) do të vërë në përdorim burimet dhe pikat ekzistuese të kontaktit të institucioneve kryesore për t'u ofruar punëdhënësve, punëmarrësve dhe publikut të gjerë informacion të vazhdueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm.

Përfshirjen e përfaqësuesve të masmedias dhe të gazetarëve të pavarur: Bashkëpunimi me përfaqësuesit e masmedias dhe gazetarët e pavarur është jetik për të përforcuar tematikat që lidhen me SSHP-në në informacionin publik. Ngritja e rrjeteve të profesionistëve mediatikë të informuar do të të nxiste mbulimin e çështjeve SSHP në median shqiptare duke rritur kështu ndërgjegjësimin dhe angazhimin publik.

Krijimin e një hapësire të aksesueshme digjitale me informacion mbi SSHP-në: Krijimi i një portali apo vendosjen e lidhëzave në faqen e internetit të një institucioni kyç, nën koordinimin e sekretariatit të

¹⁷ ALLI, Benjamin O. Parimet Themelore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, botimi i dytë; ILO Gjenevë – 2008.

¹⁸ ILO, Faqet e të Dhënave Ndërkombëtare për Profesionet. E disponueshme tek: <https://www.ilo.org/resource/international-hazard-datasheets-occupations-hdo>.



KNSSHP-së me informacion të përditësuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Rishikim dhe përkthim i Fletëve Ndërkombëtare të të Dhënave të ONP/ILO: Të dhënat e aksesueshme për sigurinë janë me mjaft rëndësi me qëllim informimin e punëmarrësve, veçanërisht të atyre në ekonominë informale apo të vetëpunësuarve. Duke përditësuar dhe përkthyer burimet ekzistuese nga Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe agjenci të tjera me rëndësi për SSHP-në, bëhet e mundur shtrirja e informacionit për të arritur audienca më të gjera.

Vënien në zbatim të vlerësimit *online* ndërveprues të riskut (OiRA) apo të instrumenteve të ngjashme për vlerësimin e riskut nga ana e punëdhënësve: Aplikimi i instrumenteve *online* dhe ndërvepruese të vlerësimit të riskut si OiRA u jep mundësinë bizneseve të kryejnë me efikasitet vlerësimin e riskut për SSHP-në. Këto mjete jo vetëm përmirësojnë cilësinë e vlerësimit të riskut por shërbejnë si platforma të vlefshme për rritjen e ndërgjegjësimit, veçanërisht për kompanitë e vogla me burime të kufizuara.

Përdorimi i platformave interaktive në internet të vlerësimit të rrezikshmërisë në vendin e punës (OiRA) ose mjeteve të ngjashme nga punëdhënësit: Përdorimi i mjeteve interaktive të vlerësimit të rrezikshmërisë në internet si OiRA, u mundëson bizneseve të kryejnë vlerësime të plota dhe efikase të rreziqeve dhe nivelit të rrezikshmërisë për SSHP-në. Këto mjete jo vetëm që përmirësojnë cilësinë e vlerësimit të rrezikut, por gjithashtu shërbejnë si platforma të vlefshme për rritjen e ndërgjegjësimit, veçanërisht për kompanitë e vogla me burime të kufizuara.

Organizimi i veprimtarive të përvitshme: Për data të shënuara si 28 prilli – Dita Botërore e ONP/ILO për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe për ditë të tjera të rëndësishme për punën mbahen veprimtari të përvitshme për të rritur angazhimin dhe ndërgjegjësimin e forcës punëtore, bizneseve dhe qytetarëve në përgjithësi. Duke u mbështetur te masmediat miqësore dhe duke bashkëpunuar me aktorët dhe partnerët socialë mund të maksimizohet efekti me minimumin e investimeve financiare.

Veprimtari me institucione të arsimit parauniversitar me tematika për SSHP-në: Edukimi i punëmarrësve, punëdhënësve e qytetarëve të ardhshëm për SSHP-në është mjaft i rëndësishëm. Organizimi i veprimtarive të përvitshme mes

institucioneve të ndryshme të arsimit parauniversitar, në data të shënuara si dita kombëtare e sigurisë dhe shëndetit në institucione të arsimit parauniversitar rrit angazhimin dhe interesin e nxënësve në këtë tematikë. Gjatë kësaj dite mund të organizohen veprimtari të ndryshme si konkurse vizatimi dhe eseje/poezie me këtë temë. Këto nisma promovojnë kulturën e sigurisë qysh në moshë të hershme dhe nxisin pjesëmarrjen aktive në ruajtjen e standardeve të sigurisë dhe shëndetit për punëmarrësit dhe punëdhënësit e ardhshëm.

3.2 Bërja prioritet e edukimit në SSHP-ë në të gjitha nivelet

Veprimet me synim vendin e punës janë thelbësore, por krijimi i kulturës së SSHP-së duhet të kryhet me diskutime dhe promovime të kësaj teme nëpër institucionet e arsimit parauniversitar. Do të zbatohen nisma të ndryshme për të promovuar kulturën e parandalimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale në të gjitha nivelet arsimore. Për këtë qëllim, trajnimi i mësuesve është i domosdoshëm.

Për të adresuar këtë çështje, duhet të ndërmerren nisma në nivele të ndryshme arsimore për të garantuar trajnimin e duhur dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Zhvillim profesional i vazhdueshëm për mësuesit: Kjo ka të bëjë me hartimin e moduleve kurrikulare për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe punën e fëmijëve, të përshtatura për grup-mosha të ndryshme nxënësish. Qëllimi është që të përmirësohen praktikat ekzistuese të trajnimit duke prezantuar aty rreziqet e reja dhe të ardhshme të lidhura me SSHP-në. Kjo garanton pajisjen e mësuesve me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të edukuar siç duhet nxënësit për tematika të tilla.

Integrimi i edukimit për SSHP-në në institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe qendrat e formimit profesional: Prezantimi i SSHP-së, përfshirë punën e fëmijëve, si temë/kurs në institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe qendrat e formimit profesional, ose përditësimi i kurrikulave ekzistuese për SSHP-në duke i harmonizuar me standardet kombëtare të SSHP-së, ato të BE-së dhe ONP/ILO.

Përfshirja e një lënde me zgjedhje për SSHP-në, në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë: Përfshirja e një lënde me zgjedhje për SSHP-në në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë do t'u jepte mundësinë nxënësve të eksplorojnë parime dhe praktika të



sigurisë. Kryerja e sesioneve të specializuara trajnimi për mësuesit që japin njohuri për SSHP-në është garanci për angazhimin efikas të nxënësve.

Integrimi i SSHP-së në institucionet e arsimit të lartë (IAL-të): Prezantimi i SSHP-së si kurs i veçantë apo si grup tematik në IAL-të i përshtatur sipas fushave specifike të studimit. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar plane mësimore gjithëpërfshirëse që adresojnë sfidat e SSHP-së merr rëndësi të veçantë.

Të gjitha këto nisma parashikohen të vijojnë me programe trajnimi për mësuesit për SSHP-në në mënyrë që të garantohet dhënia me efikasitet e kurrikulimit.

KAPITULLI 4 KOSTOT DHE BURIMET E PARASHIKUARA TË FINANCIMIT

Metodologjia e përdorur për përllogaritjen e kostove të Planit të Veprimit SSHP bazohet në metodën e kostimit bazuar në veprimtari.

Kjo metodë përllogarit kostot potenciale si një proces me dy faza:

- i. kostot nga burimet te veprimtaritë; dhe
- ii. kostot nga veprimtaritë tek objektivat.

Kostot e parashikuara për secilën veprimtari përllogariten bazuar në tri kategori kryesore:

- i. kosto periodike;
- ii. burime njerëzore; dhe
- iii. investime.

Identifikimi i burimeve të ndryshme të financimit është gjithashtu një element kyç në ushtrimin e kostimit. U bë i mundur identifikimi i dy burimeve kryesore për financimin e Planit të Veprimit për SSHP-në 2025–2030, si vijon:

1. kontribut i fondeve publike nga buxheti i shtetit, duke përdorur Programin e Buxhetit Afat-Mesëm (PBAM) 2025–2027 me alokime të miratuara dhe të parashikuara për ministritë respektive dhe programet buxhetore, si dhe Programet e Buxhetit Afat-Mesëm (PBAM) 2026–2028, e në vazhdim.

2. kontribut i donatorëve potencialë të cilët veprojnë në fushën e SSHP-së në vend apo dhe ndërkombëtarë.

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për SSHP-në është vlerësuar në **675,878,620 Lekë**, ekuivalente me EUR **6,212,120** si në tabelë:

Kostot në euro dhe lekë/vitet	2025	2026	2027	Vitet në vijim	Totali
Kosto totale në euro	580,573	1,077,613	1,097,233	3,456,700	6,212,120
Kosto totale në ALL (kursi 1 eur = 108.8*)	63,166,342	117,244,331	119,378,987	376,088,960	675,878,620

Për vitin 2025, fondet e nevojshme për zbatimin e këtij plani janë të parashikuara në buxhetin aktual dhe janë të garantuara për përdorim në përputhje me objektivat e përcaktuar. Për periudhën pasuese, që përfshin vitet 2026 dhe 2027, realizimi financiar i planit do të mbështetet në alokimet që do të përcaktohen në kuadër të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028. Gjithashtu, burimet e financimit mund të plotësohen nga rialokime të brendshme gjatë viteve përkatëse, në varësi të prioriteteve të politikave dhe mundësive buxhetore.

Përveç këtyre burimeve, një pjesë e zbatimit të planit do të mbështetet edhe nga donatorë të jashtëm, me të cilët jemi aktualisht në faza aktive diskutimesh. Këto diskutime kanë për qëllim të sigurojnë mbështetje të dedikuar për disa prej komponentëve kyç të planit, duke plotësuar fondet e alokuara nga buxheti i shtetit dhe duke garantuar një realizim më efektiv dhe të qëndrueshëm të objektivave të përcaktuar.

Analiza e kostove dhe burimeve të financimit të parashikuara do të kryhet më 2027-n, brenda kuadrit të rishikimit afat-mesëm të zbatimit të Dokumentit Politik të SSHP-së.

Në përfundim, vlerësimi i impaktit buxhetor në zbatimin e Planit të Veprimit do të zhvillohet më tej kur të përgatitet raporti përfundimtar për vlerësimin e përgjithshëm të zbatimit të tij dhe do të mbulojë periudhën kohore 2025–2030.

KAPITULLI 5 MEKANIZMAT E LLOGARIDHËNIES, MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Ky dokument politik dhe plan veprimi është produkt i përpjekjeve ndërinstitucionale dhe bashkërenduese. Si rrjedhojë, monitorim-vlerësimi i tij do të kryhet me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të përfshira në këtë proces. Këshilli Ndërmnistror për SSHP-në (KNSSHP) do të jetë organi mbikëqyrës i zbatimit të këtij dokumenti politik dhe do të



monitorojë dhe kontrollojë zbatimin e veprimtarive të përfshira në Planin aktual të Veprimit për SSHP-në.

Për secilin objektiv të këtij dokumenti politik caktohet një institucion përgjegjës, i cili ka rolin e bashkërendimit me institucionet e tjera të përfshira në kryerjen e veprimtarive të parashikuara për secilin objektiv. Për të vënë në lëvizje bashkërendimin në fjalë, është e nevojshme që secili institucion të caktojë një pikë kontakti e cila do të jetë përgjegjëse për të raportuar në faza tremujore në lidhje me ecurinë e veprimtarive në institucionet e tyre respektive, raportim ky që do të kryhet pranë pikës së kontaktit të institucionit përgjegjës për objektivin në fjalë.

Çdo vit, pika e kontaktit për secilin objektiv do të dorëzojë një raport të pjesshëm në fund të çdo semestri dhe një raport të konsoliduar vjetor pranë Sekretariatit të Këshillit, duke detajuar ecurinë e veprimtarive që lidhen me objektivin e tyre. Këshilli do të vlerësojë raportet e marra dhe do të dalë me një deklaratë. Nëse shihet e nevojshme, mund të

bëjë rekomandimet për veprimtari shtesë që do të garantonin arritjen me sukses të objektivave.

Vlerësimi afat-mesëm (2027) i Dokumentit Politik të SSHP-së dhe planit të tij të veprimit do të kryhet për të matur ecurinë e zbatimit të këtij dokumenti, duke vlerësuar dobishmërinë dhe fizibilitetin e indikatorëve ekzistues dhe duke zhvilluar indikatorë të rinj aty ku shihet e nevojshme. Vlerësimi përfundimtar është planifikuar të kryhet në vitin 2030 dhe do të realizohet për të vlerësuar suksesin në total të zbatimit të Planit të Veprimit (eficiencën dhe efikasitetin) si dhe për aq sa është e mundur për të vlerësuar impaktin e politikave të parashikuara në këtë dokument.

Përveç vetëmonitorimit dhe monitorimit të vazhdueshëm, duhet të merren masa për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin nga vlerësues të pavarur, veçanërisht për vlerësimin afatmesëm dhe atë përfundimtar.

SHTOJCAT

SHTOJCA A: Plani i Veprimit dhe Treguesit, 2025–2030

SHTOJCA B: Përkufizimet



Tabela 1: Përmbledhje e objektivave strategjike të propozuara nga Dokumenti Politik për SSHP-në 2025–2030

PLANI I VEPRIMIT					
Shtylla A – Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë me sfidat aktuale dhe ato të ardhshme.					
Treguesi i impaktit A.a: Ndryshimi në shpejtësinë dhe efektivitetin e reagimit institucional ndaj rreziqeve të reja në SSHP-në.					
Treguesi i impaktit A.b: Ndryshimi në gatishmërinë për të adresuar rreziqet në punë në të ardhmen (p.sh. ndryshimet teknologjike, kushtet e reja të punës, rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike).					
Prioriteti strategjik A1: Përmirësimi i kuadrit ligjor për SSHP-në					
Treguesi i rezultatit A1: Shkalla e plotësisë së institucioneve të SSHP-së dhe e sistemit efektiv për SSHP.					
Objektivi A1.1: Krijimi dhe funksionimi i rregullt i Këshillit Ndërmënyor për SSHP-në (KNSSH) në përputhje me ligjin për SSHP-në					
Treguesi A.1.1 Shkalla e funksionimit (takime dhe vendime të kërkuara) të KNSSH-së sipas afateve.					
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Organizata përgjegjëse: MEKI Kostot e parashikuara	Periudha e zbatimit 2025–2030 Treguesit	Afati i fundit/periudha e zbatimit
A.1.1.1	Ngritja e Këshillit Ndërmënyor për SSHP-në (KNSSH)	MEKI, ministritë e përfshira.	12,800 euro		Q2 2025
	Hartimi dhe dorëzimi i Urdhrit të Kryeministrit për ngritjen e Këshillit Ndërmënyor të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (KNSSH), i cili përmban qëllimin, objektivat, strukturën dhe përgjegjësitë e Këshillit.			Statusi i hartimit të Urdhrit të Kryeministrit për të ngritur KNSSH-në dhe dorëzimi pranë Kryeministrit.	
	Rishikim dhe miratim i Urdhrit për ngritjen e Këshillit Ndërmënyor të SSHP-së (KNSSH) nga Kryeministri.			Urdhri i Kryeministrit i firmosur dhe publikuar në fletoren zyrtare.	
	Ngritja e Sekretariatit të KNSSH-së.			Gatishmëria operationale e Sekretariatit matet me: * Numri (x nga y) i pozicioneve të personelit të sekretariatit që janë të plotësuar; * Burimet e nevojshme financiare të vëna në dispozicion (apo të alokuara nga buxheti).	
	Miratimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe procedurave standarde të funksionimit (PSF-të) të KNSSH-së.			* Statusi i miratimit zyrtar të rregullave dhe PSF-ve për funksionimin e KNSSH-së. * Shkalla e përputhjes me rregullat dhe PSF-të e funksionimit të KNSSH-së, siç evidentohet në vlerësimet periodike (vjetore).	
A.1.1.2	Takime sistematike të Këshillit siç përcaktohet në rregullat e Këshillit dhe të PSF-të përfshirë ato ku marrin pjesë organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve.	MEKI, ministritë e përfshira, Sekretariatit për SSHP-në, Organizatat e Punëdhënësve dhe Punëmarrësve.	13,000 euro	Numri i takimeve të organizuara, krahasuar me takimet e planifikuara.	2025–2030
	Organizimi dhe bashkërendimi i takimit të KNSSH-së. Këtu përfshihet përgatitja e programit dhe shpërndarja e tij; dërgimi i ftesave dhe konfirmimi i pjesëmarrjes së të ftuarve për të garantuar gjithëpërfshirjen dhe angazhimin.			Numri i anëtarëve të KNSSH-së të ftuar, i përfaqësuesve të institucioneve dhe partnerëve, të cilët marrin pjesë në takim.	Q4 2025
	Hartimi dhe miratimi i planit vjetor për takimet e KNSSH-së duke përkrahur me hollësi tematikat, shpeshësinë, datat e takimeve dhe të komunikimeve për të informuar palët për planin.			Statusi i hartimit dhe miratimit të planeve vjetore.	
A.1.1.3	Monitorim dhe vlerësim i zbatimit të Dokumentit Politik për SSHP-në	MEKI, përfaqësues të Organizatave të Punëmarrësve dhe Punëdhënësve në KNSSH	74,880 Euro	Përqindja e arritjeve të objektivave të ndërmjetëm të Dokumentit të Politikave të SSHP-së krahasuar me objektivat e planifikuara brenda afateve të përcaktuara.	2025–2030
	Ngritja e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit (M&V) për Dokumentin Politik të SSHP-së.			Përqindja e komponentëve të planifikuar të mekanizmit të M&V, të cilët janë të ngritur dhe plotësisht operationale.	Q3 2025
	Diskutim dhe miratim i: Raportëve vjetore për zbatimin e Dokumentit Politik të SSHP-së duke përdorur të dhëna të gjeneruara nga mekanizmi M&V; Prioriteteve të përditësuara të SSHP-së për vitin në vijim.			Statusi i miratimit të raportit vjetor për zbatimin e Dokumentit Politik të SSHP-së nga anëtarët e KNSSH. Numri i prioriteteve të përditësuara për vitin në vijim që diskutohen dhe miratohen nga KNSSH.	2025-2030
	Bërja e raporteve vjetore të aksesueshme nga publiku dhe shpërndarja e tyre të gjithë aktorët, përfshirë anëtarët e KNSSH, organizatat e Punëmarrësve dhe Punëdhënësve.			Përqindja e raporteve vjetore të publikuara online brenda 90 ditëve të fundit të vitit fiskal.	2025-2030
	Vlerësimi afat-mesëm i zbatimit të Dokumentit Politik të SSHP-së			Statusi i përfundimit të vlerësimit afat-mesëm për zbatimin e për Dokumentin Politik të SSHP-së.	Q3 2027
A.1.1.4	Ngritja e kapaciteteve të Sekretariatit të KNSSH-së dhe "Pikave të Kontaktit" që përfaqësojnë ministritë në rrjetin e SSHP-së.	MEKI, MSHMS-ja dhe të gjitha ministritë sipas fushës së ekspertizës dhe përgjegjësisë.	67,700 Euro	Numri i anëtarëve të Sekretariatit të KNSSH-së dhe i pikave të kontaktit në ministritë pjesëmarrëse, të cilët janë trajnuar kundrejt numrit total të anëtarëve të tij.	Q4 2025
	Zhvillimi i programit trajnues për ngritjen e kapaciteteve për sekretariatit e KNSSH-së dhe pikave të kontaktit.			Statusi i përfundimit të zhvillimit të programit trajnues për ngritjen e kapaciteteve, përfshirë materialet kurrikulare dhe metodat e organizimit.	Q1 2025



	Trajnimi i punonjësve të sekretariatit të KNSSH-pë për përgatitjen, zbatimin dhe ndjekjen e rregullave dhe procedurave për takimet e KNSSH-pë.			Numri i anëtarëve të trajnuar të Sekretariatit që kanë implementuar me sukses trajnimin në përgatitjen, zhvillimin dhe pjesëmarrjen në takimet e KNMSSH-pë brenda gjashtë muajve kundrejt numrit total të tyre.	Q2 2025
	Trajnimi i pikave të kontaktit të Ministrive, pjesë e rrjeteve të SSHP-së, dhe punonjësve të sekretariatit për çështje lokale, rajonale, sektoriale dhe profesionale që kanë të bëjnë me SSHP-në.			Numri i pikave të kontaktit dhe sekretariatit të cilët kanë përfunduar trajnimin për çështje lokale, rajonale, sektoriale dhe profesionale që kanë të bëjnë me SSHP-në, kundrejt numrit të tyre në total.	Q4 2025
Objekti A1.2: Harmonizimi i kuadrit rregullator në vend për procesin e anëtarësimit në BE. Treguesi i rezultati A1.2 Përqindja e përputhshmërisë me standardet rregullatore të BE-së deri më 2030.					
			Organizata përgjegjëse: MEKI, MSHMS, ministritë e përfshira	Periodha e Zbatimit 2025–2030	
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periodha e zbatimit
A.1.2.1	Harmonizimi i kuadrit ligjor të SSHP-së me <i>acquis</i> e BE-së	MEKI, MSHMS, KNSSH dhe ministritë e përfshira	36,700 Euro	Përqindja e akteve të harmonizuara me <i>acquis</i> të BE-së për SSHP-në, kundrejt numrit total të planifikuar në Planin Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE) brenda afateve të këtij Dokumenti Politikash.	Q4 2030
	Përditësimi i analizës së mangësive bazuar në raportimin për kapitullin 19.			Statusi i plotësimit të analizës së përditësuar të mangësive bazuar në raportimin për kapitullin 19.	Q2 2025
	Përgatitja e ndryshimeve ligjore, sipas analizës së mangësive, nga grupet e punës të caktuara nga ministritë e përfshira.			Numri i ndryshimeve ligjore të hartuara dhe gati për shqyrtim krahasuar me numrin e synuar nga analiza e mangësive.	Q4 2025 – Q4 2028
	Miratimi i ndryshimeve ligjore			Numri i ndryshimeve ligjore zyrtarisht të miratuara nga autoritetet kryesore krahasuar me numrin e synuar nga analiza e mangësive.	Q4 2026 – Q1 2030
A.1.2.2	Ratifikimi dhe nisja e zbatimit të konventave të ONP/ILO.	MEKI, ministritë e përfshira	100,000 euro	* Statusi i ratifikimit të konventave të ONP/ILO (161, 188 dhe 189) * Statusi i zbatimit të konventave të ONP/ILO: 161, 188, 189, dhe 190.	2025-2030
	Kryerja e analizës së mangësive të kuadrit rregullator për të mbështetur ratifikimin e konventave të ONP/ILO: 161, 188 dhe 189.			Statusi i përfundimit të raportit të analizës së mangësive.	Q4 2025
	Kryerja e analizës së mangësive të kuadrit rregullator për zbatimin e Konventës 190 në lidhje me risqet psikosociale.			Statusi i kryerjes së raportit të analizës së mangësive.	Q4 2025
	Advokimi për ratifikimin e konventave: 161, 188, 189.			Përqindja e veprimtarive kryesore të advokimit të përfunduara për të mbështetur ratifikimin e konventave 161, 188 dhe 189, si takime me aktorët, përmbledhje të politikave dhe fushata publike.	2025-2030
A.1.2.3	Zbatimi i udhëzimeve të ONP/ILO	MEKI/ISHPSHSH, ONP/ILO	87,520 euro		Q4 2026
	Përgatitja dhe dhënia e kursit të trajnimit për Inspektoratin e Punës për inspektimin e kantierëve të ndërtimit bazuar në udhëzimet e përditësuara të ONP/ILO			Numri i inspektorëve të punës që të kanë përfunduar kursin për inspektimin e kantierëve të ndërtimit bazuar në udhëzimet e rishikuara të ONP/ILO kundrejt numrit total të inspektorëve të synuar. Përqindja e pjesëmarrësve të cilët e kanë vlerësuar kursin si efektiv dhe shumë efektiv.	Q2 2025
	Organizimi dhe kryerja e veprimtarive për mirënjohje dhe ndërgjegjësim për të përhapur informacionin që përmban Kodi i Praktikës së ONP/ILO për sektorin e veshjeve e tekstilëve dhe udhëzimet e rishikuara të ONP/ILO për sektorin e ndërtimit.			Numri i veprimtarive të planifikuara për rritjen e ndërgjegjësimin të kryera për të përhapur informacionin që përmban Kodi i Praktikës së ONP/ILO për sektorin e veshjeve dhe Tekstileve dhe udhëzimet e rishikuara të ONP/ILO për Ndërtimin.	2026
Prioriteti Strategjik A2: Përmirësimi i sistemeve për hetimin dhe raportimin e aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale					
Treguesi i efektit A2: Numri i politikave, rekomandimeve, veprimeve parandaluese të reja apo të rishikuara bazuar në të dhënat e RASP-it.					
Objekti A2.1: Zhvillimi i Regjistrat Kombëtar të Aksidenteve në Punë dhe Sëmundjeve Profesionale (RASP) bazuar në Kriteret e ESAW dhe EODS					
Treguesi i rezultati A2.1: Përqindja e fushave të të dhënave të kërkuara nga ESAW dhe EODS të përfshira në RASP.					
			Organizatat përgjegjëse: MEKI, ISHPSSH, ISSH, MSHMS, ISHP, ISHSH, INSTAT	Periodha e Zbatimit 2025–2028	
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periodha e zbatimit
A.2.1.1	Krijimi dhe përdorimi i një mekanizmi ligjor për administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave për aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale.	INSTAT, MEKI, ISHPSHS, MSHMS, Sigurimet Shoqërore, ISHP-ja, ISHSH-ja, AKSHI, etj.	380,000 euro	* Statusi i ngritjes së mekanizmit ligjor për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave për aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale në dispozicion të aktorëve kryesorë.	Q4 2026



				* Numri i institucioneve dhe organizatave, grupeve të interesit (p.sh. organizma rregullatorë, punëdhënës, organizata shëndetësore) të cilat po përdorin në mënyrë aktive mekanizmin e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave për të aksesuar dhe shkëmbyer informacionin për aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale.	Q4 2030
	Vlerësim i sistemit aktual të njoftimit dhe hetimit të aksidenteve në punë, përfshirë kapacitetet e burimeve njerëzore.			Statusi i kryerjes së vlerësimit të planifikuar sistemit aktual të njoftimit dhe hetimit të aksidenteve në punë (p.sh. procedurat, cilësia e të dhënave, reagimi i aktorëve).	Q4 2025
	Vlerësimi i sistemit aktual të deklarimit dhe raportimit të sëmundjeve profesionale, përfshirë kapacitetet e burimeve njerëzore.			Statusi i kryerjes së vlerësimit të planifikuar të deklarimit dhe raportimit të sëmundjeve profesionale (p.sh. procedurat, cilësia e të dhënave, reagimi i aktorëve).	Q4 2025
	Rivlerësimi i sistemit të informacionit, për njoftimin dhe hetimin e aksidenteve në punë dhe deklarimin dhe raportimin e sëmundjeve profesionale dhe zbatimit i tij.			Statusi i rivlerësimit dhe zbatimit të sistemit të informacionit, për njoftimin dhe hetimin e aksidenteve në punë dhe deklarimin dhe raportimin e sëmundjeve profesionale.	Q4 2026
A.2.1.2	Zhvillimi i Regjistrit Kombëtar të Aksidenteve në Punë dhe Sëmundjeve Profesionale bazuar në ESAW dhe EODS.	MEKI, ISHPSHS, INSTAT, MSHMS, Sigurimet Shoqërore	160,000 euro	Statusi i përfundimit të krijimit të sistemit dhe të specifikimeve, përfshirë strukturën e bazës së të dhënave, fushat e të dhënave, dhe përputhshmërinë me standardet e ESAW dhe EODS.	Q4 2029
	Përgatitja e amendimeve të rregullores aktuale për aksidentet në vendin e punës përfshirë informacionin që kërkon metodologjia e ESAW për mbledhjen e të dhënave.			Përqindja e amendimeve të nevojshme të përgatitura dhe të gatshme për miratimin rregullator të regjistrit kombëtar për aksidentet në punë në përputhje me e ESAW.	Q4 2026
	Rishikim i sistemit të njoftimit dhe regjistrimit për sëmundjet profesionale dhe propozimi i ndryshimeve në përputhje me kërkesat e Statistikave Evropiane të Sëmundjeve Profesionale (EODS).			Statusi i rishikimit të sistemit të njoftimit dhe regjistrimit të sëmundjeve profesionale.	Q4 2026
	Ngritja e një sistemi informativ të ndërlidhur për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave të aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale që përdor metodologjinë ESAW dhe EODS.			Statusi i ngritjes së sistemit informativ që ndërlidh mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave të aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale.	Q4 2027
	Ndërlidhja e sistemit të informacionit, duke marrë parasysh të dhënat e shkëmbyeshme, me sistemin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale dhe centralizimi i RASP duke marrë në konsideratë informacionin e kërkuar nga ESAW dhe EODS.			Statusi i përfundimit të ndërlidhjes së sistemeve të informacionit dhe centralizimit të të dhënave në RASP sipas standardeve të ESAW dhe EODS.	Q4 2027
A.2.1.3	Ngritja e kapaciteteve të institucioneve kryesore në lidhje me dokumentimin e aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale	MEKI, ISHPSHS, INSTAT, MSHMS, Sigurimet Shoqërore, Sindikatat, Punëdhënësit, profesionistët e SSHP-së, Policia e Shtetit.	224,000 euro	Numri i personelit të institucioneve kryesore të cilët kanë plotësuar orët e nevojshme të trajnimit në lidhje me regjistrimin e aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale.	Q4 2028
	Zhvillimi i udhëzimeve dhe materialeve për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për punëdhënësit dhe sindikatat.			Përqindja e punëdhënësve dhe sindikatave që kanë akses tek udhëzimet dhe materialet mbi aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale.	Q4 2027
	Trajnime dhe fushata ndërgjegjësuere për aktorët kryesorë në sektorët publikë dhe privatë.			Numri i (a) veprimtarive për rritjen e ndërgjegjësimit për SSHP-në dhe (b) numri i personelit të trajnuar për zbatimin e udhëzimeve.	Q4 2028
Prioriteti Strategjik A3: Ngritja e sistemit për trajnimin, certifikimin e ekspertëve dhe licencimin e shërbimeve për SSHP-në.					
Treguesi i impaktit A3: "Përqindja e bizneseve që përdorin profesionistët e certifikuar dhe shërbimet e licencuara për SSHP-në të cilat zbatojnë rregulloret dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë krahasuar me ato që nuk i përdorin këta specialistë dhe shërbime (numri i inspektimeve të ISHPSHS-së & ISHSH-së)".					
Objektivi A3.1: Zbatimi i programit të trajnimit dhe ngritja e një sistemi regjistrimi funksional për certifikimin dhe licencimin e shërbimeve të profesionistëve për SSHP-në.					
Treguesi i rezultatis 3.1.1: Numri total i ekspertëve të SSHP-së të cilët kanë përfunduar me sukses procesin e certifikimit.					
Treguesi i rezultatis 3.1.2: Përqindja e ofruesve të shërbimeve për SSHP-në të cilët kanë marrë licencën zyrtare.					
			Organizatat përgjegjëse: MEKI, ISHPSHS, MSHMS, ISHSH, DPA	Periodha e Zbatimit 2025–2029	
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periodha e zbatimit
A.3.1.1	Ngritja dhe zbatimi i kuadrit të trajnimit dhe certifikimit për profesionistët e SSHP-së dhe të licencimit të shërbimeve në një sektor të synuar.	MEKI, ISHPSHS, MSHMS, ISHSH, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	143,760 euro	* Statusi i programeve të trajnimit dhe certifikimit për profesionistët e SSHP-së që janë hartuar, miratuar dhe zhvilluar në një sektor të synuar. * Statusi i ngritjes së një mekanizmi licencimi për shërbimet SSHP të hartuara dhe implementuara në një sektor të synuar, përfshirë kriteret dhe procedurat e licencimit.	Q4 2027
	Kryerja e një analize krahasimore të sistemeve dhe praktikave të vendeve të tjera që sigurojnë cilësi të lartë të ekspertëve dhe shërbimeve të SSHP-së.			Raporti i analizës krahasimore i përfunduar dhe dorëzuar KNSSH-së.	Q3 2025
	Identifikimi i mangësive kryesore në cilësinë e shërbimeve dhe ekspertëve të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP) brenda njësitë të bizneseve.			Statusi i përfundimit dhe dorëzimit të KNSSH-ja të raportit mbi identifikimin dhe dokumentimin e mangësive kryesore në shërbimet dhe ekspertët e SSHP-së.	Q4 2025



	Formulimi i kompetencave dhe zhvillimi i një kurrikule dhe programi të strukturuar trajnimi të përshtatur për nevojat e ndryshme të profesionistëve të SSHP-së së një sektori të caktuar.			Statusi i përfundimit të ngritjes së kuadrit të kompetencave, kurrikulës dhe programit të trajnimit për nevojat e profesionistëve të SSHP-së.	Q2 2026
	Formulimi i kriterëve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve për SSHP-në në një sektor të synuar.			Statusi i përfundimit të formulimit të kriterëve për kryerjen e shërbimeve për SSHP-në në një sektor të synuar.	Q2 2026
	Zhvillimi i procesit të certifikimit të profesionistëve dhe licencimit të shërbimeve për SSH-në për sektorin e synuar.			Statusi i zhvillimit të procesit të (a) certifikimit të profesionistëve dhe (b) licencimit të shërbimeve për SSHP-në në një sektor të synuar.	Q4 2026
	Përshtatja e rregullores kombëtare për ta bërë të zbatueshëm procesin e certifikimit dhe licencimit në fushën e SSHP-së në sektorin e synuar.			Statusi i përshtatjes së rregullores kombëtare për të mbështetur certifikimin dhe licencimin në fushën e SSHP-së në sektorin e synuar.	Q2 2027
	Zbatimi i procesit të certifikimit dhe licencimit në fushën e SSHP-së për sektorin e synuar.			Numri total i ekspertëve të SSHP-së të cilët kanë përfunduar me sukses procesin e certifikimit në sektorin e synuar. Përqindja e ofruesve të shërbimeve SSHP të cilët kanë marrë licencat në sektorin e synuar.	Q4 2027
	Vlerësim i procesit të zbatuar për certifikimin dhe licencimin në fushën e SSHP-së në sektorin e synuar dhe i fizibilitetit të shtrirjes së këtij procesi në gjithë sektorët.			Statusi i kryerjes së studimit të fizibilitetit për shtrirjen e proceseve të certifikimit dhe licencimit në fushën e SSP-së në të gjithë sektorët.	Q4 2027
A.3.1.2	Shkallëzimi i kuadrit të trajnimit dhe certifikimit për profesionistët për SSHP-në dhe të licencimit të shërbimeve në sektorë të tjerë apo në të tërë sektorët.	MEKI, ISHPSHS, MSHSHS, ISHSH, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1,581,360 euro	* Statusi i programeve të certifikimit për profesionistët e SSHP-së të cilët janë hartuar, miratuar dhe zhvilluar në të gjithë sektorët e synuar. * Statusi i mekanizmit të licencimit për shërbimet SSHP të zhvilluar dhe implementuar, përfshirë kriteret dhe procedurat për licencimin në të gjithë sektorët e synuar.	Q4 2029
	Formulimi i kompetencave të kërkuara dhe zhvillimi i programit të trajnimit të përshtatur sipas nevojave të ndryshme të profesionistëve të SSHP-së.			Statusi i përfundimit të ngritjes së kuadrit të kompetencave, hartimit të kurrikulës dhe programit të trajnimit të përshtatur sipas nevojave të ndryshme të profesionistëve të SSHP-së në të gjithë sektorët e tjerë të synuar.	Q1 2029
	Formulimi i kriterëve specifike sipas fushave, për shërbimet për SSHP-në në të gjithë sektorët e tjerë të synuar.			Statusi i përfundimit të formulimit të kriterëve për shërbimet për SSHP-në në të gjithë sektorët e tjerë të synuar.	Q1 2029
	Përshtatja e procesit të certifikimit të profesionistëve dhe licencimit të shërbimeve për SSHP-në për të gjithë sektorët e tjerë të synuar.			Statusi i përshtatjes së procesit të certifikimit të profesionistëve dhe licencimit të shërbimeve të SSHP-së në të gjithë sektorët e tjerë të synuar.	Q2 2029
	Përshtatja e rregullores kombëtare në mbështetje të procesit të certifikimit të profesionistëve dhe licencimit të shërbimeve për SSHP-në për të gjithë sektorët e tjerë të synuar.			Statusi i përshtatjes së rregullores kombëtare në mbështetje të procesit të certifikimit të profesionistëve dhe licencimit të shërbimeve për SSHP-në për të gjithë sektorët e tjerë të synuar.	Q2 2029
	Vënia në zbatim e procesit të certifikimit të profesionistëve dhe licencimit të shërbimeve për SSHP-në për të gjithë sektorët e tjerë të synuar.			* Numri total i profesionistëve për SSHP-së të cilët kanë përfunduar me sukses procesin e certifikimit në të gjithë sektorët e tjerë të synuar. * Përqindja e ofruesve të shërbimeve për SSHP-në që kanë marrë licencën zyrtare në të gjithë sektorët e tjerë të synuar.	Q4 2029
Shtylla B: Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për garantuar kushte pune të denjë.					
Treguesi i impaktit B.a: Ndryshimi në përqindje e bizneseve që janë në përputhje me standardet SSHP-së gjatë inspektimeve të ISHPSHS-së dhe ISHSH-së.					
Treguesi i impaktit B.b: Ndryshimi vjetor në përqindje i aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.					
Prioriteti strategjik B1: Forcimi i kapaciteteve të institucioneve politikbërëse dhe zbatuese.					
Objekti B1.1: Rritja e kapacitetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për SSHP-në					
Organizata përgjegjëse: MSHMS, ISHP, ISHSH, QSUT/5 Spitalet Rajonale					
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periudha e Zbatimit
B.1.1.1	Forcimi i strukturës ekzistuese brenda MSHMS-së me detyrë adresimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.	MSHMS		Statusi i aktual i strukturës brenda MSHMS-së dhe ISHP-së me detyrë të posaçme adresimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.	Q2 2026
	Forcimi i strukturës ekzistuese në MSHMS të ngarkuar me detyrën e adresimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.				Q2 2025
B.1.1.2	Ringritja e strukturës përgjegjëse për deklarimin e sëmundjeve profesionale	MSHMS / QSUT/5 Spitalet Rajonale	362,000 euro	Statusi i zbatimit të ndryshimeve që nevojiten për të ringritur strukturën përgjegjëse për deklarimin e sëmundjeve profesionale.	Q2 2026
	Trajnimi i mjekëve specialistë për identifikimin e sëmundjeve profesionale dhe SSHP-në në mjedisin e punës.			Përqindja e mjekëve, të cilët kanë përfunduar programin trajnues për sëmundjet profesionale dhe SSHP-në.	Q2 2027
	Riaktivizimi i Shërbimit Kombëtar për Sëmundjet Profesionale (Kabineti për Sëmundjet Profesionale) pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) përmes: * Alokimit, rehabilitimit dhe pajisjes së ambienteve të QSUT-së. * Trajnimi i personelit shëndetësor të kabinetit			* Përqindje e personelit mjekësor që ka përfunduar programin trajnues për identifikimin e sëmundjeve profesionale dhe SSHP-në në mjedisin e punës. * Statusi i rehabilitimit dhe pajisjes së ambienteve të QSUT-së dhe 5 spitaleve rajonale për të garantuar shërbimin për sëmundjet profesionale.	Q2 2027



				* Përqindja e pajisjeve (mjekësore dhe laboratorike) të nevojshme të instaluar dhe funksionale.	
	Riaktivizim i Kabineteve të Sëmundjeve Profesionale në pesë spitalet rajonale për të garantuar aksesin në shërbime për shëndetin në punë për të gjithë punëmarrësit në të gjitha rajonet.			Numri i spitaleve rajonale me shërbime funksionale të kabineteve të sëmundjeve krahasuar me numrin e spitaleve të synuar.	Q2 2027
	Alokim, rehabilitim dhe pajisje e ambienteve në 5 spitalet rajonale.			Ndryshimi me përqindje e numrit të punëmarrësve që kanë akses në shërbime për shëndetin në punë krahasuar me pikën fillestare.	Q1 2030
B.1.1.3	Fuqizimi i Institutit të Shëndetit Publik	MSHMS, ISHP, ISHSH	90,060 euro	Shkalla e gatishmërisë së ISHP-së për të kryer me efektivitet detyrat që lidhen me shëndetin në punë.	Q4 2026
	Rritja e aftësive për të vlerësuar me rigorozitet rreziqet në punë dhe rrezikshmërinë ndaj shëndetit dhe për të kryer monitorim të plotë në lidhje me shëndetin në punë duke: * Ngritur laboratorin e toksikologjisë * Pajisur atë me instrumente matëse specifike për mjedisin e punës * Trajnuar personelin e laboratorit * Trajnuar personelin/specialistët e shëndetit në punë/ shëndetit publik/ mjedisit për SSHP-në			* Shkalla e garantimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të nevojshme për laboratorin e toksikologjisë me qëllim kryerjen e kontrollit periodik të shëndetit në punë (monitorimit) të plotë të rasteve të lidhura me faktorët përcaktues dhe shëndetin në punë. * Përqindja e protokolleve themelore laboratorike të cilat janë në vend dhe gjendje pune. * Përqindja e personelit të laboratorit që ka kryer të paktën 16 orë trajnimi të lidhur me shëndetin në punë dhe sëmundjet profesionale.	Q4 2026
B.1.1.4	Zhvillimi dhe Zbatimi i Sistemit Digital të të Dhënave të Shëndetit në Punë	MSHMS, ISHP, ISHSH	360,000 Euro		Q1 2027
	Trajnimi i mjekëve në ndërmarrje dhe mjekëve të kabineteve për dokumentacionin shëndetësor dhe informimin e duhur të strukturave përgjegjëse shtetërore, si dhe për procedurat për survejimin shëndetësor me fokus shëndetin në punë.			Numri i mjekëve në ndërmarrje dhe mjekëve të kabineteve të trajnuar për procedurat për dokumentacionin dhe informimin dhe survejimin shëndetësor me fokus shëndetin në punë krahasuar me numrin total të synuar.	Q1 2027
	Rishikim i të dhënave shëndetësore digjitale të lidhura me shëndetin në punë.			Statusi i nshikimit të të dhënave shëndetësore digjitale të lidhura me shëndetin në punë.	Q1 2028
	Përmirësimi i sistemit digital të të dhënave për shëndetin në punë për të standardizuar procesin në mënyrë që mjekët e punës/sëmundjeve profesionale dhe specialistët e shëndetit në punë/ shëndetit publik/shëndetit dhe mjedisit për SSHP-në të mund të menaxhojnë dhe analizojnë me efektivitet të dhënat e pacientëve, të monitorojnë rreziqet në vendin e punës dhe tendencat të lidhura me shëndetin në punë.	-		* Përqindja e mjekëve të punës/të sëmundjeve profesionale/ specialistët e shëndetit në punë/ shëndetit publik/ mjedisit për SSHP-në, të cilët përdorin rregullisht sistemin digital të të dhënave të pacientëve të përmirësuar. * Ndryshimi në saktësinë e të dhënave për rreziqet në punë dhe sëmundjet profesionale. * Numri i raporteve mbi rreziqet dhe sëmundjet profesionale krahasuar me numrin e raporteve para përmirësimit të sistemit digital të të dhënave për shëndetin në punë.	Q4 2027
	Lehtësim i qarkullimit të informacionit në lidhje me rreziqet në punë			* Shkalla e aksesueshmërisë së informacionit në lidhje me rreziqet në punë. * Shkalla e rëndësisë së informacionit të aksesueshëm në lidhje me rreziqet në punë.	Q4 2027
Objekti B1.2: Hartimi dhe zhvillimi i kurseve dhe programeve të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë					
Treguesi B1.2: Shkalla e përmirësimit të njohurive dhe zbatimeve praktike për SSHP-në të punonjësit të cilët kanë përfunduar programet e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë.					
Organizata përgjegjëse: MSHMS, ISHSH, ISHP, Fakulteti i Mjekësisë, MAS		Perioda e zbatimit 2025-2030			
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/perioda e Zbatimit
B.1.2.1	Zbatimi i programit të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë për nëpunësit publik në institucionet kryesore.	MSHMS, ISHSH, ISHP	50,000 euro	Përqindja e nëpunësve në institucionet publike që merren me shëndetin në punë të cilët kanë përfunduar programin e trajnimit për SSHP-në.	Q2 2027
	Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim në SSHP-ë për nëpunësit e institucioneve publike të cilët merren me shëndetin në punë.			Statusi i kryerjes së raportit të vlerësimit të nevojave për SSHP-në për nëpunësit e institucioneve publike të cilët merren me shëndetin në punë.	Q2 2027
	Hartimi i kuadrit të kurrikulës të trajnimit në SSHP-ë për nëpunësit e institucioneve publike të cilët merren me shëndetin në punë.			Statusi i përfundimit të zhvillimit të kuadrit të finalizuar të kurrikulës së trajnimit, përfshirë objektivat e të nxënit dhe strukturën e kursit.	Q2 2027
	Hartimi i moduleve të trajnimit në SSHP-në për nëpunësit e institucioneve publike të cilët merren me shëndetin në punë.			Përqindja e moduleve të trajnimit që është përgatitur plotësisht për zbatim përfshirë materialet e trajnimit, prezantimet, literaturën dhe vlerësimet.	Q2 2027
	Zbatimi i trajnimit në SSHP-ë për nëpunësit e institucioneve publike të cilët merren me shëndetin në punë.			* Përqindja e numrit të synuar të pjesëmarrësve të cilët janë regjistruar në programin e trajnimit. * Përqindja e sesioneve të planifikuara të trajnimit që janë zbatuar sipas kurrikulës së planifikuar.	Q4 2028
B.1.2.2	Dhënia e një kursi trajnimi me fushë të gjerë për profesionistët e shëndetit në punë.	MSHMS, ISHSH, ISHP	20,000 euro	Përqindja e profesionistëve të shëndetit në punë të cilët kanë përfunduar programin e trajnimit.	Q4 2028
	Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim në SSHP për profesionistët e shëndetit në punë.			Statusi i kryerjes së raportit të vlerësimit të nevojave për SSHP-në për profesionistët e shëndetit në punë.	Q2 2026
	Përpunimi i një kurrikule trajnimi në SSHP për profesionistët e shëndetit në punë.			Statusi i përfundimit kurrikulës së trajnimit, përfshirë objektivat e të nxënit dhe strukturën e kursit.	Q4 2026



	Hartimi i moduleve të trajnimit në SSHP për profesionistët e shëndetit në punë.			Përqindja e moduleve të trajnimit të cilat janë përgatitur plotësisht për t'u vënë në zbatim përfshirë materialet e trajnimit, prezantimet, literaturën dhe vlerësimet.	Q2 2027
	Zbatimi i programit të trajnimit në SSHP për profesionistët e shëndetit në punë.			Përqindja e numrit të synuar të pjesëmarrësve të cilët janë regjistruar në programin e trajnimit. Përqindja e sesioneve të planifikuara të trajnimit të cilat janë zhvilluar sipas kurrikulës së planifikuar.	Q4 2028
B.1.2.3	Integrimi i sigurisë dhe shëndetit në punë në kurrikulën për specializimin e mjekëve të familjes, ose/dhe krijimi i masterit ekzekutiv të mjekut në mjekësinë e punës.	Fakulteti i Mjekësisë, MAS	100,000 Euro	* Statusi i integrimit të SSHP-së si pjesë e kurrikulës për specializimin e mjekëve të familjes/ statusi i krijimit të masterit ekzekutiv në mjekësinë e punës * Numri i temave të SSHP-së të integruara në kurrikulën për specializimin e mjekëve të familjes.	Q3 2028
	Identifikimi i tematikave për SSHP-në dhe të lidhura me shëndetin në punë që mund të shtohen në kurrikulën e Mjekëve të Familjes.			Numri i tematikave të SSHP-së dhe Shëndetit në Punë të identifikuar dhe dokumentuara për përfshirje në kurrikulën e specializimit të mjekëve të familjes.	Q2 2026
	Bashkërendim me Universitetin e Mjekësisë për të zbatuar një disiplinë të veçantë për SSHP-në në bazë të tematikave të identifikuar.			Statusi i zbatimit të një discipline të veçantë për shëndetin në punë nga Universiteti i Mjekësisë	Q4 2027
	Zbatimi i kurrikulës së re për SSHP-në/ krijimi i masterit ekzekutiv.			Statusi i zbatimit të kurrikulës së re për SSHP-në /statusi i krijimit të masterit ekzekutiv në mjekësinë e punës.	Q3 2028
B.1.2.4	Organizimi dhe zbatimi i trajnimit me kohë të plotë për specializantëve për mjekësinë e punës në kuadër të edukimit në vazhdim.	MSHMS, ISHP, MAS	532,000 Euro	Përqindja e pozicioneve të plotësuara për mjekësinë e punës.	Q4 2027
	Kryerja e një analize krahasimore të trajnimit të mjekëve në mjekësinë e punës në vendet e Bashkimit Evropian.			Statusi i kryerjes së analizës krahasimore në lidhje me trajnimin në mjekësinë e punës.	Q4 2025
	Përgatitja e kurrikulës duke marrë në konsideratë standardet e BE-së për mjekët e punës.			Status i përfundimit të kurrikulës të specializimit, përfshirë objektivat e të nxënësve dhe strukturën e kursit, sipas standardeve të BE-së për mjekët e punës.	Q4 2026
	Rishikim i sistemit aktual të mjekësisë së punës dhe përgatitja e ndryshimeve ligjore për të krijuar kriteret për mjekët e punës.			* Statusi i kryerjes së rishikimit të sistemit aktual të mjekësisë së punës. * Numri i ndryshimeve ligjore gati për dorëzim pranë autoriteteve përkatëse për caktimin e kriterëve për mjekët e punës krahasuar me numrin e përgjithshëm të ndryshimeve të duhura.	Q2 2027
	Miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore për të krijuar kriteret për mjekët e punës.			Numri i ndryshimeve ligjore të përgatitura për kriteret për mjekët e punës për t'u miratuar zyrtarisht nga autoritetet përkatëse.	Q4 2027
	Zbatimi i programit të trajnimit për specializantët e mjekësinë e punës në përputhje përafërsisht me standardet e BE-së me qëllim njohjen e sëmundjeve profesionale dhe propozimin e masave parandaluese.			Statusi i zhvillimit të programit të trajnimit për specializantët në mjekësinë e punës në përputhje përafërsisht me standardet e BE-së.	Q4 2028
Prioriteti strategjik B2: Rritja e kapaciteteve të institucioneve zbatuese në fushën e SSHP-së.					
Treguesi i impaktit B2: Përqindja e bizneseve të cilat zbatojnë rregulloret dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë në mjediset e inspektuara nga ISHPSHSH-ja dhe ISHSH-ja krahasuar me periudhën përpara zbatimit të dokumentit politik për SSHP-në.					
Objekti i B2.1: Rritja e kapaciteteve të ISHPSHSH. Ky objektivi do të zbatohet në sinergji me 2.2.					
Treguesi i impaktit B2.1 Përqindja e bizneseve të cilat zbatojnë rregulloret dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë në mjediset e inspektuara nga ISHPSHSH-ja krahasuar me periudhën përpara zbatimit të dokumentit politik për SSHP-në.					
Organizata përgjegjëse: MEKI, ISHPSHSH, MSHMS, ISHSH, IQ, AKSHI			Periodha e zbatimit 2025–2030		
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periudha e zbatimit
B.2.1.1	Analizë e kuadrit ligjor	MEKI, ISHPSHSH	20,400 euro		Q3 2025
	Ngritja e grupeve të punës ndërinstitucionale për të rishikuar kuadrin ligjor për institucionet zbatuese në fushën e SSHP-së. Aktiviteti i përbashkët me 2.2.1.	MEKI, ISHPSHSH MSHMS, ISHSH			
	Kryerja e vlerësimit të të gjithë kuadrit ligjor që qartëson funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e ISHPSHSH-së dhe masave zbatuese (gjohave për shkelje bazuar në natyrën dhe ashpërsinë e sanksioneve).	MEKI, ISHPSHSH		Status i kryerjes së shqyrtimit të kuadrit ligjor për (a) qartësimin e funksioneve, autoritetit dhe përgjegjësisë të ISHPSHSH-së dhe (b) vlerësimin e masave zbatuese (gjohave për shkelje bazuar në natyrën dhe ashpërsinë e sanksioneve).	Q2 2025
	Prezantimi i raportit me propozime për ndryshime ligjore apo institucionale të grupit të punës pranë ministrit përgjegjës për Punën dhe SSHP-në.	MEKI, ISHPSHSH		Statusi i prezantimit të vlerësimit të legjisllacionit dhe propozimeve për ndryshime ligjore të ministrit përgjegjës për çështjet e punës dhe SSHP-së.	Q3 2025
B.2.1.2	Ngritja e mekanizmit raportues për SSHP-në.	MEKI, ISHPSHSH	20,000 euro		Q4 2026
	Kryerja e vlerësimit të platformave digjitale aktuale që përdoren nga ISHPSHSH-ja me fokus të gjithë treguesit periodikë të inspektimit dhe sidomos ata të SSHP-së.			Statusi i kryerjes së vlerësimit të platformave digjitale aktuale që përdoren nga ISHPSHSH-ja me fokus të gjithë treguesit periodikë të inspektimit dhe sidomos ata të SSHP-së.	
	Përcaktimi i nevojave për informacion apo raporte periodike për institucione/role jashtë ISHPSHSH-së, sipas përgjegjësisë ligjore dhe kompetencave përkatëse			Numri i roleve, institucioneve dhe të dhënave që kërkojnë ndryshime për të plotësuar nevojat raportuese të ISHPSHSH-së.	
	Hartimi i raporteve me të dhëna periodike dhe indikatorë inspektimi për palët e treta.			Përqindja e raporteve vjetore me të dhëna inspektimi të sakta dhe të verifikuara që janë plotësuar dhe u janë dërguar palëve të treta brenda afatit.	
B.2.1.3	Rishikim i sistemit administrativ të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale	MEKI, ISHPSHSH	32,000 euro	Statusi i përmbylljes së sistemit të ISHPSHSH-së për zbatimin e masave.	Q4 2027
	Hartimi i një plani me hapa për hetimin e aksidenteve në punë për punëmarrësit dhe inspektorët e punës.			Statusi i përfundimit të planit me hapa për hetimin e aksidenteve në punë.	
	Rivlerësim dhe përmirësim i strukturës së protokollit "Aksidente në Punë" sipas udhëzimeve të përditësuara për punëmarrësit dhe inspektorët e punës.			Niveli i përafërimit (%) të strukturës së protokollit "Aksidente në punë" me (a) legjisllacionin kombëtar dhe (b) udhëzimet e ESAW.	



	Rivlerësim i të dhënave për aksidentet në punë, të regjistruara në regjistrin elektronik që mbahet nga ISHPSHSH-ja.			<i>* Plotësia e të dhënave:</i> Raporti i të dhënave me të gjitha fushat e plotësuara kundrejt numrit të total të fushave të dhënave. <i>* Shkalla e saktësisë:</i> Përqindja e të dhënave që janë të sakta dhe të verifikuara me një burim të besueshëm. <i>* Shkalla e uniformitetit:</i> Përqindja e të dhënave që janë uniforme në seri të ndryshme të dhënash apo brenda të njëjtës bashkësi të dhënash.	
B.2.1.4	Përmirësim i sistemit digjital të e-Inspektimit.	Inspektorati Qendror, MEKI, ISHPSHSH, AKSHI, ISHSH, etj. Mbulohe nga buxheti i shtetit	100,000 euro	<i>* Numri i informacioneve të reja analitike apo tendencave të reja të identifikuar përmes sistemit digjital të përmirësuar të menaxhimit të të dhënave, krahasuar me periudhën para përmirësimit.</i> <i>* Ndryshimi në kohën që është dashur për gjenerimin e raporteve pas procesit të digitalizimit krahasuar me periudhën para përmirësimit.</i>	Q4 2027
	Zhvillimi i sistemit të e-Inspektimit, duke marrë parasysh: * Përmirësimet e moduleve raportuese dhe analitike në lidhje me SSHP-në. * Integrimin me sistemin e informacionit për aksidentet dhe sëmundjet sipas kriterëve të ESAW dhe EODS për mbledhjen dhe regjistrimin e saktë dhe në kohë të të dhënave.			* Ndryshimi në përqindje në saktësinë dhe plotësinë e raporteve të gjeneruara nga sistemi i përmirësuar krahasuar me periudhën para përmirësimit. * Përqindja e raporteve të të dhënave dorëzuar brenda afateve të kërkuara sipas standardeve të ESAW dhe EODS.	Q4 2027
B.2.1.5	Përmirësimi i sistemit të rekrutimit dhe trajnimit të inspektorëve të punës.	MEKI, Inspektorati Qendror, ISHPSHSH, ONP/ILO	1,274,000 euro	<i>* Përqindja e kandidatëve të cilët plotësojnë apo tejkalojnë kriteret e kompetencave gjatë procesit të rekrutimit.</i> <i>* Ndryshimi në cilësi dhe plotësinë e inspektimeve të kryera pas zhvillimit të programit të trajnimit.</i>	Q2 2026
	Kryerja e vlerësimit të nevojave për kompetencat dhe njohuritë që duhet të kenë personeli dhe inspektorët e ISHPSHSH-së.			Statusi i kryerjes së vlerësimit të nevojave për kompetencat dhe njohuritë që duhet të kenë personeli dhe inspektorët e ISHPSHSH-së.	Q2 2025
	Përgatitja e programit të trajnimit për personelin dhe inspektorët e ISHPSHSH-së bazuar në gjetjet e vlerësimit të nevojave përfshirë trajnimin për SSHP-në në sektorët me rrezikshmëri të lartë si bujqësia, ndërtimi dhe minierat.			Përqindja e moduleve të trajnimit që janë të plotësisht të përgatitura për implementim përfshirë materialet e trajnimit, prezantimet, literaturën dhe vlerësimet.	Q4 2025
	Zbatimi i sistemit të konsoliduar të rekrutimit dhe trajnimit për inspektorët e ISHPSHSH-së bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim.			Përqindja e numrit të synuar të pjesëmarrësve të cilët kanë përfunduar programin e trajnimit. Përqindja e sesioneve të zhvilluara të trajnimit të cilat janë kryer sipas kurrikulës së planifikuar.	Q2 2026
B.2.1.6	Pjesëmarrja në veprimtaritë ndërkombëtare	MEKI, ISHPSHSH			2025-2030
	Rritja e përfshirjes në veprimtaritë ndërkombëtare të inspektimit të punës, përfshirë Komitetin e Lartë të Inspektorëve të Punës (KLIP/SLIC), ONP/ILO dhe EU OSHA), mbajtja parasysh e pjesëmarrjes si anëtar zyrtar apo si vëzhgues në KLIP dhe forume të tjera. (Mbulohe nga organizatat ftuese)			* Përqindja e takimeve dhe forumeve ndërkombëtare ku kanë marrë pjesë përfaqësues të inspektoratit të punës. * Marrja e statusit të vëzhguesit në KLIP/SLIC apo forume të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.	2025-2030
Objektivi B2.2: Rritja e kapaciteteve të ISHSH-së					
Treguesi i impaktit B2.1: Përqindja e bizneseve të cilat zbatojnë rregulloret dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë në mjediset e inspektuara nga ISHSH-ja krahasuar me periudhën përpara zbatimit të dokumentit politik për SSHP-në.					
Organizata përgjegjëse: MSHMS, ISHSH, IQ					
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periudha e zbatimit
B.2.2.1	Analiza e kuadrit ligjor	MSHMS, ISHSH	18,800 euro		Q3 2025
	Përcaktimi i përfaqësuesve të MSHMS-së në grupin e punës të ngritur nga MEKI si pjesë e ngritjes së grupit të punës në aktivitetin 2.1.1.	MEKI, ISHPSHSH MSHMS, ISHSH		Vendimi për ngritjen e GP-së ndër-institucionale nënshkruar dhe dërguar institucioneve përkatëse.	Q2 2025
	Kryerja e analize gjithëpërfshirëse të kuadrit ligjor që qartëson funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e ISHSH-së, si dhe vlerësimin e masave zbatuese (gjaba për shkelje sipas natyrës dhe ashpërsisë së sanksioneve).			Statusi i: a) kryerjes së analizës së kuadrit ligjor që qartëson funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e ISHSH-së; dhe b) vlerësimit të masave zbatuese (gjaba për shkelje sipas natyrës dhe ashpërsisë së sanksioneve).	Q2 2025
	* Bashkërendim me nismën e Qeverisë shqiptare për reformimin e inspektorateve. * Prezantim i raportit me propozimet për ndryshime institucionale dhe ligjore të grupit të punës ministrit të shëndetësisë.			Prezantimi te ministri i Shëndetësisë i gjetjeve të analizës së legjislacionit dhe propozimet për ndryshime ligjore.	Q3 2025
B.2.2.2	Forcimi i formimit të inspektorëve të shëndetësisë për shëndetin në punë.	Inspektorati Qendror, MSHMS, ISHSH	168,000 euro	Ndryshim në cilësinë dhe plotësinë e inspektimeve të kryera pas kryerjes së programit të trajnimit.	Q2 2026
	Kryerja e vlerësimit të nevojave për kompetencat dhe njohuritë që duhet të kenë zyrat e ISHSH-së për t'i pajisur inspektorët me njohuri të specializuara për të kryer inspektime të plota dhe për t'i zbatuar rregulloret në mënyrë efektive.			Statusi i kryerjes së vlerësimit të nevojave për kompetencat dhe njohuri të specializuara për të kryer inspektime të plota dhe për t'i zbatuar rregulloret në mënyrë efektive.	Q2 2025
	Përgatitja e programit të trajnimit për zyrat e ISHSH-së.			Përqindja e moduleve të trajnimit të cilat janë përgatitur plotësisht për t'u vënë në zbatim përfshirë materialet e trajnimit, prezantimet, literaturën dhe vlerësimet.	Q4 2025
	Zbatimi i sistemit të konsoliduar të rekrutimit dhe trajnimit për inspektorët e ISHSH-së bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim.			* Përqindja e numrit të synuar të pjesëmarrësve të cilët kanë përfunduar programin e trajnimit.	Q2 2026



				* Përqindja e sesioneve të zhvilluara të trajnimit të cilat janë kryer sipas kurrikulës së planifikuar.	
B.2.2.3	Rishikim i sistemit të zbatimit të masave.	MSHMS, ISHSH		Statusi i kryerjes së rishikimit të masave zbatuese.	Q4 2027
	Zbatimi i bashkërenduar i masave për njoftimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale ndërmjet ISHPSHSH-së dhe ISHSH-së, në përputhje edhe me parashikimet e ligjit për inspektimin.				Q4 2027
Prioriteti strategjik B3: Përmirësimi i dialogut social për sigurinë dhe shëndetin në punë Treguesi i impaktit B3: Ndryshim në efektivitetin e dialogut social në sigurinë dhe shëndetin në punë. Matësit: B3.a: Numri i aktorëve kryesorë (sindikata, punëdhënës) përkundrejt numrit potencial të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive në takimet, komitetet dhe forumet për SSHP-së. B3.b: Numri i masave, politikave, rekomandimeve për SSHP-në të dakordësuara në sesione dypalëshe ose trepalëshe të cilat zbatohen me sukses në vendet e punës përkundrejt numrit të propozuar. B3.c: Përqindja e vendeve të punës që plotësojnë apo tejkalojnë standardet rregullatore të SSHP-së si rezultat i veprimeve të dialogut social. B3.d: Numri i takimeve, konsultimeve dhe forumeve dypalëshe dhe trepalëshe të organizuara çdo vit për të diskutuar çështje të SSHP-së.					
Objekti i B3.1: Ngritja e Komiteteve trepalëshe ad-hoc për sektorë specifike dhe promovimi i funksionimit të rregullt të këshillave për SSHP-në në nivel ndërmarrjeje. Treguesi i rezultatis B3.1.a: Numri i sektorëve ku janë ngritur me sukses komitetet e përkohshme trepalëshe përkundrejt numrit total të sektorëve të synuar. Treguesi i rezultatis B3.1.b: Përqindja e ndërmarrjeve në sektorët e synuar që kanë këshilla aktive dhe funksional SSHP përkundrejt numrit total të ndërmarrjeve në këta sektorë.					
Organizata përgjegjëse: MEKI, KNSSHP, Organizatat e Punëdhënësve dhe Punëmarrësve					
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periudha e zbatimit
B.3.1.1	Ngritja e komiteteve trepalëshe sektoriale për SSHP-në.	MEKI, KNSSHP		Numri i komiteteve të përkohshme trepalëshe të ngritura.	Q2 2026
	Përgatitja e rregullores për funksionimin e komiteteve trepalëshe sektoriale për SSHP-në.			Statusi i finalizimit të rregullores për funksionimin e komiteteve të përkohshme trepalëshe për SSHP-në.	Q4 2025
	Ngritja e komitetit të përkohshëm sektorial trepalësh për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat përballen sektorët me rrezikshmëri të lartë, bazuar në rekomandimet e KNSSHP-së.			Numri i komiteteve të përkohshme trepalëshe që mbledhen rregullisht gjatë periudhës së tyre aktive.	Q2 2026 -2030
B.3.1.2	Ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve në Këshillat për SSHP-në në nivel ndërmarrjeje.	MEKI, ISHPSHSH, Organizatat e Punëdhënësve dhe Punëmarrësve	14,440 euro	Përqindja e numrit të synuar të përfaqësuesve të këshillave për SSHP-në në nivel ndërmarrjeje të cilët kanë kryer programin e trajnimit.	Q4 2025 -2030
	Zhvillimi i moduleve të trajnimit për dialogun social dhe praktikën me të mira në SSHP të përshtatura për anëtarët e këshillave të SSHP-së, punëdhënësve, punëmarrësve dhe aktorëve të tjerë.			Përqindja e moduleve të trajnimit gati për zbatim për dialogun social dhe praktikën e mira në SSHP të përshtatura për anëtarët e komiteteve të SSHP-së, sindikatave, punëmarrësve dhe aktorëve të tjerë.	Q4 2029
B.3.1.3	Përmirësimi i masave të përfaqësimit SSHP në kategori të ndryshme biznesi.	MEKI, ISHPSH, Organizatat e Punëmarrësve		Shkalla e lehtësisë së punëmarrësve në NMV dhe të mëdha për t'u anëtarësuar në Këshillat e SSHP-në.	Q2 2027
	Monitorimi i procesit për emërimin e përfaqësuesve të punëmarrësve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të siguruar që kuadri ligjor aktual e garanton siç duhet përfaqësimin e punëmarrësve aty ku nuk ka Këshill SSHP-je.			Statusi i përfundimit të raportit të monitorimit për procesin e emërimit të përfaqësuesve të punëmarrësve në NVM-të.	Q4 2026
	Amendimi i rregullave për ta thjeshtuar pjesëmarrjen e punëmarrësve në këshillat për SSHP-në, veçanërisht në kompanitë më të mëdha ku dhe mandatohen të tilla këshilla.			Statusi i miratimit të amendimeve të rregullave që synojnë qartësimin dhe thjeshtimin e procedurave të anëtarësimit të punëmarrësve në këshillat për SSHP-në duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të tyre.	Q2 2027
Shtylla C: Kthimi në prioritet dhe rritja e ndërgjegjësisimit për SSHP-në për të garantuar kushtet e punës së denjë. Prioriteti strategjik C1: Promovimi i kulturës parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nëpërmjet përhapjes së informacionit dhe rritjes së ndërgjegjësisimit. Objekti i C1.1: Promovimi i kulturës parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Treguesi i rezultatis C1.1: Përqindja e punëmarrësve të cilët janë trajnuar për tema të SSHP-së në sektorin publik dhe privat.					
Organizata përgjegjëse: MEKI, MSHMS, KNSSHP, MAS, ISHPSHSH, ISHSH, ISHP					
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet përgjegjëse	Kostot e parashikuara	Treguesit	Afati i fundit/periudha e zbatimit
C.1.1.1	Krijimi i një hapësire të aksesueshme në mënyrë digjitale me informacion për SSHP-në.	KNSSHP, MEKI, MSHMS	15,000 euro	Statusi i ngritjes së një portali/faqeje informuese në internet për SSHP-në	Q4 2025
	Mirëmbajtja/përditësimi i portalit ose faqes informuese në internet me lidhëza për të shpërndarë informacion për SSHP-në të të gjithë aktorët e rëndësishëm dhe publikun.			Numri i vizitave në portalin/faqen informuese në internet për SSHP-në.	Q4 2025
C.1.1.2	Zhvillimi i një plani komunikimi për SSHP-në	MEKI, MSHMS	2,400 euro	Numri i hapave të përbushura të planit të komunikimit	Q3 2025
	Përgatitja e një plani komunikimi për SSHP-në duke marrë në konsideratë angazhimin dhe bashkëpunimin e përfaqësuesve të medias dhe gazetarëve të pavarur.			Statusi i finalizimit dhe miratimit të planit të komunikimit për SSHP-në.	Q3 2025



	Riaktivizim i Njësisë së Shëndetit në Punë për të garantuar aksesin e punëmarrësve në rajone të ndryshme me shërbimet themelore të shëndetit në punë.			Përqindja e Njësisë rajonale të Shëndetit në Punë të aksesueshme nga punëmarrësit.	Q2 2026
C.1.1.3	Zhvillimi i broshurave informuese me të dhëna për SSHP-në bazuar tek udhëzimet e ONP/ILO dhe BE-së si dhe te Standardet Ndërkombëtare të Punës.	MEKI, ISHPSHSH, ONP/ILO	15,000 euro	Përqindja e broshurave informuese me të dhëna që janë përshtatur dhe integruar në kuadrin kombëtar të SSHP-së.	Q4 2025
	Përditësimi dhe përkthimi i broshurave informuese të mbështetura tek “International Data Sheets” të ONP/ILO për Sigurinë në Profesion.			Numri i broshurave të përditësuara dhe përkthyer në gjuhën shqipe.	Q4 2025
	Vënia në dispozicion e këtyre broshurave informuese në portalin/faqen informuese në internet për SSHP-në, për t'u dhënë informacion NVM-ve në sektorin formal, informal dhe të vetëpunësuarve.			Numri vjetor i shkarkimeve të broshurave informative. Përqindja e broshurave informuese të cilat janë lehtësisht të aksesueshme në portalin/faqen e internetit SSHP.	Çdo vit
C.1.1.4	Vënia në zbatim e vlerësimit ndëreprues online të riskut (OiRA)	MEKI, ISHPSHSH	50,000 euro	Përqindja e bizneseve që përdorin instrumentin OiRA në sektorë të synuar.	2025-2030
	Përzgjedhja e sektorëve të synuar dhe zhvillimi apo përshtatja e instrumentit ekzistues OiRA me qëllim rritjen e efikasitetit të kryerjes së vlerësimit të rrezikshmërisë së SSHP-së nga bizneset.			Statusi i aksesueshmërisë së OiRA nga bizneset lokale në sektorët e synuar.	Q1 2026 (për instrumentin e parë)
C.1.1.5	Organizimi i aktiviteteve të përvitshme për SSHP-në	MEKI, MSHMS, MAS, ISHPSHSH, ISHSH, ISHP	60,000 euro	Numri vjetor i aktiviteteve të organizuara për SSHP-në	2025-2030
	Krijimi i një kalendari vjetor me datat e rëndësishme si Dita Botërore e ONP/ILO për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (28 prill) dhe datat të tjera që kanë lidhje me punën ku përmes aktiviteteve të përvitshme të rritet angazhimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit.			Statusi i finalizimit të kalendarit të përvitshëm me datat e rëndësishme që lidhen me SSHP-në.	2025-2030
	Organizimi i aktiviteteve me tematika për SSHP-në në institucionet e arsimit parauniversitar.			Numri i aktiviteteve për SSHP-në të organizuara çdo vit në institucionet e arsimit parauniversitar.	Q2 2026
Prioriteti strategjik C2: Dhënia e prioritetit të edukimit për SSHP-në në të gjitha nivelet arsimore. Treguesi i impaktit C2: Përqindja e nxënësve/studentëve që demonstrojnë praktika të sigurta në mjedise reale apo të simuluar deri më 2030. Objekti i C2.1: Integrimi i SSHP-së në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, formimit profesional dhe arsimit të lartë. Treguesi i rezultatit C2.1: Numri i moduleve të SSHP-së i integruar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, formimit profesional dhe arsimit të lartë, deri më 2030.					
Organizata përgjegjëse: MEKI, MAS, ASCAP, AKPA, AKAFPK, IAL					
Nr.	Veprimtaritë	Institucionet e përfshira	Kostot e parashikuara	Periodha e zbatimit	Afati i fundit/periodha e zbatimit
C.2.1.1	Integrimi i SSHP-së në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.	MEKI, MAS, ASCAP	21,000 euro		Q4 2026
	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për mësuesit, duke: * Hartuar module kurrikulash për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe punën e fëmijëve, të përshtatur për grup-mosha të ndryshme nxënësish të institucioneve të arsimit parauniversitar. * Trajnimi i trajnerëve për SSHP-në në arsim duke përfshirë zyrat vendore të arsimit parauniversitar.			* Përqindja e moduleve të SSHP-së që janë përgatitur plotësisht e të gatshme për t'u zbatuar në institucionet e arsimit parauniversitar. * Përqindja e numrit të synuar të pjesëmarrësve, të cilët kanë përfunduar trajnimin e trajnerëve.	Q4 2025
	Përfshirja e një lënde me zgjedhje për SSHP-në kurrikulën e institucioneve të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë (gjimnaze), përfshirë: * Hartimin e doracakut të SSHP-së për mësuesit. * Kryerjen e sesioneve të specializuara të trajnimit për mësuesit që do të japin mësim lëndën e SSHP-së për të garantuar angazhimin me efektivitet të nxënësve.			* Përqindja e institucioneve të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë që kanë integruar SSHP-në në kurrikulën e tyre. * Doracakut i moduleve për SSHP-në për mësuesit në dispozicion të të gjithë mësuesve në institucionet e arsimit parauniversitar të mesëm të lartë që kanë integruar SSHP-në në kurrikul. * Përqindja e mësuesve të trajnuar për tematika të SSHP-së.	Q4 2026
C.2.1.2	Integrimi i Edukimit për SSHP-në në arsimin e mesëm profesional dhe qendrat e formimit profesional	MEKI, MAS, AKPA, AKAFPK	3,000 euro	Përqindja e institucioneve të arsimit të mesëm parauniversitar profesional dhe qendrat e formimit profesional, të cilat kanë integruar SSHP-në në kurrikulën e tyre.	Q4 2025
	Hartimi dhe prezantimi i SSHP-së, përfshirë punën e fëmijëve, si lëndë në institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe qendrat e formimit profesional, apo përditësimi i kurrikulave ekzistuese të SSHP-së për t'u harmonizuar me standardet e ONP/ILO dhe BE-së si dhe ato kombëtare të SSHP-së.			Numri i lëndëve për SSHP-në të përgatitura dhe gati për zbatim në institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe qendrat e formimit profesional.	Q4 2025
C.2.1.3	Integrimi i SSHP-së në institucionet e arsimit të lartë.	Institucionet e arsimit të lartë, MAS	3,000 euro	Përqindja e IAL-ve të cilat kanë integruar SSHP-në në kurrikulën e tyre.	Q4 2027
	Integrimi i SSHP-së në institucionet e arsimit të lartë si lëndë e veçantë apo grup tematikash, përshtatur për fusha të veçanta studimi (aty ku mungojnë).			Numri i lëndëve ose temave për SSHP-në që janë përgatitur dhe gati për zbatim në institucionet e arsimit të lartë.	Q4 2027
	Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për të hartuar kurrikula gjithëpërfshirëse që të adresojnë sfidat e SSHP-së në fushat respektive.			Numri i lëndëve për SSHP-në të hartuara në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë në fusha të synuara studimi dhe profesione të caktuara.	Q4 2027



Tabela 1: Kostot sipas viteve

Aktiviteti	Përshkrimi	Institucionet	2025	2026	2027	Vitet më pas	Totali
A.1.1.1	Ngritja e Këshillit Ndërmnistror për SSHP-në (KNSSHP).	MEKI, ministrinë e përfshira	12,800				12,800
A.1.1.2	Takime sistematike të Këshillit siç përcaktohet në rregullat e Këshillit dhe të PSF-të përfshirë ato ku marrin pjesë organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve.	MEKI, ministrinë e përfshira, Sekretariati për SSHP-në, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve	2,167	2,167	2,167	6,500	13,000
A.1.1.3	Monitorim dhe vlerësim i zbatimit të Dokumentit Politik për SSHP-në	MEKI, përfaqësues të organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve në KNSSHP	65,880		9,000		74,880
A.1.1.4	Ngritja e kapaciteteve të Sekretariatit të KNSSHP-së dhe “Pikave të Kontaktit” që përfaqësojnë ministrinë në rrjetin e SSHP-së.	MEKI, MSHMS-ja dhe të gjitha ministrinë sipas fushës së ekspertizës dhe përgjegjësisë.	67,700				67,700
A.1.2.1	Harmonizimi i kuadrit ligjor të SSHP-së me <i>acquis</i> të BE-së.	MEKI, MSHMS, KNSSHP dhe ministrinë e përfshira	10,000	10,000	10,000	6,000	36,000
A.1.2.2	Ratifikimi dhe nisja e zbatimit të konventave të ONP/ILO.	MEKI	16,667	16,667	16,667	50,000	100,000
A.1.2.3	Zbatimi i udhëzimeve të ONP/ILO	MEKI/ISHPSHS, ONP/ILO	53,760	33,760			87,520
A.2.1.1	Krijimi dhe përdorimi i një mekanizmi ligjor për administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave për aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale.	INSTAT, MEKI, ISHPSHS, MSHMS, Sigurimet Shoqërore, ISHP-ja, ISHSH-ja, AKSHI etj.	80,000	300,000			380,000
A.2.1.2	Zhvillimi i Regjistrit Kombëtar të Aksidenteve në Punë dhe Sëmundjeve Profesionale bazuar në ESAW dhe EODS	MEKI, ISHPSHS, INSTAT, MSHMS, Sigurimet Shoqërore			160,000		160,000
A.2.1.3	Ngritja e kapaciteteve të institucioneve kryesore, në lidhje me dokumentimin e aksidenteve në vendin e punës dhe sëmundjeve profesionale.	MEKI, ISHPSHS, INSTAT, MSHMS, Sigurimet Shoqërore, Sindikatat, Punëdhënësit, profesionistët e SSHP-së, Policia e Shtetit				224,000	224,000
A.3.1.1	Ngritja dhe zbatimi i kuadrit të trajnimit dhe certifikimit për profesionistët e SSHP-së dhe të licencimit të shërbimeve në një sektor të synuar.	MEKI, ISHPSHS, MSHMS, ISHSH, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	40,000	94,160	9,600		143,760
A.3.1.2	Shkallëzimi i kuadrit të trajnimit dhe certifikimit për profesionistët për SSHP-në dhe të licencimit të shërbimeve në sektorë të tjerë apo në të tërë sektorët.	MEKI, ISHPSHS, MSHMS, ISHSH, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit				1,581,360	1,581,360



B.1.1.1	Forcimi i strukturës ekzistuese brenda MSHMS-së me detyrë adresimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.	MSHMS					-
B.1.1.2	Ringritja e strukturës përgjegjëse për deklarimin e sëmundjeve profesionale.	MSHMS / QSUNT/5 spitalet rajonale	60,000	62,000	60,000	180,000	362,000
B.1.1.3	Fuqizimi i Institutit të Shëndetit Publik.	MSHMS, ISHP, ISHSH		90,060			90,060
B.1.1.4	Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit Digjital të të Dhënave të Shëndetit në Punë.	MSHMS, ISHP, ISHSH			360,000		360,000
B1.2.1	Zbatimi i programit të trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë për nëpunësit publik në institucionet kryesore.	MSHMS, ISHSH, ISHP			50,000		50,000
B.1.2.2	Dhënia e një kursi trajnimi me fushë të gjerë për profesionistët e shëndetit në punë.	MSHMS, ISHSH, ISHP			20,000		20,000
B.1.2.3	Integrimi i sigurisë dhe shëndetit në punë në kurrikulën për specializimin e mjekëve të familjes, ose/dhe krijimi i masterit ekzekutiv të mjekut në mjekësinë e punës.	Fakulteti i Mjekesise, MAS				100,000	100,000
B.1.2.4	Organizimi dhe zbatimi i trajnimit për mjekësinë e punës në kuadër të edukimit në vazhdim.	MSHMS, ISHP, MAS	16,000	16,000		500,000	532,000
B.2.1.1	Analizë e kuadrit ligjor.	MEKI, ISHPSHSH	20,400				20,400
B.2.1.2	Ngritja e mekanizmit raportues për SSHP-në.	MEKI, ISHPSHSH		20,000			20,000
B.2.1.3	Rishikim i sistemit administrativ të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale	MEKI, ISHPSHSH			32,000		32,000
B.2.1.4	Përmirësim i sistemit digjital të <i>e-Inspektimit</i> .	Inspektorati Qendror, MEKI, ISHPSHSH, AKSHI, ISHSH, etj.			100,000		100,000
B.2.1.5	Përmirësimi i sistemit të rekrutimit dhe trajnimit të inspektorëve të punës.	MEKI, Inspektorati Qendror, ISHPSHSH, ONP/ILO	50,000	244,800	244,800	734,400	1,274,000
B.2.1.6	Pjesëmarrja në veprimtaritë ndërkombëtare	MEKI, ISHPSHSH					-
B.2.2.1	Analiza e kuadrit ligjor	MSHMS, ISHSH	18,800				18,800
B.2.2.2	Forcimi i formimit të inspektorëve të shëndetësisë për shëndetin në punë.	MSHMS, ISHSH, Inspektorati Qendror		168,000			168,000
B.2.2.3	Rishikim i sistemit të zbatimit të masave.	MSHMS, ISHSH					-
B.3.1.1	Ngritja e komiteteve trepalëshe sektoriale për SSHP-në.	MEKI, KNSSHP					-
B.3.1.2	Ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve në këshillat për SSHP-në në nivel ndërmarrjeje.	MEKI, ISHPSHSH, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve				14,440	14,440
B.3.1.3	Përmirësimi i masave të përfaqësimit SSHP në kategori të ndryshme biznesi.	MEKI, ISHPSH, organizatat e punëmarrësve					-
C.1.1.1	Krijimi i një hapësire të aksesueshme në mënyrë digjitale me informacion për SSHP-në.	KNSSHP, MEKI, MSHMS	15,000				15,000
C.1.1.2	Zhvillimi i një plani komunikimi për SSHP-në.	MEKI, MSHMS	2,400				2,400



C.1.1.3	Zhvillimi i broshurave informuese me të dhëna për SSHP-në bazuar tek udhëzimet e ONP/ILO dhe BE-së, si dhe te Standardet Ndërkombëtare të Punës.	MEKI, ISHPSHSH, ONP/ILO	15,000				15,000
C.1.1.4	Vënia në zbatim e vlerësimit ndërveprues <i>online</i> të riskut (OiRA)	MEKI, ISHPSHSH		10,000	10,000	30,000	50,000
C.1.1.5	Organizimi i aktiviteteve të përvitshme për SSHP-në.	MEKI, MSHMS, MAS, ISHPSHSH, ISHSH, ISHP	10,000	10,000	10,000	30,000	60,000
C.2.1.1	Integrimi i SSHP-së në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.	MEKI, MAS, ASCAP	21,000				21,000
C.2.1.2	Integrimi i edukimit për SSHP-në në arsimin e mesëm profesional dhe qendrat e formimit profesional.	MEKI, MAS, AKPA, AKAFPK	3,000				3,000
C.2.1.3	Integrimi i SSHP-së në institucionet e arsimit të lartë.	Institucionet e arsimit të lartë, MAS			3,000		3,000
			580,573	1,077,613	1,097,233	3,456,700	6,212,120

Kostimi në lekë është bërë me kursin e këmbimit (1 euro = 108.8)¹⁹

Kostot në euro dhe lekë/vitet	2025	2026	2027	Vitet në vijim	Totali
Kosto totale në euro	580,573	1,077,613	1,097,233	3,456,700	6,212,120
Kosto totale në ALL (kursi 1 eur=108.8*)	63,166,342	117,244,331	119,378,987	376,088,960	675,878,620

¹⁹ Kursi sipas udhëzimit plotësues të ministrit të Financave nr. 9, datë 10.7.2024, [CamScanner 07-12-2024 12.02](#)
Kostot për vitin 2025 do të mbulohen nga buxhetet e secilit institucion.



UDHËZIM
Nr. 13, datë 7.3.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË
SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË
8.7.2019, “PËR PAJISJEN E
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË ME REGJISTRIN THEMELTAR
TË STUDENTËVE, REGJISTRIN E
ARRITJEVE AKADEMIKE DHE
REGJISTRIN E LËSHIMIT TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 101 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 16, datë 8.7.2019, “Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”, bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

a) Pikat 5, 8 dhe 10 të kreut I ndryshojnë si më poshtë:

“5. Aplikimi për pajisjen me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave bëhet nga IAL-të në platformën *e-Albania* dhe aplikimi shqyrtohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (në vijim “QSHA”).

Krahas formularit të aplikimit, që duhet të përmbajë emërtimin e njësisë kryesore, emërtimin dhe llojin e programit të studimit, forma e studimit (me kohë të plotë ose me kohë të zgjatur), IAL-ja ngarkon mandatpagesën për QSHA-në, si dhe autorizimin e rektorit për punonjësën e IAL-së për tërheqjen e tyre.

Qendra e Shërbimeve Arsimore siguron me ndërveprim nga institucioni përgjegjës:

- a) aktin e hapjes së IAL-së;
- b) aktin e akreditimit të parë ose të akreditimit periodik të IAL-së;
- c) aktin e hapjes së programit të studimit;
- ç) aktin e akreditimit të parë ose akreditimit periodik të programit të studimit (kur është kryer

nga Bordi i Akreditimit përpara lëshimit të diplomave).”.

8. Pajisja e IAL-ve me regjistra bëhet përpara fillimit të vitit akademik, por jo më vonë se data 31 tetor e çdo viti akademik”.

10. Në rast ndryshimi/riorganizimi të IAL-së, njësisë kryesore apo të programit të studimit, IAL-ja bën aplikim të ri për regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.”.

b) Pika 1 e kreut V shfuqizohet.

c) Pas pikës 3, të kreut V, shtohet pika me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre dhe të dhënat pasqyrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL).”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT**
Ana Kapaj

URDHËR
Nr. 204, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BOSNJË-HERCEGOVINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të



gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-IT, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Republika Srpska	Bijeljina	Bijeljina*
Republika Srpska	Bijeljina	Lopare*
Federacija Bosna i Hercegovina	Posavina	Orašje*
Republika Srpska	Bijeljina	Ugljevik*
Republika Srpska	Doboj	Samac*
Republika Srpska	Doboj	Donji Žabar*
Republika Srpska	Doboj	Modriča*
Republika Srpska	Doboj	Pelagićevo*
Republika Srpska	Doboj	Doboj*
Republika Srpska	Doboj	Petrovo*
Republika Srpska	Istočno Sarajevo	Sokolac*
Republika Srpska	Istočno Sarajevo	Istočni Stari Grad*
Republika Srpska	Trebinje	Nevesinje*
Republika Srpska	Trebinje	Gacko*
Republika Srpska	Foča	Kalinovik*
Republika Srpska	Foča	Foča*
Republika Srpska	Vlasenica	Bratunac*
Republika Srpska	Vlasenica	Milići*
Republika Srpska	Vlasenica	Osmaci*
Republika Srpska	Vlasenica	Šekovići*
Republika Srpska	Vlasenica	Vlasenica*
Brčko	Brčko	Brčko*
Republika Srpska	Banja Luka	Bosanska Gradiška*
Federacija Bosna i Hercegovina	Posavina	Orašje*
Federacija Bosna i Hercegovina	Central Bosnia	Kreševo*
Federacija Bosna i Hercegovina	Sarajevo	Vogošća*
Federacija Bosna i Hercegovina	Sarajevo	Hadžići*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Ilijaš*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Trnovo*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Vogošća*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Stari Grad Sarajevo*
Federacija Bosna i Hercegovina	Tuzla	Teočak*
Federacija Bosna i Hercegovina	Tuzla	Sapna*
Federacija Bosna i Hercegovina	West Herzegovina	Široki Brijeg*
Federacija Bosna i Hercegovina	West Herzegovina	Posušje*
Federacija Bosna i Hercegovina	Zenica-Doboj	Žepče*
Federacija Bosna i Hercegovina	Bosnian Podrinje	Foča-Ustikolina*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8.

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.



2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të

Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose



b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 91, datë 30.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e

Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 205, datë 4.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2
Hajdú-Bihar	Püspökladány*
Heves	Füzesabony*
Bács-Kiskun	Kiskunfélegyháza*
Bács-Kiskun	Kiskőrös*
Békés	Mezőkovácsháza*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.



3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 169, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 206, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland*
Bayern	Augsburg (Kreisfreie Stadt)	Augsburg*
Bayern	Garmisch-Partenkirchen	Ohlstadt*
Rheinland-Pfalz	Rhein-Pfalz-Kreis	Dannstadt-Schauernheim*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Altenpleen*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock (Kreisfreie Stadt)	Rostock*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Stralsund*
Niedersachsen	Oldenburg	Hude*
Baden-Württemberg	Schwäbisch Hall	Ilshofen-Vellberg*
Niedersachsen	Wittmund	Holtriem*
Bayern	Eichstätt	Kösching*
Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Ermlichheim*
Schleswig-Holstein	Plön	Probstei*
Niedersachsen	Leer	Jemgum*
Niedersachsen	Aurich	Aurich*
Niedersachsen	Friesland	Wangerland*
Niedersachsen	Aurich	Hinte*
Niedersachsen	Emsland	Emsbüren*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 168, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe



Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 207, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MOLDAVISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë
Anëni Noj*
Briceni*
Cahul*
Criuleni*
Dubăsari*
Drochia*
Edinet*
Făleşti*
Floreşti*
Rîşcani*
Sîngerei*
Străşeni*
Şoldăneşti*
Soroca*
Ialoveni*
Ocnita*
Ungheni*
Glodeni*
Donduseni*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Moldavisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.



2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të

Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose



b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 136, datë 13.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Moldavisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e

Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 208, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MBRETËRISË SË
BASHKUAR**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Mbretërisë së Bashkuar, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Northern Ireland	Mid Ulster	Magherafelt*
2	Northern Ireland	Mid Ulster	Cookstown*
3	England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
4	England	Shropshire	Shropshire*
5	England	Cornwall	Cornwall*
6	England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
7	England	Norfolk	South Norfolk*
8	England	Lincolnshire	East Lindsey*
9	England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*



2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 170, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 209, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezët e shpendëve;

dh) mishi i shpendëve i patrajtuar termikisht;

e) nënproduktet e shpendëve të patrajuara termikisht.

Nga shteti i Bullgarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Ndarja administrative e nivelit 1</i>	<i>*Ndarja administrative e nivelit 2</i>
Yambol*	Tundzha*
Plovdiv	Asenovgrad*
Plovdiv	Maritsa*
Plovdiv	Rakovski*
Plovdiv	Sadovo*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve i patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 167, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



URDHËR
Nr. 210, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Çekisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
10	Jihočeský	Strakonice*
11	Plzeňský	Plzeň – jih*
12	Jihomoravský	Břeclav*
13	Liberecký	Česká Lípa*
14	Středočeský	Mladá Boleslav*
15	Jihomoravský	Znojmo*
16	Moravskoslezský	Opava*
17	Karlovarský	Sokolov*
18	Karlovarský	Hradec Králové*
19	Kraj Vysočina	Jihlava*
20	Pardubický	Ústí nad Orlicí*
21	Ústecký	Teplíc*
22	Středočeský	Praha – východ*
23	Plzeňský	Rokycany*
24	Prague	Praha 19*
25	Plzeňský	Tachov*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë,

Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 149, datë 19.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Çekisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 211, datë 4.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;



e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Turqisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Konya	Selçuklu (Meram)*	
Afyon	Merkez*	
Konya	Çumra*	
Konya	Karatay*	
Hatay	Merkez*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1056, datë 5.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë” dhe urdhri nr. 164, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 212, datë 4.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Lódzkie	Skiermiewice	Maków*
2	Dolnośląskie	Trzebnica	Wisznia Mała*
3	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
4	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
5	Wielkopolskie	Poznań	Kleszczewo*
6	Wielkopolskie	Września	Miłosław*
7	Dolnośląskie	Wrocław	Wrocław*
8	Śląskie	Głównice	Toszek*
9	Śląskie	Częstochowa	Dąbrowa Zielona*
10	Dolnośląskie	Góra	Niechlów*
11	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
12	Mazowieckie	Siedlce	Zbuczyn*
13	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
14	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
15	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Dąbrówno*
16	Lódzkie	Sieradz	Warta*
17	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
18	Podkarpackie	Jarosław	Jarosław (rural)*
19	Zachodniopomorskie	Goleniów	Osina*
20	Podkarpackie	Ropczyce-Sędziszów	Ostrów*
21	Lódzkie	Kutno	Krośnice*
22	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Kisielice*
23	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
24	Lódzkie	Zgierz	Ozorków (rural)*
25	Wielkopolskie	Koło	Grzegorzew*
26	Wielkopolskie	Kępno	Kępno*
27	Lubuskie	Nowa Sól	Kolsko*
28	Wielkopolskie	Kalisz	Żelazków*
29	Warmińsko-Mazurskie	Mragowo	Piecki*
30	Lódzkie	Sieradz	Goszczanów*
31	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
32	Warmińsko-Mazurskie	Mragowo	Mikolajki*
33	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
34	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Wielichowo*



35	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Kikół*
36	Podkarpackie	Lesko	Olszanica*
37	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
38	Małopolskie	Myslenice	Siepraw*
39	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Rakoniewice*
40	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Olsztynek*
41	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 161, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 223, datë 6.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

Faqe/ 5694

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland*
Bayern	Augsburg (Kreisfreie Stadt)	Augsburg*
Bayern	Garmisch-Partenkirchen	Ohlstadt*
Rheinland-Pfalz	Rhein-Pfalz-Kreis	Dannstadt-Schauernheim*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Altenpleen*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock (Kreisfreie Stadt)	Rostock*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Stralsund*
Niedersachsen	Oldenburg	Hude*
Baden-Württemberg	Schwäbisch Hall	Ilshofen-Vellberg*
Niedersachsen	Wittmund	Holtriem*
Bayern	Eichstätt	Kösching*
Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Emlichheim*
Schleswig-Holstein	Plön	Probstei*
Niedersachsen	Leer	Jemgum*
Niedersachsen	Aurich	Aurich*
Niedersachsen	Friesland	Wangerland*
Niedersachsen	Aurich	Hinte*
Niedersachsen	Emsland	Emsbüren*
Brandenburg	Oberhavel	Zehdenick*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Landhagen*
Schleswig-Holstein	Schleswig-Flensburg	Süderbrarup*
Sachsen	Leipzig	Grimma*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të



shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 206, datë 4.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 224, datë 6.3.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndaja administrative e nivelit 1	Ndaja administrative e nivelit 2	Ndaja administrative e nivelit 3
42	Lódzkie	Skiermiewice	Maków*
43	Dolnośląskie	Trzebnica	Wisznia Mała*
44	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
45	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
46	Wielkopolskie	Poznań	Kleszczewo*
47	Wielkopolskie	Września	Milosław*
48	Dolnośląskie	Wolów	Wińsko*
49	Śląskie	Gliwice	Toszek*
50	Śląskie	Częstochowa	Dąbrowa Zielona*
51	Dolnośląskie	Góra	Niechlów*
52	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
53	Mazowieckie	Siedlce	Zbuczyn*
54	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
55	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
56	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Dąbrówno*
57	Lódzkie	Sieradz	Warta*
58	Mazowieckie	Zuromin	Biezuń*
59	Podkarpackie	Jarosław	Jarosław (rural)*
60	Zachodniopomorskie	Goleniów	Osina*
61	Podkarpackie	Ropczyce-Sędziszów	Ostrów*
62	Lódzkie	Kutno	Krośnice*
63	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Kisielce*
64	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
65	Lódzkie	Zgierz	Ozorków (rural)*
66	Wielkopolskie	Koło	Grzegorzew*
67	Wielkopolskie	Kępno	Kępno*
68	Lubuskie	Nowa Sól	Kolsko*
69	Wielkopolskie	Kalisz	Żelazków*
70	Warmińsko-Mazurskie	Mragowo	Piecki*
71	Lódzkie	Sieradz	Goszczanów*
72	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
73	Warmińsko-Mazurskie	Mragowo	Mikołajki*
74	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
75	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Wielichowo*
76	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Kikół*
77	Podkarpackie	Lesko	Olszanica*
78	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
79	Małopolskie	Myslenice	Siepraw*
80	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Rakoniewice*
81	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Olsztynnek*
82	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
83	Wielkopolskie	Kościan	Czempiń*
84	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Janowiec Wielkopolski*
85	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzetnik*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 212, datë 4.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.



5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Nr. 1119/9, datë 4.3.2025

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 4.2.2025, me vendim nr. 11, datë 4.2.2025, të Autoritetit Klasifikues, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të dosjes së urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 639, datë 17.12.2024, “Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në I EVP të Sigurisë së Lartë” për të dënuarin Klement Çala, si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, i përbërë nga:

1. Relacion për vlerësim paraprak, nr. 1267 prot., datë 30.10.2024, i Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, Sektori i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Shkresa nr. 1267/1 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

3. Shkresa nr. 1267/2 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

4. Shkresa nr. 1267/3 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

5. Shkresa nr. 1267/4 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

6. Shkresa nr. 1267/5 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

7. Shkresa nr. 1267/6 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

8. Shkresa nr. 1267/7 prot., datë 30.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Nr. 1119/10, datë 4.3.2025

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’ të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 13.2.2025, me vendim nr. 16, datë 13.2.2025 të Autoritetit Klasifikues, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të dosjes së urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 620,



datë 13.12.2024, “Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë” për të dënuarin Fran Marashi, si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i përbërë nga:

1. Relacion për vlerësim paraprak nr. 1241 prot., datë 30.10.2024, i Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, Sektori i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Shkresa nr. 1241/1 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

3. Shkresa nr. 1241/2 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

4. Shkresa nr. 1241/3 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

5. Shkresa nr. 1241/4 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

6. Shkresa nr. 1241/5 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

7. Shkresa nr. 1241/6 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

8. Shkresa nr. 1241/7 prot., datë 24.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË MINISTRINË E DREJTËSISË

Nr. 1119/11, datë 4.3.2025

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin,

asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’ të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 17.2.2025, me vendim nr. 17, datë 17.2.2025, të Autoritetit Klasifikues, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të dosjes së urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 650, datë 26.12.2024, “Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë” për të dënuarin Aleksandër Llanaj, si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i përbërë nga:

1. Relacion për vlerësim paraprak nr. 1376 prot., datë 3.12.2024, i Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, Sektori i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Shkresa nr. 1376/1 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

3. Shkresa nr. 1376/2 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

4. Shkresa nr. 1376/3 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

5. Shkresa nr. 1376/4 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

6. Shkresa nr. 1376/5 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

7. Shkresa nr. 1376/6 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

8. Shkresa nr. 1376/7 prot., datë 3.12.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË MINISTRINË E
DREJTËSISË****Nr. 1119/12, datë 4.3.2025**

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’ të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 19.2.2025, me vendim nr. 21, datë 19.2.2025, të Autoritetit Klasifikues, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të dosjes së urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 623, datë 16.12.2024, “Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë”, për të dënuarin Altin Kodra, si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i përbërë nga:

1. Relacion për vlerësim paraprak, nr. 1224 prot., datë 21.10.2024, i Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, Sektori i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Shkresa nr. 1224/1 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

3. Shkresa nr. 1224/2 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

4. Shkresa nr. 1224/3 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

5. Shkresa nr. 1224/4 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

6. Shkresa nr. 1224/5 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

7. Shkresa nr. 1224/6 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për mendim”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

8. Shkresa nr. 1224/7 prot., datë 21.10.2024, e ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kërkesë për informacion”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BURGJEVE****Nr. 1119/13, datë 4.3.2025**

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, “Për miratimin e rregullores ‘Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’ të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 12.2.2025, me vendim nr. 15, datë 12.2.2025, të Autoritetit Klasifikues, dhe në datë 25.2.2025, me vendim nr. 26, datë 25.2.2025, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të fondkrijuesit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pjesë e dosjeve të urdhrave të ministrit të Drejtësisë nr. 639, datë 17.12.2024, Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë” për të dënuarin Klement Çala”, si dhe nr. 620, datë 13.12.2024, “Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë” për të dënuarin Fran Marashi”, si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i përbërë nga:

1. Shkresa nr. 2556/1 prot., datë 27.11.2024, me lëndë “Kthim përgjigje tuajës me nr. 1267/2 prot., datë 30.10.2024”, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, niveli i klasifikimit “Sekret”.



2. Shkresa nr. 2472/1 prot., datë 7.11.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me lëndë “Dërgohet informacion në përgjigje të shkresës me nr. 1241/6 prot., datë 24.10.2024”, niveli i klasifikimit “Sekret”.

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

VENDIM
Nr. 1, datë 17.1.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.1.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 17 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Sali Berisha, përfaqësuar nga avokatët Klodiana Gjyzari dhe Genc Gjokutaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Arben Kraja.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Legjislativ, Merita Qato.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 520, datë 30.12.2023 dhe nr. 521, datë 27.12.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar; nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar; nr. 00-2024-667 (94), datë 9.4.2024, të Kolegjit Penal të

Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 27, 29, 42, 46, pika 1, 70, pika 1, 73, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, 6, 7, 8, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDN*); nenet 9, 14, 15, 25 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit Sali Berisha (*kërkesë*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, u njoh me aktet e paraqitura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), i cili nuk ka mbajtur qëndrim për çështjen, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Kërkesi është aktualisht një politikan, drejtues i partisë kryesore opozitare dhe deputet i Kuvendit, si dhe ish-president dhe ish-kryeministër. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, Prokuroria e Posaçme në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (*KP*). Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit të pronës në favor të 5



familjeve ish-pronare, procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv “Partizani”), procesin e ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe të zhvillimit të pronës.

2. Me urdhrin e datës 2.10.2023 prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim me shtetasit J.M. dhe F.B., të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Për sa i përket kërkuesit, faktet penale objekt hetimi lidhen me sjelljen e dyshuar të tij gjatë kohës kur ai ka ushtruar funksionin e Kryeministrit, pas vitit 2005, në proceset e kthimit të pronës, të privatizimit të pronës shtetërore (objekteve të klubit sportiv “Partizani” në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Klubit Shumësportesh Partizani në varësi të Ministrisë së Kulturës), të ndryshimit të destinacionit dhe të zhvillimit të pronës, duke favorizuar shtetasit J.M., F.B. e XH.B., ku këta të fundit dhe shoqëria e lidhur me ta kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh. Për këto procese dyshohet se janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*.

3. Në datën 16.10.2023, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin, për të cilin është kërkuar vendosja e masave të sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Sipas Prokurorisë së Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se nga ana e kërkuesit, në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër, janë kryer veprime konkrete dhe aktive në drejtim të: përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve dhe të projektvendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vet politikë, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku përfitues i drejtpërdrejtë ishte edhe shtetasi J.M., bashkëshorti i vajzës së tij; kryerjes së kontrolleve administrative, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave

konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin procesin e privatizimit të klubeve sportive në favor edhe të shtetasit J.M.; vendosjes në dispozicion të shtetasit J.M. të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të kthimit të pronës, privatizimit të pronës shtetërore dhe ndryshimit të destinacionit të pronës edhe në favorin e këtij shtetasi. Po ashtu, sipas Prokurorisë së Posaçme, përfitimi i parregullt në favor të shtetasit J.M. lidhet me dyshimin se të gjitha këto procedura, pavarësisht interesit publik në lidhje me nevojën për ambiente sportive, janë bërë me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë pronën dhe për ta përdorur atë për përfitime materiale, ku si të tilla janë konsideruar të gjitha ato përfitime monetare që ky shtetas ka marrë përmes shoqërisë ndërtuese, konkretisht nga shpërndarja e fitimeve të saj të akumuluar ndërmjet viteve përpara se ai të deklarohet bashkortsak i saj, të llogaritura në shumën 672,976,832 lekë ose 5,420,345 euro.

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 (*vendimi nr. 112/2023*), ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar për kërkuesin masat e sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të KPP-së. Me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 (*vendimi nr. 117/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka disponuar me vazhdimin e këtyre masave. Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

5. Ndërkohë, një prej detyrimeve të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së të Shkallës së Parë, të konfirmuar me vendimin nr. 117/2023 të kësaj të fundit, konkretisht “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, nuk është përmbushur prej tij (kërkuesit). Në këtë rast, referuar procesverbaleve të datave 6.11.2023, 20.11.2023, 4.12.2023 dhe 18.12.2023, të mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për paraqitjen e kërkuesit, rezulton se ky i fundit nuk është paraqitur në asnjë nga këto data. Për këtë arsye, Prokuroria e Posaçme,



me argumentin se nga ana e kërkuarit nuk janë zbatuar këto vendime, për shkak se ai nuk ka ekzekutuar detyrimet e vendosura për të, konkretisht të paraqitjes në Policinë Gjyqësore, me kërkesën nr. 16688 prot., datë 12.12.2023 dhe relacionin bashkëlidhur saj, bazuar në nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, i ka kërkuar Kuvendit dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuarit për zëvendësimin e masave të sigurimit personal nga “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, në atë të “Arrestit në burg/shtëpi”, të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të KPP-së.

6. Për këtë arsye, në datën 18.12.2023 është zhvilluar mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (*Këshilli*), në të cilën kanë qenë të pranishëm dhe kanë shprehur qëndrimet e tyre, përveç deputetëve anëtarë të Këshillit, edhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësit e kërkuarit. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, Këshilli ka vendosur t’i rekomandojë seancës plenare pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuarit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit.

7. Po ashtu, Kuvendi, i mbledhur në seancë plenare në datën 21.12.2023, me vendimin nr. 127, datë 21.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuarit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Në datën 22.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë (gjyqtarit të hetimeve paraprake) kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuarit, e cila është pranuar me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të asaj gjykate (*vendimi nr. 520/2023*), duke u caktuar ndaj kërkuarit masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe duke u urdhëruar kërkuari të mos largohet nga banesa e tij, si edhe të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të.

8. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, kërkuari nuk ka përmbushur detyrimet që vijnë si rezultat i zbatimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të po asaj gjykate, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore. Sipas asaj gjykate, ekziston “dyshimi i arsyeshëm”, i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është

autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore/hetuesit dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në rastin konkret nevojat e sigurimit vijnë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuarit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, jemi para kushteve kur duhet të zëvendësohen masat e sigurimit të dhëna ndaj tij me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuarit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë shtetasi nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe të funksionit të tij aktual si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë ende rrethanat që kërkuari mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuari, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, të shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” me masën “Arresti në shtëpi”.

9. Mbi ankimin e kërkuarit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 520/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se pretendimet e kërkuarit për kontrollin e ligjshmërisë së autorizimit të dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë janë të pabazuara, pasi dalin jashtë juridiksionit gjyqësor dhe posaçërisht atij penal, respektimi i të cilit është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykimit, për shkak se gjykatat në këtë rast verifikojnë vetëm nëse ky autorizim i



kërkuar është dhënë. Bazuar në përcaktimet e nenit 231 të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar, njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë, se kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij. Edhe GJKKO-ja e Apelit, njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ka konsideruar se masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit, ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të kërkuesit në kufizim të lirisë së tij të komunikimit dhe së drejtës së shprehjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në respektim të kufijve diskrecionalë të caktuar nga pika 2 e nenit 237 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka përzgjedhur një kufizim që është proporcional dhe i motivuar nga interesi publik që prevalon mbi interesin personal të individit. Në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit, GJKKO-ja e Apelit lidhur me kërkesën/pretendimin e kërkuesit për cenimin e pavarësisë dhe paanësisë nga gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë, dhe të rrëzuar nga një gjyqtare tjetër e së njëjtës gjykatë, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, e ka vlerësuar si të bazuar rrëzimin e asaj kërkesë. Sipas GJKKO-së së Apelit të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuesit në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit e gjithë procedura e ndjekur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për caktimin e gjyqtarës që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarës nga shqyrtimi i çështjes, është në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe kërkesat ligjore të dispozitave të neneve 18 dhe 19 të KPP-së. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-667 (94), datë 9.4.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024 të GJKKO-së së Apelit. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancitë e lidhura me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një

gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre. Lidhur me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ai kolegji ka vlerësuar se janë të pambështetura në ligj e prova, pasi, në thelb, mbështeten tek ushtrimi i vendimarrjes nga gjyqtari, si edhe drejtimi dhe menaxhimi i procesit gjyqësor (nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve) konform tagrave që i njeh ligji. Në lidhje me themelin e çështjes, Kolegji Penal ka vlerësuar se të gjitha pretendimet që lidhen me ligjshmërinë e autorizimit të dhënë nga Kuvendi janë të pabazuara. Në rastin kur procedohet ndaj një deputeti të Kuvendit, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykata verifikon sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së, vetëm nëse autorizimi i kërkuar është dhënë ndërsa dhënia apo jo e autorizimit është në diskrecion të Kuvendit dhe ky kontroll i ligjshmërisë së dhënies së autorizimit nga Kuvendi dhe më tej marrja dhe lejimi i provave lidhur me një pretendim të tillë dalin jashtë juridiksionit gjyqësor, kjo për arsye se kompetenca për heqjen e imunitetit në çështjet penale është e vetë parlamentit (neni 73 i Kushtetutës).

11. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e tjera të kërkuesit kanë marrë përgjigje të argumentuara nga gjykatat më të ulëta. Sipas tij, pjesa e pretendimeve që lidhet me vlerësimin e rrethanave të faktit del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, por, megjithatë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsyen e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimarrjes



së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit, duke evidentuar “shmangien e dëmtimit të hetimeve” dhe “ikjen e kërkuesit” (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese “Arresti në shtëpi” me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë veç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimarrjes objekt rekursi.

12. Procesi gjyqësor në të cilin janë vendosur masat e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin e saj nr. 81, datë 21.11.2024, (*vendimi nr. 81/2024*), ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesës, duke shfuqizuar këto vendime gjyqësore vetëm për pjesën që kanë caktuar masën “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, për shkak të cenimit të parimit të proporcionalitetit, në aspektin e domosdoshmërisë së kësaj mase, në kushtet kur qëllimet e saj përmbushen nga masa tjetër e dhënë ndaj kërkuesit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

13. Ndërkohë, në datën 18.11.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore

që kanë zëvendësuar masat e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” me masën “Arresti në shtëpi”. Ky ankim kushtetues është regjistruar në datën 18.11.2024.

14. Në datën 26.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Gjithashtu, rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 674, datë 27.11.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit dhe revokimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, për shkak se nuk ekzistojnë më nevojat e sigurimit. Në vijim, për ankimin e Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Apelit, në datën 3.1.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit të lartpërmendur të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” me masën e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

16. Në datën 25.11.2024, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë një kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, e cila u pranua nga Gjykata.

17. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 3.12.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes, e cila është plotësuar me argumente shtesë në datën 13.1.2025. Po ashtu, i njëjti gjyqtar, në datën 10.1.2025 ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet nr. 30, datë 14.1.2025 dhe nr. 1, datë 14.1.2025, me shumicë votash²⁰, ka vendosur rrëzimin e kërkesave.

²⁰ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahim i votuan për pranimin e kërkesës së kërkuesit për përjashtim, sikundër edhe pranimin e kërkesës për heqje dorë të gjyqtarës, bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000. Në arritjen e këtij përfundimi u mor në konsideratë shkak i pretenduar nga kërkuesi, që është marrëdhënia e veçantë mes gjyqtarës dhe deputetit E.A., i cili, si anëtar i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit ka qenë i vetmi deputet i pakicës parlamentare dhe në raportin e hartuar prej tij është shprehur në favor të dhënies së autorizimit. Prania dhe vota e këtij deputeti në Këshill ka qenë përcaktuese për arritjen e kuorumit të vlefshëm për shqyrtimin e kërkesës në këtë Këshill, në përfundim të të cilit i është rekomanduar seancës plenare dhënia e autorizimit për caktimin e masës së arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit. Nga ana tjetër, gjyqtarja, si në kërkesën e saj për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, ashtu

edhe e dëgjuar nga trupa gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, nuk e mohoi ekzistencën e marrëdhënies së veçantë të pretenduar nga kërkuesi, ndërkohë që është shprehur se ajo ka paraqitur dorëheqjen, me qëllim ruajtjen e reputacionit të Gjykatës, perceptimit publik për paanshmërinë e saj dhe veçanërisht për të siguruar kërkuesin që procesi do të jetë i drejtë dhe i paanshëm. Në këto kushte, duke pasur parasysh që objekti dhe shkaqet e çështjes në shqyrtim nga Gjykata lidhen me kundërshtimin edhe të akteve të nënshkruara nga ky deputet ashtu edhe të pjesëmarrjes dhe ndikimit të tij në procedurën parlamentare të zhvilluar nga Këshilli, u konsiderua se shkaqet e parashtruara nga kërkuesi janë të tilla që justifikojnë pranimin e kërkesave për përjashtim dhe për heqje dorë, me qëllim garantimin e perceptimit publik dhe eliminimin e çdo dyshimi, qoftë edhe në dukje, për njëanshmërinë e kësaj Gjykate.



II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka cenuar:

18.1 *Procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit*, të parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës, për shkak se procedura e ndjekur në Kuvend për dhënien e autorizimit është bërë në kundërshtim me këtë dispozitë, pasi nuk është ndjekur procedura e parashikuar nga Kushtetuta për kufizimin e lirisë së deputetit në caktimin e masës së sigurimit që pretendohet se nuk është zbatuar nga kërkuesi. Masa e sigurimit ndaj kërkuesit është dhënë bazuar në informacione të pasakta dhe në mungesë të informacionit për ekzistencën e faktit penal, si edhe për veprimtari që mbrohen nga imuniteti absolut i deputetit, i parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës. Kërkuesi ka kundërshtuar procedurën e shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit në Kuvend, por gjykatat nuk i kanë shqyrtuar pretendimet e tij me arsyetimin se nuk mund të përbëjnë objekt vlerësimi gjyqësor. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për dhënien e masës së arrestit në shtëpi. Ishte detyrë e gjykatave të verifikonin nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e masave të sigurimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Ndërkohë, sipas kërkuesit, procedura për dhënien e autorizimit duhet të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor. Procedura e ndjekur nga Kuvendi është në shkelje të neneve 288 dhe 289 të KPP-së, pasi Kuvendi nuk ka verifikuar ekzistencën e faktit penal. Autorizimi për heqjen e lirisë së kërkuesit është dhënë bazuar në informacione të paplota, gjysmë të vërteta, në lidhje me detyrimet e masës së sigurimit që është pretenduar se nuk është përmbushur. Procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë e paragykuar politikisht, nisur nga deklaratimet në Këshillin për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin të deputetëve B.Ç., L.N., E.F. dhe E.A. Po ashtu, në këtë procedurë nuk janë shqyrtuar të gjitha provat, pasi ato nuk janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, por është bërë vetëm duke shqyrtuar vendimet gjyqësore që kishin caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e Policisë Gjyqësore. Pra, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e

të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij dhe nuk është verifikuar nga Kuvendi ekzistenca e këtij fakti penal.

18.2. Parimet e *paanshmërisë dhe pavarësisë*, pasi sipas neneve 42 dhe 48-51 të ligjit nr. 95/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (*ligji nr. 95/2016*), gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë nën vëzhgimin e një oficeri hetues. Ky vëzhgim mbulon të gjitha komunikimet elektronike dhe të tjera të gjyqtarëve, përfshirë edhe ato të familjarëve të tyre, dhe është i pakufizuar në kohë e hapësirë, si edhe nuk miratohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë në lidhje me proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje. Në këtë kuptim, gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë objekt i një monitorimi që nuk paraqet asnjë garanci ligjore dhe institucionale. Një vëzhgim i tillë i vazhdueshëm ngre dyshime serioze për pavarësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve të gjykatave të posaçme. Nuk është e mundur që një gjyqtar që gjendet nën një vëzhgim të tillë nga një hetues anonim, sipas nenit 42 të ligjit nr. 95/2016, të jetë një autoritet gjyqësor që plotëson kushtet e pavarësisë. Për më tepër, hetuesi i komunikimeve është pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), e cila varet nga Prokuroria e Posaçme, që është organi që ka kërkuar masat e sigurimit personal në rastin e kërkuesit dhe i mbron ato përpara gjykatave. Ky ligj cenon procesin e rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, sepse nuk garanton pavarësinë e gjyqtarëve. Gjithashtu, është cenuar edhe parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë I.GJ., që ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuesit, është shkarkuar nga detyra e gjyqtarës nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (*ish-KLD*) në vitin 1996, kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi në cilësinë e Presidentit të Republikës. Kjo kërkesë është paraqitur edhe në GJKKO-në e Shkallës së Parë, ku gjyqtarja për të cilën është paraqitur kërkesa për përjashtim ka caktuar edhe gjyqtaren tjetër që do të shqyrtonte këtë kërkesë për përjashtim, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm. Si përfundim, kërkesa për përjashtim nuk është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023.

18.3 *Të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatave përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë



dhënë zgjidhje të plotë dhe shteruese pretendimeve të ngritura. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkesit për pretendimin e tij për mbikëqyrjen e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme nga Prokuroria e Posaçme. Arsytimi i gjykatave në lidhje me procedurat për përjashtimin e gjyqtarës është telegrafik. GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar përse ka refuzuar marrjen e provave të kërkesit. Arsytimi arbitrar i GJKKO-së së Apelit nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila nuk është shprehur as për cenimin e parimit të pavarësisë për shkak të dispozitave të ligjit nr. 95/2016. Gjykatat nuk kanë arsyetuar pretendimin e kërkesit në lidhje me moskzistencën e kushtit procedural “Shkelja e detyrimeve që lidhen me një masë tjetër sigurimi”, të parashikuar nga neni 231 i KPP-së, duke qenë se vendimet me të cilat janë caktuar masat e sigurimit nuk i janë njoftuar atij.

18.4 Kërkesi ka ngritur pretendime edhe në drejtim të *së drejtës për mbrojtje efektive, të lidhur me parimin e barazisë së armëve*, duke argumentuar se GJKKO-ja e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim vendimin e saj nr. 23, datë 5.1.2024 (vendimi për papranueshmërinë e kërkesës për përjashtim), të kërkuar prej tij. GJKKO-ja e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim në vendimin e saj të ndërmjetëm për mosmarrjen e kësaj prove. Kjo provë ishte e rëndësishme, pasi provonte që kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë me një vendim të formës së prerë, është konsideruar e paraqitur brenda afatit dhe nuk është shqyrtuar për shkak se gjyqtarja për të cilën kërkohej përjashtimi kishte shpallur vendimin përfundimtar.

18.5 *Parimin e sigurisë juridike*, për shkak të mungesës së qartësisë dhe qëndrueshmërisë në interpretimin e dispozitave procedurale penale në zbatimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Nga interpretimi i neneve 246 dhe 417 të KPP-së, rezulton se vendimet të cilat kufizojnë lirinë personale të individit nuk janë menjëherë të ekzekutueshme, por ekzekutimi i tyre pezullohet nga ankimi. Për shkak të paqartësisë në lidhje me momentin e lindjes së detyrimit për zbatimin e masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkesit me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që është pretenduar se nuk janë zbatuar nga kërkesi dhe që më tej janë bërë shkak për kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, si edhe nga zbatimi dhe interpretimi i ndryshëm i kufizimit të së

drejtës personale të kërkesit nga autoritetet shtetërore, cenimi i lirisë së kërkesit me vendimet objekt të këtij ankimi kushtetues, nuk e plotëson kushtin e procedurave të parashikuara në ligj, në aspektin e qartësisë së këtyre procedurave.

18.6 *Lirinë personale*, për shkak se nuk është respektuar procedura e parashikuar në ligj në lidhje me moskzistencën e shkakut procedural për të cilin është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit, pasi vendimi gjyqësor mbi bazën e të cilit ishin caktuar masat e sigurimit personal nuk ka qenë i ekzekutueshëm deri në datën 21.11.2023 kur ka marrë formë të prerë. Shkaku për të cilin është zëvendësuar masa e sigurimit nuk ka ekzistuar, pasi nuk janë respektuar dispozitat që rregullojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Edhe pse masat e sigurimit për kërkesin janë dhënë nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe gjykatat kanë pranuar argumentet e Prokurorisë së Posaçme se ai nuk është paraqitur në Policinë Gjyqësore, ato (gjykatat) nuk kanë hetuar kur ka lindur detyrimi i kërkesit për t'i zbatuar ato masa sigurimi të caktuara me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Arsytimi i gjykatave se detyrimi për zbatimin e masave të sigurimit personal “*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*” ka lindur menjëherë me shpalljen e vendimit, është i gabuar dhe në kundërshtim me nenin 417 të KPP-së. Pra, zbatimi i masave të sigurimit personal “*Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*” ka qenë arbitrar, pasi detyrimi për zbatim për kërkesin lindte pasi të shqyrtohej ankimi nga GJKKO-ja e Apelit. Pas marrjes formë të prerë të vendimit nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, Prokuroria e Posaçme nuk ka nxjerrë urdhër, për pasojë vendimi nuk është vënë asnjëherë në ekzekutim dhe për kërkesin nuk ka lindur asnjë detyrim. Procedura e caktimit të masave të sigurimit të vendosura ndaj kërkesit ka qenë e paligjshme, për rrjedhojë edhe zëvendësimi i masës për shkak të moszbatimit të njëres prej masave të sigurimit të vendosura me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë është e paligjshme.

18.7 *Parimin e proporcionalitetit*, duke i kufizuar edhe të drejta të tjera të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë liria personale, e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit, e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar, për shkak se kufizimi i tyre është bërë pa ligj. Këto kufizime nuk



janë të nevojshme, pasi fakti penal i dyshuar, për të cilin është duke u kryer hetimi, nuk ka lidhje me ushtrimin nga kërkuesi të të drejtave që janë kufizuar nga gjykatat. Kufizimi nuk është proporcional. Gjykatat nuk kanë arsyetuar përse nevojat e sigurimit nuk garantoreshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë “Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar” dhe “Garancia pasurore”. Gjykatat nuk mund të përcaktojnë kufizime tej atyre të përcaktuara nga ligji. Ato i kanë kufizuar kërkuesit të drejtat politike dhe të lirisë së shprehjes, pavarësisht se në ushtrim të tyre nuk ka kryer ndonjë fakt të pretenduar penal dhe nuk është duke u hetuar për ndonjë fakt penal që ka lidhje me këto të drejta dhe liri. Në vendimet e ankimuara mungon tërësisht arsyetimi. Masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal. Fakti për të cilin është regjistruar procedimi penal nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi është veprimtari politike që rrjedh nga funksioni i deputetit.

18.8 *Parimin e mosdiskriminimit*, për shkak se kërkuesi është kryetari i partisë opozitare me numrin më të lartë të deputetëve në Kuvend. Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin.

19. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

19.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimeve të *pavarësisë dhe paanshmërisë*, për shkak të përcaktimeve të neneve 49-51 të ligjit nr. 95/2016, është i pabazuar, pasi ky i fundit parashikon një mjet mbikëqyrës për GJKKO-të, Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, si një masë parandaluese kundër korrupsionit në këto institucione, por pa cenuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të hetuesve. Sistemi i kontrollit i parashikuar në ato dispozita është i garantuar nga një procedurë strikte. Ligji nr. 95/2016 ka vendosur garanci të rëndësishme gjatë procesit të monitorimit, ku oficerit përgjegjës nuk i lejohej të dëgjojë telefonatat që shkelin të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Parashikimet e dispozitave të kundërshtuara nga kërkuesi janë parashikuar shprehimisht në nenin 135, pika 4, të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vendoset para faktit që duhet të shqyrtojë vetë dispozitën kushtetuese, ndërkohë që sipas nenit 131, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata kur vihet në lëvizje

për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

19.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së *mbrojtjes efektive* është i pabazuar, pasi ai gjatë gjithë kohës që ka qenë në masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” ka komunikuar vazhdimisht me mbrojtësit e tij. Kjo konfirmohet edhe nga ankimet e bëra prej tij ndaj vendimit të caktimit të masës së sigurimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe ankimin në këtë Gjykatë.

19.3 Pretendimi për antikushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi për *heqjen e imunitetit* është i pabazuar. Në lidhje me këtë pretendim edhe gjykatat e kanë dhënë përgjigjen e tyre në vendimet që kanë shqyrtuar ankimet e kërkuesit kundër vendimit që ka vendosur masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, ku thelbi i tyre ishte se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi nuk është objekt i vlerësimit gjyqësor.

19.4 Pretendimi i kërkuesit se nuk është zbatuar procedura e parashikuar në ligj për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi shkaku për të cilin është zëvendësuar ajo nuk ka ekzistuar, është i pabazuar. Sipas akteve konstatohet se edhe pse kërkuesi ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të mos u njohur me vendimin nr. 112/2023, në fakt, rezulton se ai është njohur me atë vendim, i cili u është vënë në dispozicion edhe mbrojtësve të kërkuesit, duke qenë se ata gëzonin tagrin për të marrë në dorëzim akte për llogari të tij. Gjithashtu, referuar të gjitha të dhënave të publikuara nga mediat, rezulton se kërkuesi është njohur me disponimin e vendimit nr. 112/2023, që ka caktuar masat e sigurimit personal të vendosura ndaj tij. Në këtë kuptim, rezulton se ka qenë vetë kërkuesi që ka refuzuar të marrë në dorëzim atë vendim, megjithëse ai është njohur me përmbytjen e tij.

19.5 Pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal është i pabazuar, pasi fakti penal është konfirmuar nga të dyja gjykatat në mënyrë të plotë dhe të qartë. Ky fakt penal është konsoliduar në vijim dhe çështja penale në ngarkim të tij është në fazën e gjykimit.

19.6 Pretendimi i kërkuesit se gjykatat nuk kanë argumentuar nevojshmërinë e masës së sigurimit personal, duke i cenuar edhe lirinë e shprehjes, të drejtat politike dhe lirinë e organizimit, është i pabazuar. Referuar vendimeve të gjykatave rezulton se ato kanë bërë një analizë tërësore të rezultateve të



hetimit dhe në këtë mënyrë kanë konkluduar me vendimmarrje në përputhje me dispozitat përkatëse. Ato vendime nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore, të paqarta ose në mungesë të elementeve formale. Edhe pse me masë sigurimi “Arresti në shtëpi”, kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të shprehjes, lirinë politike dhe atë të organizimit. Kushtet dhe kriteret në caktimin e masave të sigurimit janë analizuar qartësisht nga gjykatat.

20. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim përpara Gjykatës, duke mos mbajtur një qëndrim në lidhje me çështjen, por ka paraqitur kopje të akteve të procedurës parlamentare të ndjekur në rastin konkret për dhënien e autorizimit për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

21. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

22. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimin që kanë vendosur ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, për shkak të mospërbushjes të masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të caktuar ndaj tij me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Këto të fundit (vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023) kanë caktuar ndaj

kërkuesit edhe masën tjetër të sigurimit personal “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, por duke qenë se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” është zëvendësuar për shkak se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, Gjykata do t’u referohet atyre vendimeve vetëm për këtë masë sigurimi.

23. Gjykata vëren, gjithashtu, se me vendimin e datës 27.11.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e kërkuesit dhe ka revokuar masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, ndërsa GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 3.1.2025, ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Në kushtet kur vendimi gjyqësor objekt ankimi nuk prodhon më efekte për kërkuesin, Gjykata do të vlerësojë, së pari, nëse ai (kërkuesi) mbart ende statusin e “viktimës” që do ta legjitimonte për të paraqitur një ankim para kësaj Gjykate. Për këtë qëllim, Gjykata sjell në vëmendje interpretimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas të cilit fjala “viktimë”, sipas kontekstit të nenit 34 të KEDNJ-së, përcakton personin që preket drejtpërdrejt nga veprimi ose mosveprimi konkret. Sipas GJEDNJ-së, një vendim ose masë (e mëvonshme) në favor të kërkuesit, në parim, nuk është e mjaftueshme për ta privuar atë nga statusi i tij si “viktimë”, nëse autoritetet vendase nuk kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, duke korrigjuar më pas shkeljen konkrete të Konventës (*shih Afërdita Hysa kundër Shqipërisë, datë 21 shkurt 2023, § 52*).

24. Për këtë arsye, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, duke pasur parasysh se masa e sigurimit me heqje lirie ndaj kërkuesit (vendimi gjyqësor objekt ankimi) nuk u pranua për shkak të konstatimit të paligjshmërisë së saj, por si rezultat i ndryshimit të nevojave të sigurimit, kërkuesi e ruan statusin e viktimës dhe, për pasojë, legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësisht se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” është zëvendësuar nga gjykatat me një masë më të lehtë,



konkretisht me masën “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore, dhe ai proces është ende në pritje të gjyqimit nga Gjykata e Lartë, kërkuesi e mbart ende statusin e viktimës, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur.

25. Po ashtu, Gjykata evidenton se edhe ndryshimet e vazhdueshme të masës së sigurimit në ngarkim të kërkuesit nuk mund të konsiderohen si korrigjim, duke qenë se kërkesat për ndryshimin e masës së sigurimit mund të bëhen nga i dyshuari në çdo kohë dhe fati i tyre (pranimi ose jo nga gjykata) përcaktohet ekskluzivisht nga ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius* nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar. Thënë ndryshe, pavarësisht se masa e sigurimit e kundërshtuar nga kërkuesi “Arresti në shtëpi” nuk është më në fuqi për shkak të revokimit e, më pas, ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkesë nuk sjellin më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se kërkuesi ka qenë duke vuajtur një masë heqjeje të lirisë, për të cilën ai pretendon se është jokushtetuese dhe në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e tij.

26. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, duke qenë se ato lidhen me heqjen e lirisë së individit dhe konsiderohen përfundimtare për qëllime të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 13, datë 13.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Po për sa i përket plotësimit të kriterit të shterimit, Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeli meve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete

(*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 3, datë 11.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesi i ka shteruar formalisht të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeli meve në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm.

28. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ky kriter kërkon që pretendimet që parashtrihen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket plotësimit të këtij kriteri në drejtim të pretendimeve të paraqitura, Gjykata vëren se pretendimet e ngritura nga kërkuesi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, për shkak të mungesës së qartësisë dhe qëndrueshmërisë në interpretimin e neneve 246 dhe 417 të KPP-së, nga ku nuk rezulton e qartë nëse vendimet që kufizojnë lirinë personale të individit me masa sigurimi personal pezullohen ose jo nga ankimi i paraqitur në gjykatën e apeli; për cenimin e *lirisë personale*, për shkak se përmbushja e detyrimit të masës të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij ka lindur vetëm pasi vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka disponuar për të është miratuar nga GJKKO-ja e Apeli; për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit*, për shkak se Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin, ky i fundit nuk i ka ngritur as në ankimin e drejtuar GJKKO-së së Apeli, as në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se lidhur me këto pretendime dhe argumente ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

29. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkuesi, rezulton që ai t’i ketë parashtruar ato në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme dhe në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, konsiderohet se ai i ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

30. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 9.4.2024, u është komunikuar mbrojtësve të



kërkuesit në adresat e tyre të postës elektronike në datën 29.9.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 18.11.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

31. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, ai verifikohet në drejtim të përmbajtjes dhe natyrës së pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual. Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të pavarësisë* së gjyqtarëve të GJKKO-së për shkak të përmbajtjes së dispozitave të ligjit nr. 95/2016, të cilat përcaktojnë kontrollin periodik të telekomunikimeve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme dhe familjarëve të tyre të afërt nga BKH-ja. Po ashtu, në pretendimin e tij për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për pretendimin për efektet e regjimit të vëzhgimit për pavarësinë e gjyqtarëve të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas kërkuesit, vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka vendosur masën e sigurimit personal, e cila pretendohet nga Prokuroria e Posaçme se nuk është zbatuar prej tij, nuk i është njoftuar. Gjykata konstaton, gjithashtu, se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *imunitetit parlamentar*, duke argumentuar, ndër të tjera, se procedura e ndjekur në Kuvend për dhënien e autorizimit është bërë në kundërshtim me nenin 73 të Kushtetutës, për shkak se nuk është ndjekur procedura e parashikuar nga Kushtetuta për kufizimin e lirisë së deputetit në caktimin e masës së sigurimit që pretendohet se nuk është zbatuar prej tij.

32. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se në vendimin e saj nr. 81/2024, ajo ka marrë në shqyrtim edhe përmbajtjen e neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, duke vlerësuar se ato nuk cenojnë parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë në gjykim dhe se ligji përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve në mënyrën se si realizohet kontrolli (*shih paragrafët 65-77*). Po ashtu, në vendimin e saj nr. 81/2024, Gjykata ka vlerësuar se argumenti i kërkuesit, sipas të cilit Kuvendi duhet të japë autorizimin në rastin e caktimit të masave të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore dhe të

ndalimit të daljes jashtë shtetit, nuk pajtohet me parashikimin e nenit 73 të Kushtetutës dhe autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale (*shih paragrafët 58-59*)²¹. Në vlerësimin e saj, me vendimin nr. 81/2024, Gjykata ka evidentuar se nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë marrë të gjitha masat për njoftimin kërkuesit të vendimit nr. 112/2023, i cili ka disponuar për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit dhe pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë të bazuara (*shih paragrafin 87*).

33. Në këtë kuptim, Gjykata ripohon se kur ajo është shprehur më parë me vendim përfundimtar për themelin e pretendimeve të ngritura nga palët, ai vendim përbën pengesë për Gjykatën që të rimarrë përsëri në shqyrtim të njëjtat pretendime, të ngritura për të njëjtat shkaqe (*shih vendimin nr. 60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, duke pasur parasysh se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të posaçëm, si rrjedhojë e parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 95/2016, cenimit të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje atij lidhur me pretendimin për efektet e regjimit të vëzhgimit për pavarësinë e gjyqtarëve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që lidhen përsëri me dispozitat e ligjit nr. 95/2016, si edhe mosnjoftimit të vendimit nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, dhe imunitetit parlamentar, për shkak se nuk është ndjekur nga Kuvendi procedura e parashikuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës për dhënien e autorizimit për heqjen e lirisë së deputetit, i janë nënshtruar tashmë vlerësimit kushtetues dhe janë bërë objekt i një vendimmarrjeje të mëparshme kushtetuese me vendimin nr. 81/2024, duke u gjendur të pabazuara, Gjykata çmon se ato nuk mund të merren në shqyrtim.

34. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi ka argumentuar se caktimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, pavarësisht se ajo ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së masave të caktuara me vendimet nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duhet të respektojë edhe kriteret e tjera të parashikuara në nenin 27 të

²¹ Në vendimin nr. 81/2024 gjyqtarja në pakicë Sonila Bejtja ka mbajtur qasjen e saj se duhej të ishte marrë autorizimi nga

Kuvendi për lejimin e caktimit ndaj kërkuesit të masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”.



Kushtetutës dhe dispozitat përkatëse procedurale penale. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuarit lidhen me pasojat që ka sjellë zëvendësimi i masave të sigurimit në ushtrimin prej tij të të drejtave dhe lirive të tjera kushtetuese, siç janë liria personale, e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit dhe e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar. Sipas kërkuarit, këto kufizime nuk janë të nevojshme, pasi fakti penal i dyshuar, për të cilin është duke u kryer hetimi penal, nuk ka lidhje me ushtrimin prej tij të të drejtave dhe lirive që janë kufizuar nga gjykata dhe kufizimi nuk është proporcional. Po sipas kërkuarit, gjykata e zakonshme nuk kanë arsyetuar se përse nevojat e sigurimit në rastin konkret nuk garantoreshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë “Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar” apo “Garancia pasurore”. Në aspektin procedural, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e garancive që ofron e drejta për proces të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, në drejtim të parimit të paanshmërisë, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë nga ish-KLD-ja në kohën që drejtohej nga kërkuari në cilësinë e Presidentit të Republikës, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, së drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me parimin e barazisë së armëve, si edhe imunitetit parlamentar.

35. Gjykata, fillimisht, evidenton se masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuarit është “Arresti në shtëpi”. Gjithashtu, Gjykata vëren se me anë të kësaj mase, kërkuari është urdhëruar të mos largohet nga banesa, si edhe të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të, detyrime të cilat kanë intensitet të tillë që mund të barazohen me heqjen e lirisë. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se neni 27 i Kushtetutës garanton lirinë personale dhe funksionin e deputetit që ushtron kërkuari, si edhe thelbin e argumenteve të tij për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, vlerëson t'i shqyrtojë ato nën prizmin e lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe së drejtës substanciale për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të mandatit përfaqësues të deputetit nga kërkuari, të mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës, për shkak të caktimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale

36. Gjykata ka pohuar se ndërkohë që aspekti substancial i lirisë personale mbrohet nga neni 27 i Kushtetutës, për aspektin procedural të kësaj lirie ajo ka theksuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura. Po sipas Gjykatës, garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 19, datë 4.4.2023*), sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi të lidhura me garancitë e parashikuara nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, procedura e parashikuar nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së, kur është rasti, duhet të plotësojë të njëjtat garanci si ato të kërkuara në nenin 6 § 1 të Konventës për çështjet penale ose civile dhe ajo duhet të ketë karakter gjyqësor dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për llojin e heqjes së lirisë në fjalë (*shih vendimin nr. 83, datë 5.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Lidhur me kufizimin e lirisë personale, Gjykata vëren se sipas nenit 27, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës, liria e personit mund të kufizohet edhe për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës. Kurse sipas nenit 5, pika 4, të KEDNJ-së çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë, me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

38. Nga ana tjetër, sipas nenit 42 të Kushtetutës, liria dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

39. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se aspekti substancial i lirisë personale duhet analizuar nën dritën e nenit 27 të Kushtetutës (*shih vendimet nr.*



83, datë 5.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese), ndërsa aspekti procedural i saj nën atë të nenit 28 të saj të lidhur me nenin 42.

40. Po kështu, duke qenë se kërkuesi gëzon statusin e deputetit dhe procesi gjyqësor për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” me masën “Arresti në shtëpi” paraprihet nga procesi që zhvillon Kuvendi, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, për dhënien e autorizimit për caktimin e masës “Arresti në shtëpi”, Gjykata në vijim do të verifikojë në aspektin procedural si procedurën e zhvilluar nga Kuvendi, ashtu edhe procedurën e zhvilluar nga gjykatat.

41. Në këtë kuptim, Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuesit, në vijim do të shqyrtojë aspektet procedurale që kanë të bëjnë me: *i)* procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit; *ii)* të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit; *iii)* parimin e paanshmërisë në kuadër të ankimeve të bëra gjatë procesit gjyqësor, për shkak të lirimit të gjyqtarës I.Gj. nga detyra nga ish-KLD-ja dhe për shkak të mosmarrjes në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit të pretendimit të kërkuesit për paraqitjen e kërkesës së dytë për përjashtimin e asaj gjyqtareje, si aspekte procedurale të të drejtave substanciale të sipërpërmendura; *iv)* aspektin substancial të kufizimit të këtyre të drejtave në drejtëm të parimit të proporcionalitetit të masës së sigurimit të vendosur për kërkuesin.

B.1.1 Për aspektet procedurale të cenimit të lirisë personale

B.1.1.1 Për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit

42. Kërkuesi ka pretenduar se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë paragykuar politikisht, nisur nga deklaratimet e bëra në Kuvend në mbledhjen e Këshillit nga deputetët të B.Ç., L.N., E.F. dhe E.A. Sipas kërkuesit, procedura e zhvilluar në Kuvend ka qenë e paragykuar politikisht, nisur nga dhënia e opinionit në lidhje me kërkesën e deputetit B.Ç. dhe opinionet e anëtarëve të tjerë të Këshillit. Në vlerësimin e kërkuesit, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nga Këshilli nuk janë shqyrtuar të gjitha provat, pasi ato nuk janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, por janë shqyrtuar vetëm vendimet gjyqësore që kishin caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e

Policisë Gjyqësore për përmbushjen e atyre masave. Pra, sipas kërkuesit, në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij dhe nuk është verifikuar nga Kuvendi ekzistenca e këtij fakti penal. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për dhënien e masës së arrestit në shtëpi. Po sipas kërkuesit, ishte detyrë e gjykatave të verifikonin nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

43. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar, duke argumentuar, se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi gjykatat e kanë dhënë përgjigjen e tyre në vendimet që kanë shqyrtuar ankimet e kërkuesit kundër vendimit që ka vendosur masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, ku thelbi i tyre ishte se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi nuk ishte objekt i vlerësimit gjyqësor. Sipas Prokurorisë së Posaçme, pretendimi i kërkuesit se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të faktit penal është i pabazuar, pasi fakti penal është konfirmuar nga të dyja gjykatat në mënyrë të plotë dhe të qartë dhe se ky fakt penal është konsoliduar në vijim dhe çështja penale në ngarkim të tij është në fazën e gjykimit në themel.

44. Gjykata ka pohuar se regjimi i imuniteteve, në çdo rast, synon, nga njëra anë, të garantojë ushtrimin e qetë dhe të pandikuar të funksioneve të rëndësishme publike nga zyrtarët e lartë të shtetit, të cilët nuk duhet të druhen se veprimtaria e tyre shtetërore mund të bëhet shkas për pasoja personale, si, për shembull, një padi civile ose një akuzë penale. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, dispozitat që përbëjnë regjimin e imuniteteve synojnë të garantojnë përgjegjshmërinë e këtyre funksionarëve të lartë në qoftë se, në përfundim të verifikimeve përkatëse dhe një procesi të rregullt ligjor, rezulton se veprimet e tyre nuk janë të motivuara nga interesi publik, por nga interesi privat ose keqbesimi (*shih vendimin nr. 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Imuniteti i deputetëve nuk është privilegj personal i tyre, por qëllimi kryesor i tij (imunitetit parlamentar) është mbrojtja e vetë parlamentit dhe në veçanti funksionimi i duhur i tij. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se duhet të ekzistojë një prezumim themelor që imuniteti duhet të hiqet në të



gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit përkatës janë të motivuara politikisht dhe se paprekshmëria e tij duhet të zbatohet vetëm në rastet kur ka arsye për të dyshuar se në vendimin për ndjekjen penalisht të deputetit ka elemente partiako-politike (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se paprekshmëria penale ndihmon për të arritur pavarësinë e plotë të Parlamentit, duke parandaluar çdo mundësi të procedimeve penale të motivuara politikisht (*fumus persecutionis*) dhe mbron pakicën parlamentare nga presioni ose abuzimi i shumicës parlamentare. Mekanizmi për zbatimin e detyrimit parlamentar, që konsiston në marrjen e një vendimi për të hequr apo jo imunitetin, është një nga mënyrat me të cilat Parlamenti ushtron autonominë e tij (*shih vendimin Kart kundër Turqisë, datë 3 dhjetor 2009, §§96, 101*).

47. Në lidhje me procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit, Komisioni i Venecias ka mbajtur qëndrimin se është e vështirë për Kuvendin (komisionin parlamentar përkatës) të vlerësojë heqjen e imunitetit pa u futur në detajet dhe themelin e akuzave penale të rastit specifik dhe pa formuar një opinion paraprak. Gjithashtu, sipas Komisionit të Venecias, kjo është në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, sipas të cilit vetëm gjykatat mund të vlerësojnë përgjegjësinë penale individuale. Organi parlamentar që shqyrton kërkesat për heqje imuniteti nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes si të tillë (*shih raportin CDL-AD (2014) 011 të Komisionit të Venecias*).

48. Për sa më lart, referuar edhe pretendimeve të kërkuarit, për të vlerësuar nëse në rastin konkret ka pasur cenim të procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit parlamentar, Gjykata, në vijim, do ta analizojë këtë pretendim, duke u bazuar në aktet e Këshillit (procesverbali dhe raportet), aktet mbi të cilat anëtarët e Këshillit kanë vlerësuar dhënien e autorizimit, si edhe rrethanat e rastit konkret. Në këtë kuptim, Gjykata do ta analizojë nëse procedura e ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së arrestit ndaj kërkuarit ka qenë e ndikuar politikisht dhe nëse ka qenë e bazuar në prova të mjaftueshme.

49. Në rastin konkret, rezulton se Prokuroria e Posaçme në datën 12.12.2023 i është drejtuar Kuvendit me kërkesë për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit (kërkuarit)

nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, për shkak se kërkuari nuk kishte zbatuar detyrimet e vendosura më parë ndaj tij, duke paraqitur edhe relacionin shoqërues, si edhe provat ku mbështeste kërkesën e saj. Sipas Prokurorisë së Posaçme, në rastin konkret përmbushen kërkesat e parashikuara nga nenet 231 dhe 260 të KPP-së, pasi personi nën hetim (kërkuari), në mënyrë të përsëritur, nuk ka zbatuar detyrimet që i janë ngarkuar nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore. Për këtë arsye, Kuvendi ka nisur procedurën për shqyrtimin e kësaj kërkeje të Prokurorisë së Posaçme, duke thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 18.12.2023.

50. Referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, si dhe akteve bashkëlidhur kërkesës, rezulton që kërkesa, relacioni dhe provat (procesverbalet e oficerit të Policisë Gjyqësore për paraqitjen e kërkuarit dhe vendimet gjyqësore që kanë vendosur masat e sigurimit personal, të cilat nuk janë zbatuar prej tij) të jenë vënë në dispozicion të anëtarëve të tij. Rezulton, gjithashtu, që mbrojtësit e kërkuarit t'i kenë kërkuar Këshillit pezullimin e procedurës për dhënien e autorizimit nga Kuvendi deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese të çështjes së paraqitur nga kërkuari për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Në lidhje me këtë kërkesë anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje kanë votuar për rrëzimin e saj. Në vijim, anëtarët e Këshillit i kanë drejtuar pyetje prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësve të kërkuarit. Po kështu, rezulton që në mbledhje të kenë shprehur mendimin e tyre në lidhje me kërkesën për dhënien e autorizimit të Kuvendit edhe deputetja E.F., si edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputeti B.Ç., i cili ka pohuar se “*ne [...] si grup parlamentar do të votojmë çdo kërkesë për heqje imuniteti [...]*” (faqe 62). Në vlerësimin e këtyre anëtarëve të Këshillit (E.F. dhe B.Ç.) vetë kërkuari është shprehur që të jetë pa imunitet dhe se ai nuk ka respektuar dhe ka injoruar vendimet e gjykatave, si edhe se në rastin konkret janë rënduar nevojat e sigurimit, pasi ai ka mobilizuar njerëz duke i sjellë pranë godinave të Kuvendit dhe pretendon t'i sjellë sërish në sallën e seancave plenare për të



bllokuar punën e Kuvendit dhe dhënien e autorizimit.

51. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli i ka rekomanduar seancës plenare dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Megjithatë, për sa kohë që në lidhje me arsyet e dhënies së autorizimit ka pasur mendime të ndryshme ndërmjet anëtarëve të Këshillit, seancës plenare i janë paraqitur dy raporte rekomanduese. Sipas njërit raport (i deputetëve të shumicës anëtarë të Këshillit) kërkesa e paraqitur nga mbrojtësit e kërkuesit për pezullimin e procedurës për dhënien e autorizimit është e pabazuar në ligj, pasi nuk ka asnjë dispozitë ligjore mbi të cilën të mbështetet ajo, si edhe nuk ka asnjë vendim të Gjykatës për pezullimin e kësaj procedure. Sipas këtij raporti, Këshilli nuk mund të marrë në shqyrtim bazueshmërinë në prova dhe fakte të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, pasi do të cenonte parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe se vlerësimin nëse janë ose jo kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi personal e kanë gjykatat, bazuar në parashikimet e KPP-së. Po sipas këtij raporti, nga pikëpamja formale kërkesa e Prokurorisë së Posaçme është në përputhje me kërkesat ligjore dhe ai organ legjitimohet ta paraqesë atë në Kuvend. Sipas anëtarëve të shumicës, kërkesa plotëson kriteret e nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, pasi bëhet për ato shkaqe që parashikon kjo dispozitë dhe është në përputhje edhe me nenin 228, pikat 1 dhe 2, të KPP-së, duke u shoqëruar me relacionin shpjegues dhe provat përkatëse, sipas kërkesave të kësaj dispozite. Gjithashtu, sipas këtij raporti, gjatë shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, nuk rezultoi që ajo të jetë bërë në kushtet e ndikimit politik apo të një natyre/ndërhyrje tjetër të padrejtë që të bjerë ndesh me interesat e drejtësisë.

52. Sipas raportit tjetër rekomandues (i deputetit të pakicës anëtar i Këshillit), nga analiza e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, relacionit shoqërues dhe përgjigjeve të prokurorëve në mbledhjen e Këshillit konstatohet pa asnjë dyshim ekzistenca e procedimit penal ndaj kërkuesit dhe rrjedhimisht arrihet në përfundimin se plotësohet kushti ligjor se ndaj tij ekziston procedimi penal. Gjithashtu, sipas këtij raporti, konstatohet pa asnjë dyshim se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme tregon kushtet ligjore për veprimet e arrestit dhe të kontrollit, në përputhje me nenin 288 të KPP-së dhe evidentohen qartazi

kushtet e neneve 228, 229, 230, 231, pika 1 dhe 260, pika 3, të KPP-së, që lidhen me i) dyshimet e arsyeshme të bazuara në prova; ii) rrezikun përkundrejt procedimit; iii) papërshtatshmërinë e masave të tjera. Në vijim, në këtë raport është pohuar se në vlerësimin në themel të çështjes për mbajtjen ose jo të imunitetit, në këtë rast vërehen lehtësisht plotësimet e kriterëve në favor të dhënies së autorizimit, duke u renditur edhe arsyet për këtë pohim.

53. Në rastin konkret, në lidhje me argumentin e kërkuesit se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje për pretendimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur nga Kuvendi për dhënien e autorizimit, Gjykata vëren se sipas gjykatave, GJKKO-së së Apelit dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet e ngritura nga kërkuesi se gjykata e shkallës së parë duhet të kontrollonte ligjshmërinë e autorizimit të dhënë nga Kuvendi, del jashtë juridiksionit gjyqësor dhe posaçërisht atij penal, respektimi i të cilit është thelbësor për të garantuar paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykimit. Po sipas atyre gjykatave, në të kundërt me sa pretendon kërkuesi, në rastin kur procedohet ndaj një deputeti të Kuvendit, gjykata verifikon sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 288, pika 1, të KPP-së, vetëm nëse ky autorizim i kërkuar është dhënë, ndërsa dhënia ose jo e autorizimit nga Kuvendi për të hequr imunitetin ose mburojë procedurale ndaj deputetit është në diskrecion të tij dhe ka si qëllim jo të pengojë hetimet, por të mbrojë funksionin e deputetit nga sulmet abuzive të pushteteve të tjera (*shih faqen 14 të vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe paragrafin 52 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

54. Për sa më lart, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi, dhe i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për të. Në vlerësimin e Gjykatës, shqyrtimi i pretendimit për ligjshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi nuk hyn në juridiksionin e gjykatave që shqyrtojnë masat e sigurimit personal.



Për këtë arsye, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuessit nuk është i bazuar²².

55. Po kështu, referuar pretendimit tjetër të kërkuessit se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit ka qenë e paragjykuar politikisht, bazuar në sa u parashtrua më sipër nga aktet e Kuvendit (procesverbalit të Këshillit dhe dy raporteve rekomanduese), Gjykata çmon se edhe pse gjatë diskutimit të anëtarëve të Këshillit, në mbledhjen e këtij të fundit, nga disa deklarata të anëtarëve të atij Këshilli, vërehen nuanca politike në trajtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme ose edhe paracaktimi i mënyrës së votimit të tyre, kjo është e pranueshme në kontekstin e diskutimeve në një institucion politik të përbërë nga përfaqësues të politikës, siç është Kuvendi, dhe nuk do të thotë se dhënia e autorizimit ka qenë e ndikuar politikisht. Për më tepër që kërkuessi në kërkesën e tij i referohet në tërësi opinioneve/deklaratave dhe pyetjeve të deputetëve anëtarë të Këshillit, por nuk ka treguar dhe nuk ka arritur të provojë se si këto opinione/deklarata ose pyetje kanë paragjykuar vendimarrjen e Këshillit.

²² Në vijim të arsyetimit të mësipërm, gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja vlerësuan se për procedurën parlamentare për heqjen e imunitetit të deputetit, Gjykata ka juridiksion original për sa i përket ligshmërisë dhe kushtetutshmërisë së saj.

²³ Në vlerësimin e gjyqtareve Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja, në lidhje me pretendimet për procedurën parlamentare Gjykata ka juridiksion origjinal, ndaj e gjejnë të drejtë arsyetimin e gjykatave të zakonshme për mosmarrjen në shqyrtim të këtyre pretendimeve. Në këtë aspekt, kërkuessi mund t'i ishte drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës për kundërshtimin e procedurës parlamentare për dhënien e autorizimit pa qenë e nevojshme t'u drejtohej gjykatave të zakonshme. Thënë kjo, në vlerësimin e këtyre gjyqtareve, procedura parlamentare për heqjen e imunitetit, në kuptim të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës kërkon që Kuvendi, përpara dhënies së autorizimit, siç ka thënë edhe Komisioni i Venecias, të verifikojë dhe garantojë, *së pari*, që shqyrtimi i masës së kërkuar të mos mbartë ngjyrimet politike dhe, *së dyti*, që masa e kërkuar të jetë proporcionale dhe e nevojshme për të respektuar balancën mes interesit publik që lidhet me nevojat e procedimit penal dhe garantimit të ushtrimit efektiv të veprimtarisë parlamentare ose të drejtave të deputetëve. Për sa i përket shqyrtimit të kërkesës për heqjen e imunitetit, sipas Komisionit të Venecias Kuvendi nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes dhe nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës ose të bazueshmërisë së procedimit penal (*shih raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2014)001 (maj 2014)*). Për sa i përket kërkesës që *procedura të mos mbartë ngjyrimet politike*, referuar deklaratave të deputetëve anëtarë të Këshillit, sipas procesverbalit të mbledhjes të datës 18.12.2023, anëtarët e Këshillit i kanë drejtuar pyetje prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe mbrojtësve të kërkuessit, konkretisht deputetja K.B. ka pohuar: “Besoj se ju jeni të qartë se arsyeja që ne po bëjmë këtë mbledhje [...] është në vijim të shkëlqeve të klientit tuaj [...]” (faqja 50). Deputeti E.A., përfaqësues i pakicës parlamentare në Këshill, ka pohuar se “[...] ka një Kod të Sjelljes së deputetëve në këtë Parlament [...], ku [...] parashikohet se deputeti nuk duhet

56. Në arritjen e këtij përfundimi, Gjykata ka parasysh edhe se, siç del qartësisht nga diskutimet në Këshill, qëllimi i deklaratave/pohimeve të deputetëve, në kuadër të procedurës parlamentare për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuessit, ka qenë arsyetimi lidhur me ekzistencën e kushteve për dhënien ose jo të autorizimit dhe jo përcaktimi i fajësisë ose pafajësisë penale të tij. Gjykata thekson, gjithashtu, se fakti që procedura parlamentare për dhënien e autorizimit për heqjen e lirisë së kërkuessit është vënë në lëvizje për shkak të mospërbushjes nga kërkuessi të detyrimeve të vendosura më parë nga gjykatat, konkretisht për zbatimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, është një tjetër tregues i rëndësishëm i faktit që ajo (procedura) nuk ka qenë e ndikuar politikisht. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa pretendon kërkuessi, Gjykata çmon se procedura e zhvilluar nga Kuvendi për dhënien e autorizimit nuk ka qenë e paragjykuar politikisht dhe pretendimi i tij në këtë drejtim nuk është i bazuar²³.

të përfutojë mbrojtje nga imuniteti” (faqja 60). Po sipas këtij deputeti “[...] qëndrimi që ka mbajtur Partia [...], po edhe unë [...], ka qenë që, po sa bërë ka një kërkesë për dhënie/lënie imuniteti, në të jemi pro” (faqja 67); “zero imunitet për askënd” (faqja 69). Po kështu, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputeti B.Ç., ka pohuar se “Ne [...] si Grup Parlamentar do të votojmë çdo kërkesë për heqje imuniteti [...]” (faqja 62). Referuar këtyre qëndrimeve konstatohet se anëtarët e Këshillit e kanë trajtuar kërkesën për autorizim *en bloc*, duke mbajtur qëndrim politik dhe duke mos u ndalur në vlerësimin e saj individualisht. Këto qëndrime, duke pasur parasysh edhe faktin se kallëzimi penal ndaj kërkuessit është paraqitur nga ish-kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, shtetasi T.B., ndaj kryetarit të partisë më të madhe opozitare, nuk japin garanci se procedura parlamentare ka qenë e paanshme, për të treguar se ajo nuk ka mbartur ngjyrimet politike. Nga ana tjetër, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për autorizim edhe pse procedura e zhvilluar nga Kuvendi nuk është e njëjtë me atë që bën gjykata, sipas Komisionit të Venecias, e referuar edhe nga shumica, kjo ka të bëjë me ndalimin e organit parlamentar që të bëjë vlerësim ligjor në drejtim të fajësisë së deputetit ose bazueshmërisë së procedimit penal. Thënë kjo, Kuvendi, edhe pse nuk merr atributet e një organi gjyqësor, thirret në këtë rast për të shqyrtuar nëse kërkesa për kufizimin e lirisë së deputetit nuk është haptazi e pabazuar, pra nëse ajo është bërë në përputhje me kriteret dhe kushtet ligjore dhe nëse respekton raportin mes qëllimit të procedimit penal dhe garantimit të autoritetit dhe legjitimitetit të Kuvendit. Referuar raporteve rekomanduese të Këshillit, atij të shumicës dhe pakicës parlamentare, duket se ato (raportet) kanë bërë një vlerësim ligjor të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit, me qëllim zëvendësimin e masës së mëparshme të sigurimit, duke analizuar kriteret dhe kushtet ligjore që lejojnë caktimin e masës kufizuese të lirisë, çka është në kundërshtim me qëndrimin e Komisionit të Venecias. Vlerësimi që bën Kuvendi në procedurën për shqyrtimin e kërkesës për heqjen e imunitetit të deputetit është në funksion të vlerësimit



57. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuarit se në procedurën e zhvilluar në Kuvend nuk ka pasur akte provuese mbi bazën e të cilave mbështetet konkluzioni për ekzistencën e faktit penal në ngarkim të tij, Gjykata vlerëson të theksojë se në procedurën për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit, pra heqjes së imunitetit të tij, nga Kuvendi nuk është i nevojshëm administrimi i të gjithë dosjes gjyqësore në ngarkim të deputetit, por vetëm i atyre akteve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se deputeti ka kryer shkeljen për të cilën kërkohet autorizimi, që në rastin konkret janë vendimet gjyqësore që kanë caktuar më parë masat e sigurimit personal ndaj tij dhe procesverbalet e mbajtura nga oficeri i Policisë Gjyqësore, për (mos)paraqitjen e tij sipas detyrimeve të vendosura në ato vendime. Në këtë rast, Gjykata, bazuar edhe në raportin e Komisionit të Venecias, mbështet qëndrimin e këtij të fundit se organi parlamentar që shqyrton kërkesën për heqjen e imunitetit nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes dhe nuk duhet në asnjë rrethanë të japë qëndrimin e tij për fajësinë ose jo të deputetit përkatës apo bazueshmërinë e procedimit penal. Në këtë rast, duhet të ekzistojë një prezumim themelor se imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se akuzat ndaj deputetit janë të motivuara politikisht (*shih raportin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2014)001 (maj 2014)*). Pra, në vlerësimin e Gjykatës, Kuvendi, në shqyrtimin e kërkesës për heqjen e imunitetit, nuk duhet të vlerësojë përgjegjësinë penale të deputetit dhe as (pa)fajësinë e tij, por vetëm të sigurohet se ekziston dyshimi i arsyeshëm që ai (deputeti) të ketë kryer shkeljet për të cilat kërkohet heqja e imunitetit, si edhe që kjo kërkesë për heqjen

e imunitetit parlamentar të mos jetë e ndikuar politikisht.

58. Në këtë kuptim, Gjykata çmon të theksojë se natyra e vendimeve të marra nga organet politike të Kuvendit, siç mund të jetë në rastin konkret Këshilli, të cilat në vetvete kanë natyrë politike, nuk mund të jetë e njëjtë me natyrën e një vendimi gjyqësor. Për këtë arsye ai jo domosdoshmërisht duhet të plotësojë të njëjtat kriteret të një vendimi gjyqësor. Gjithashtu, Gjykata thekson se edhe pse procedura parlamentare për heqjen e imunitetit duket sikur ndërhyr në parimin e prezumimit të pafajësisë, për shkak se mund të perceptohet si një lloj gjykimi politik për themelin e çështjes së (pa)fajësisë së deputetit, kjo procedurë nuk duhet kurrësi të ketë natyrën e një procedimi gjyqësor ose t'i ngajë atij, dhe në asnjë rast organi që zhvillon këtë procedurë nuk duhet të vlerësojë (pa)fajësinë e deputetit të cilit kërkohet t'i hiqet imuniteti, e cila vlerësohet vetëm nga gjykatat. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson të ripohojë qëndrimin e saj se imuniteti i deputetit nuk përbën përjashtim nga rregulli, sipas të cilit çdo person që kryen një vepër penale është subjekt i përgjegjësisë penale, që ndiqet nga prokurorët dhe në fund vendoset nga gjykatat e pavarura (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Për këtë arsye, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, Gjykata vlerëson se aktet e paraqitura nga organi i akuzës për dhënien nga Kuvendi të autorizimit për arrestimin e kërkuarit, pra heqjes së imunitetit të tij, duket se sjellin mjaftueshëm të dhëna për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, nuk është i bazuar²⁴.

të proporcionalitetit të masës kufizuese të lirisë, duke vënë në balancë nevojën e saj për qëllime të procedimit penal dhe pamundësinë e ushtrimit të mandatit të deputetit si rrjedhojë e kufizimit të lirisë, çka rezulton të mungojë në rastin konkret. Kjo merr rëndësi në situatën kur kufizimi i lirisë ndaj kërkuarit nuk ka qenë i nevojshëm në fillimin e procedimit penal, por është kërkuar nga prokuroria jo për shkak të rëndimit të nevojave të sigurimit, pra për shkak të ndryshimit të tyre krahasimisht me momentin e caktimit të masës së parë, por për mospërmbushjen e detyrimeve të masës “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Në këto kushte, analiza e proporcionalitetit të masës kufizuese të lirisë së kërkuarit është detyra kryesore e Kuvendit dhe arsyeja se përse ky organ është thirrur në këtë procedurë, si garanci për ushtrimin e mandatit të deputetit në emër të ruajtjes së funksionalitetit të vetë Kuvendit. Për rrjedhojë, për shkak të mënyrës se si është zhvilluar procedura e shqyrtimit të kërkesës për autorizim në rastin konkret, si referuar deklaratave dhe qëndrimeve të anëtarëve të Këshillit,

ashtu edhe për shkak të mungesës së analizës në drejtim të proporcionalitetit të masës së kërkuar dhe votimit të saj *en bloc*, këto gjyqtare janë të qëndrimit se kjo procedurë nuk ka përmbushur garancitë e kërkuara kushtetuese.

²⁴ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi se pretendimi i kërkuarit për procedurën parlamentare është i bazuar. Në vendimin nr. 81/2024 kjo gjyqtare ka mbajtur qëndrimin në pakicë se është cenuar procedura parlamentare për heqjen e imunitetit të kërkuarit, për sa kohë që Prokuroria e Posaçme, në kundërshtim me nenin 73, pika 2, të Kushtetutës, nuk ka marrë autorizimin e Kuvendit për caktimin masës së sigurimit personal “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të caktuar së bashku me masën tjetër “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, çka ka qenë edhe pretendimi kryesor i ngritur nga kërkuari në gjykatat e zakonshme dhe në vijim në Gjykatë. Për rrjedhojë, në linjë me atë qëndrim, për sa kohë që vendimi për masën e sigurimit që nuk është përmbushur nga kërkuari, çka ka sjellë edhe zëvendësimin e masave të vendosura



B. 1.2.2. Për cenimin e procedurës gjyqësore

B.1.2.2.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

60. Kërkuksi ka pretenduar se arsyetimi i gjykatave për procedurat për përjashtimin e gjyqtarëve është telegrafik dhe vendimet përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë e shteruese pretendimeve të ngritura prej tij. Po ashtu kërkuksi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit nuk ka arsyetuar se përse ka refuzuar marrjen e provave të tij dhe se arsyetimi arbitrar i asaj gjykate nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë. Po sipas kërkuksit, gjykatat nuk kanë arsyetuar pretendimin e tij në lidhje me moskuzhtësinë e kushtit procedural “Shkelja e detyrimeve që lidhen me një masë tjetër sigurimi”, të parashikuar nga neni 231 i KPP-së, duke qenë se vendimet me cilat janë caktuar masat e sigurimit nuk i janë njoftuar atij.

61. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar duke argumentuar se vendimet e gjykatave nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore, të paqarta ose në mungesë të elementeve formale, duke plotësuar kështu elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjykatat i kanë dhënë përgjigje kërkuksit për pretendimet e ngritura prej tij.

62. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t’i drejtohet një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve), përfshirë edhe pretendimet që mund të ngrihen nga pala tjetër, e ndryshme nga kërkuksi, në kuadër të ankimeve që mund të bëhen gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 73, datë 17.10.2024; nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një

vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 24, datë 9.4.2024; nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 34, datë 13.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me shkaqet që kanë çuar në pranimin e kërkesës së

më parë ndaj tij me një masë më të ashpër të sigurimit personal, konkretisht “Arresti në shtëpi”, objekt i këtij gjykimi, është marrë mbi një procedurë jokushtetuese, ai vendim që caktonte ato masa, nuk mund të sillte asnjë pasojë, për rrjedhojë edhe ato nuk mund të sillnin asnjë pasojë ndaj lirisë personale të kërkuksit. Kjo do të thotë se mosrespektimi i procedurës parlamentare për shkak të mosmarrjes së autorizimit, si një kërkesë kushtetuese, shkelja e së cilës ka vesuar të gjithë procesin për caktimin e masave kufizuese

Faqe | 5716

të lirisë sjell pasoja të drejtpërdrejta edhe në procesin e zëvendësimit të atyre masave, duke e vesuar edhe këtë proces nga pikëpamja kushtetuese. Për këto arsye, për sa kohë që në vlerësimin e kësaj gjyqtareje caktimi i masës së kundërshtuar është në kundërshtim me Kushtetutën për arsyet si më sipër, ajo nuk ndalet më tej në vlerësimin e kritereve të tjera ligjore në caktimin e masave kufizuese të lirisë, për rrjedhojë as në proporcionalitetin e saj.



Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe caktimin ndaj tij të masës “Arresti në shtëpi”, si në drejtim të kriterëve dhe kushteve për caktimin e masave të sigurimit me natyrë shtrënguese, ashtu edhe në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi dhe nëse ky arsyetim plotëson standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

66. Gjykata vëren se me kërkesën e datës 22.12.2023, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 228-232, 237, 244 dhe 260 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata zëvendësimin e masave të sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të vendosura më parë ndaj kërkuesit, me masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, për shkak se kërkuesi nuk ka zbatuar vendimin e gjykatave, edhe për pasojë edhe një prej masave të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore.

67. Pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, duke e urdhëruar atë të mos largohet nga banesa, si dhe të mos komunikonte me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë në të njëjtën banesë me të. Sipas gjykatës, kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet e tij që vijnë si rezultat i zbatimit dhe respektimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke mos u paraqitur përpara Policisë Gjyqësore në katër raste. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore, për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur para oficerit të Policisë Gjyqësore dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet e gjykatës. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në rastin konkret nevojat e sigurimit vijnë në të njëjtin stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal të

caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, është para kushteve kur duhet të zëvendësohen ato masa me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, duke qenë se çështja ndodhet në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore, dhe se kërkuesi, për shkak të marrëdhënieve të krijuara për shkak të statusit të tij të mëparshëm si Kryeministër i vendit ose atij aktual, si deputet i Kuvendit, mund të ndikojë ose ndërhyjë në prishjen apo asgjësimin e provave, si edhe krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çka, sipas tyre, do të sillte një hetim të mangët. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë akoma rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, të shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, në atë “Arresti në shtëpi” (shih faqet 33 e në vijim të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë).

68. Gjatë gjykimit në GJKKO-në e Shkallës së Parë, kërkuesi në datën 26.12.2023 ka paraqitur pranë asaj gjykate kërkesën me objekt përjashtimin e gjyqtarës I.Gj. nga shqyrtimi i çështjes. Referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se sipas urdhrit nr. 381, datë 4.12.2023 të zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, është bërë përditësimi i ndarjes së gjyqtarëve sipas gatishmërisë për muajin dhjetor të vitit 2023. Po ashtu, rezulton se në datën 26.12.2023, zëvendëskryetarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka nxjerrë urdhrin nr. 418, datë 26.12.2023, sipas të cilit, duke qenë se dy gjyqtarë të asaj gjykate, përkatësisht gjyqtaret F.H. dhe E.D., kishin rënë dakord për zëvendësimin e njëra-tjetrës në gatishmërinë përkatëse, sipas shkresës nr. 3572, prot., datë 26.12.2023, bazuar në nenin 37, paragrafi “b”, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e



Shqipërisë, të ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*), ka urdhëruar përditësimin e ndarjes së gjyqtarëve sipas gatishmërisë. Ndërkohë, rezultoi se sipas vendimit nr. 57, datë 20.11.2023 “Për dhënien e lejes”, zëvendëskryetaria e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka miratuar kërkesën e gjyqtarës E.D. për dhënien e lejes vjetore për periudhën 26.12.2023–29.12.2023. Kështu, me urdhrin nr. 421, datë 26.12.2023, zëvendëskryetaria e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke qenë se vetë ajo si gjyqtare e gatshme nuk mund të merrte në shqyrtim kërkesën e kërkuarit për përjashtim, si edhe duke qenë se gjyqtarja pasardhëse e gatshme, E.D., ishte me leje vjetore, ka caktuar gjyqtaren R.P. si gjyqtare pasardhëse të gatshme për të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuarit për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. Gjyqtarja R.P., pasi administroi edhe mendimin e vet gjyqtarës I.Gj. për këtë kërkesë të kërkuarit, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ka vendosur deklarin e papranueshmërisë së saj. Gjithashtu, rezultoi se kërkuari ka paraqitur përsëri një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës I.Gj., e cila ka mbërritur në atë gjykatë në datën 3.1.2024 dhe nuk është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin nr. 23, datë 5.1.2023, për shkak se në datën 30.12.2023 ishte zhvilluar gjykimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuarit. Pra, kërkesa për përjashtim ishte paraqitur pas dhënies së vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit.

69. Mbi ankimin e kërkuarit, GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, ka arsyetuar se kërkesa e paraqitur nga kërkuari për përjashtimin e gjyqtarës I.Gj. nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 20, pika 1, i KPP-së, dhe për këtë arsye nuk përmbush kushtet për pranueshmërinë e saj. Sipas asaj gjykate, e gjithë procedura e ndjekur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për caktimin e gjyqtarës që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit për përjashtimin e gjyqtarës I.Gj. nga shqyrtimi i çështjes, është në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe kërkesat ligjore të dispozitave të neneve 18 dhe 19 të KPP-së. Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nuk ka pranuar të marrë në shqyrtim vendimmarrjen e shpallur më pas, *ex post*, nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë, sepse ai ishte i panevojshëm për vendimmarrjen. Sipas GJKKO-së së Apelit, i pabazuar është edhe shkaku tjetër i

ngritur në ankim nga kërkuari, sipas të cilit gjyqtarja I.Gj. nuk ka pranuar provat e paraqitura nga ai, pasi një vlerësim/çmuarje e tillë nga ajo gjyqtare është bërë në ushtrimin e funksionit gjyqësor të çështjes konkrete dhe në përputhje me diskrecionin e saj të lejuar nga ligji procedural penal (*shih faqet 11-13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar njësoj si GJKKO-ja e Shkallës së Parë se kërkuari ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij. Edhe sipas asaj gjykate, masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuar ose dënimit të mundshëm. Lidhur me pretendimet për shkelje të të drejtave të kërkuarit në kufizim të lirisë së tij të komunikimit dhe të së drejtës së shprehjes, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në respektim të kufijve diskrecionalë të caktuar nga pika 2 e nenit 237 të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka përzgjedhur një kufizim që është proporcional dhe i motivuar nga interesi publik që prevalon mbi interesin personal të individit (*shih faqet 15 e vijuese të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

70. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar drejt ligjin, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancitë e lidhura me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre (*shih paragrafin 44 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Lidhur me pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ai kolegji ka vlerësuar se janë të pambështetura në ligj e prova, pasi, në thelb, mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes nga gjyqtari, si edhe te drejtimi dhe menaxhimi i procesit gjyqësor (nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve) konform tagrave që i njej ligji. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtarës, sipas nenit 17, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së, janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të argumentuara si nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë që ka disponuar me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, po ashtu edhe nga GJKKO-ja e Apelit,



e cila ka shqyrtuar ankimin edhe ndaj këtij vendimi, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të të hetuarit. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se duke mbajtur në konsideratë këto fakte, edhe pretendimi i kërkuarit për shkelje nga GJKKO-ja e Apelit, që nuk ka pranuar si provë vendimmarrjen e GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkesën e dytë për përjashtim, nuk e cenon vendimmarrjen objekt rekursi, pasi kjo provë nuk ndikon dhe as passjell një vendimmarrje të ndryshme, e si e tillë me të drejtë është konsideruar një provë e panevojshme (*shih paragrafët 44, 48, 50 dhe 51 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

71. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se pjesa e pretendimeve që lidhen me vlerësimin e rrethanave të faktit del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, por, megjithatë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peius* ndaj kërkuarit, është arsyetuar dhe vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar si të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peius* ndaj kërkuarit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsytën e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se kërkuari ka kryer një veprë penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij Kolegji, gjykatat më të ulëta i kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit, duke evidentuar “shmangien e dëmtimit të hetimeve” dhe “ikjen e kërkuarit” (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese “Arresti në shtëpi” me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret.

Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë veç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 52-58 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

72. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit), në vlerësimin e tyre për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuarit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për arsytet të cilat kanë justifikuar zëvendësimin e saj, duke shfaqur një kujdes të veçantë në realizimin e procesit ndaj tij, si dhe duke arsyetuar për masën e duhur të sigurimit personal dhe nëse ishte e “mjaftueshme” për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar, që lidhej me mospërmbushjen nga ai të detyrimeve të vendosura më parë nga gjykatat. Po kështu, ato (gjykatat) kanë analizuar se vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se kërkuari mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, rrezikun që paraqet për t’u shmangur hetimit, si edhe prishjes ose të vërtetësisë së provave, nëse ndaj tij nuk do të vendosej ajo masë e sigurimit personal.

73. Në vlerësimin e gjykatës, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, arsyetimi i GJKKO-së së Apelit dhe i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me procedurat për përjashtimin e gjyqtarës, rezulton se i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të tij të ngritur në ankim/rekurs. Ndryshe nga sa pretendon kërkuari, Gjykata konstaton se edhe arsyetimi i atyre gjykatave për këtë pjesë të vendimit nuk rezulton të jetë kontradiktor, telegrafik ose arbitrar. Po ashtu, Gjykata evidenton se gjykatat kanë arsyetuar në vendimet e tyre edhe për pretendimin e ngritur nga kërkuari për kërkesën për përjashtim të paraqitur nga ai (*shih faqen 11 të vendimit të GJKKO-së Apelit dhe paragrafët 50 e në vijim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*), dhe se ky arsyetim i tyre, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimit të tij dhe nuk rezulton kontradiktor ose arbitrar, duke plotësuar kështu standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

74. Në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së zëvendësimit të masës së



sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas vendosjes së masës konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar dhe vlerësuar edhe rëndësinë e faktit se kërkuesi në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar detyrimet për zbatimin e njëres prej masave të sigurimit personal të vendosur më parë ndaj tij, që është bërë shkak për vendosjen e masës konkrete. Pra, në këtë kuptim, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat kanë arsyetuar edhe në lidhje me ekzistencën e kushtit procedural/ligjor për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke qenë se ai ishte në dijeni dhe ishte njoftuar për vendimet gjyqësore, të cilat kishin caktuar masën e sigurimit personal ndaj tij, moszbatimi i së cilës u bë shkak për zëvendësimin me masën tjetër “Arresti në shtëpi”. Për më tepër, Gjykata rithekson qëndrimin e saj në vendimin nr. 81/2024 lidhur me këtë pretendim, ku ajo (Gjykata) pajtohet me vlerësimin e gjykatave të zakonshme se kërkuesi ishte në dijeni dhe ishte njoftuar për vendimet gjyqësore, të cilat kishin caktuar masat e sigurimit personal ndaj tij. Prandaj, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit ka marrë përgjigje të arsyetuar me vendimin nr. 81/2024 të Gjykatës.

75. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjykatat kanë evidentuar edhe faktin se duke qenë se çështja ndodhet në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore, kërkuesi, për shkak të marrëdhënieve të krijuara prej statusit të tij të mëparshëm si Kryeministër i vendit ose atij aktual, si deputet i Kuvendit, mund të ndikojë ose ndërhyjë në prishjen apo asgjësimin e provave, si edhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave, çka, sipas tyre, do të sillte një hetim të mangët. Po ashtu, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në faktet dhe informacionet e administruara rregullisht gjatë procesit, kanë analizuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga kërkuesi, sikundër edhe për ekzistencën e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal.

76. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, Gjykata konstaton se gjykatat i kanë dhënë përgjigje për pretendimet kryesore të tij, përfshirë këtu edhe pretendimin për mosarsyetimin nga GJKKO-ja e Apelit për mosmarrjen e provës (*shih faqen 13 e vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Në këtë kuptim, rezulton se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese në lidhje me

objektin e çështjes së paraqitur për shqyrtim përpara tyre dhe thelbin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Referuar arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi, të pasqyruara më sipër në këtë vendim, ndryshe nga sa pretendon ai, Gjykata vëren se në tërësinë e tyre ato nuk rezultojnë arbitrare, telegrafike në lidhje me procedurat e përjashtimit të gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë, jologjike dhe të pamjaftueshme, si dhe kontradiktore ose të paqarta për sa u përket të dhënave të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ato nuk cenojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

77. Nisur nga sa më sipër, bazuar në standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata vëren se edhe Kolegji Penal i ka pasqyruar në vendimin objekt kundërshtimi shkaqet e ngritura në rekursin e ushtruar nga kërkuesi dhe pasi i ka marrë në shqyrtim ato, i ka gjetur të pabazuara, duke vlerësuar, në thelb, se nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka dhënë argumente të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e përfundimit të çështjes. Gjithashtu, bazuar në standardet kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se edhe ai i përmbush elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai ka respektuar elementet formale, duke pasqyruar të dhënat e palëve në procesin gjyqësor penal, shkaqet e parashtruara në ankim dhe rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ka mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë arbitrar, alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e tij. Për rrjedhojë vendimi i Kolegjit Penal nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të aksesit dhe standardit të arsyetimit të tij.

78. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore janë të pabazuara.

B.1.2.2.2 Për cenimin e parimit të paanshmërisë

79. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarja I.Gj., e cila ka dhënë ndaj tij masën shtrënguese të sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, është shkarkuar nga detyra e gjyqtarës në vitin 1996, nga ish-KLD-ja,



kohë kur ky institucion kryesohej nga kërkuesi, në cilësinë e Presidentit të Republikës. Sipas kërkuesit, ai ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e kësaj gjyqtareje, e cila është shqyrtuar nga një gjyqtare tjetër e GJKKO-së së Shkallës së Parë, e caktuar po nga gjyqtarja I.Gj., në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, dhe në përfundim, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ajo kërkesë nuk është pranuar. Po sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim vendimin e ndërmjetëm nr. 23, datë 5.1.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë për papranueshmërinë e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë për shkaqe anshmërie.

80. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur asnjë argument për të prapësuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në drejtëm të testit subjektiv. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e mbrojtjes efektive, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ai është i pabazuar, pasi gjatë gjithë kohës që ka qenë nën masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, kërkuesi ka komunikuar vazhdimisht me mbrojtësit e tij. Sipas Prokurorisë së Posaçme, kjo konfirmohet edhe nga ankimet e bëra nga ai ndaj vendimit të caktimit të masës së sigurimit në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe ankimin në këtë Gjykatë.

81. Neni 28 pika 2, i Kushtetutës parashikon se paraburgimi ose lirimi i individit vendoset nga gjyqtari. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata çmon se ai duhet të përmbushë garancitë kushtetuese të gjykatës së pavarur dhe të paanshme të përcaktuara nga neni 42 i Kushtetutës. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

82. Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes

ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

83. Bazuar në sa më sipër, Gjykata do të shqyrtojë në vijim nëse shqyrtimi nga gjyqtarja I.Gj. i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për zëvendësimin e masave të sigurimit personal të caktuara ndaj kërkuesit ka vënë në dyshim respektimin e parimit të paanshmërisë në aspekt të testit subjektiv në atë gjykim dhe nëse gjykatat më të larta i kanë garantuar atij të drejtën e mbrojtjes efektive, duke shqyrtuar pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë.

84. Gjykata, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se gjyqtarja I.M. (I.Gj.) ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin nr. 7, datë 8.2.1996 të ish-KLD-së është shkarkuar për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës. Në atë kohë rezulton që kryetar i ish-KLD-së të ketë qenë kërkuesi, për shkak të funksionit të tij si President i Republikës, funksion ky *ex officio* sipas legjislacionit në fuqi. Rezulton, gjithashtu, që kjo gjyqtare të jetë emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mallakastër me vendimin nr. 8, datë 23.8.1996 të po ish-KLD, e cila edhe në atë kohë drejtohej po nga kërkuesi.

85. Ndërkohë, GJKKO-ja e Apelit, duke iu referuar edhe arsyetimit të vendimit nr. 521, datë 27.12.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarës I.Gj., ka vlerësuar se ajo (kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për përjashtimin e gjyqtarës I.Gj.) nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara



nga neni 20, pika 1, i KPP-së, dhe për këtë arsye nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë së saj (*shih fagen 11 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Edhe sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pretendimet e kërkuarit për njëanshmërinë e gjyqtarës I.Gj., referuar nenit 17, pika 1, shkronja “ë”, të KPP-së, janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të arsyetuar si nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 521, datë 27.12.2023, ashtu edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka shqyrtuar ankimin ndaj këtij vendimi, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuarit (*shih paragrafin 50 i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

86. Gjykata, referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese në fuqi në kohën kur është dhënë vendimi nr. 7, datë 8.2.1996 i ish-KLD-së, vëren se gjyqtari mund të shkarkohej nga ai organ [...] për pamjaftueshmëri profesionale (*neni 147, pika 6*). Ish-KLD-ja përbëhej nga Presidenti i Republikës, kryetari Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe nëntë gjyqtarë të të gjitha niveleve [...] (*neni 147, pika 1*). Bazuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave, Gjykata vëren se shkarkimi i gjyqtarëve bëhej nga një organ kolegjal (ish-KLD-ja), vendimet e të cilit, si rregull, merren sipas formulës së parashikuar për shumicën e votave të anëtarëve të tij, ndërkohë që nuk rezulton dhe nuk është provuar nga kërkuari që ai, në cilësinë e kryetarit të këtij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtëm. Pavarësisht se kërkuari ka ushtruar në atë kohë detyrën e kryetarit të ish-KLD-së, nuk rezulton që ai të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës I.Gj. ose të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj.

87. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Gjykata evidenton se qenia e kërkuarit në cilësinë e kryetarit të një organi kolegjal, i cili ka disponuar për lirimin nga detyra të gjyqtarës I.Gj., nuk është shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e asaj gjyqtareje në këtë rast, për sa kohë nuk rezulton dhe nuk është provuar që ai (kërkuari), në cilësinë e kryetarit të atij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtëm ose të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës apo të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj. Për më tepër, siç edhe rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës, gjyqtarja I.Gj. edhe pse është shkarkuar nga detyra e gjyqtarës në vitin 1996 nga ish-KLD-ja, kur ky institucion kryesohej nga kërkuari, në cilësinë

e Presidentit të Republikës, është rikthyer në detyrë, në të njëjtin vit, po nga ish-KLD-ja e drejtuar nga kërkuari, çka tregon se pretendimet që lidhen me shkarkimin e asaj gjyqtareje neutralizohen nga riemërimi më pas i saj. Në vlerësimin e Gjykatës, ky fakt nuk është i mjaftueshëm për të treguar paragjykimin e gjyqtarës I.Gj. në drejtëm të vlerësimit të kërkesës së prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të vendosur ndaj kërkuarit.

88. Gjithashtu, Gjykata konstaton se nga gjyqtarja I.Gj. nuk është kryer asnjë veprim ose sjellje konkrete që të vërë në dyshim paanshmërinë e saj në drejtëm të testit subjektiv. Veprimet e gjyqtarës I.Gj., në cilësinë e zëvendëskryetares së GJKKO-së së Shkallës së Parë, për caktimin e një gjyqtareje tjetër për shqyrtimin e kërkesës së kërkuarit për përjashtimin e saj nga shqyrtimi i çështjes, janë kryer në ushtrimin nga ajo të detyrave administrative dhe menaxhuese në drejtimin e asaj gjykate dhe lidhen vetëm me funksionin e saj si zëvendëskryetare, ndaj për këtë arsye nuk ndikojnë në paanshmërinë e saj. Në vlerësimin e Gjykatës, nga gjyqtarja I.Gj. është ndjekur procedura e zakonshme në përditësimin e listës që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, që në rastin konkret lidhet me zëvendësimin e gjyqtarëve të gatshëm dhe këto veprime nuk ngrenë dyshime për paanshmërinë e saj, për shkak se nga ajo është vepruar në përputhje me parashikimet e KPP-së dhe ligjit nr. 98/2016, , si edhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

89. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se gjyqtarja I.Gj. ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm për paanshmërinë e saj në gjykimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete nuk ka arsye të përligjura që rrezikojnë dhe vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarës I.Gj. dhe ky dyshim nuk është objektivisht i justifikueshëm. Gjithashtu, Gjykata evidenton se nga GJKKO-ja e Apelit janë dhënë arsyet dhe është arsyetuar për mosmarrjen në shqyrtim të provës së paraqitur nga kërkuari, për shkak se ajo ishte e panevojshme për gjykimin konkret (*shih fagen 13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit në këtë drejtëm nuk është i bazuar. Për më tepër, Gjykata evidenton se kërkesa e kërkuarit për përjashtimin e gjyqtarës I.Gj. është marrë në shqyrtim nga një gjyqtare tjetër e së



njëjtës gjykatë dhe i është dhënë përgjigje e arsyetuar, si edhe, po ashtu, ky pretendim është parashtruar edhe në ankimet në gjykatat më të larta, të cilat, pasi e kanë marrë në shqyrtim, i kanë dhënë përgjigje kërkuarit se është i pabazuar (*shih faqet 11-13 të GJKKO-së së Apelit dhe paragrafët 44-51 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

90. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të paanshmërisë nuk përbëjnë shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarës I.Gj. në drejtim të testit subjektiv. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ato nuk janë të bazuara.

B.2. Për aspektin substancial

B.2.1 Për cenimin e lirisë personale dhe së drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare

91. Kërkuarisi ka pretenduar se me zëvendësimin e masës së sigurimit personal, atij i janë kufizuar edhe të drejta dhe liri të tjera të parashikuara nga Kushtetuta, siç janë e drejta për jetë familjare, liria e shprehjes, liria e organizimit, e drejta për të ushtruar mandatin parlamentar dhe se kufizimi i tyre është bërë pa ligj. Sipas tij, kufizimi nuk është proporcional dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar pse nevojat e sigurimit nuk garantoreshin me masa më të lehta sigurimi, siç janë “Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar” dhe “Garancia pasurore”, si edhe se gjykatat nuk mund të përcaktojnë kufizime tej atyre të përcaktuara nga ligji.

92. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat kanë argumentuar nevojshmërinë e masës së sigurimit personal, duke bërë një analizë tërësore të rezultateve të hetimit dhe në këtë mënyrë kanë konkluduar me vendimmarrje në përputhje me dispozitat përkatëse. Sipas Prokurorisë së Posaçme, edhe pse me masë sigurimi “Arresti në shtëpi”, kërkuarisi e ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të shprehjes, lirinë politike dhe atë të organizimit dhe se kushtet dhe kriteret në caktimin e masave të sigurimit janë analizuar qartësisht nga gjykatat.

93. Bazuar në sa më sipër, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara, që kanë caktuar ndaj kërkuarit një masë sigurimi më të rëndë, atë “Arresti në shtëpi”, duke kufizuar lirinë e tij personale, i kanë kufizuar edhe të drejtën për të ushtruar veprimtarinë parlamentare, në kuptim të së drejtës për t’u zgjedhur, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës. Nëse përgjigja e kësaj pyetjeje është

pozitive, Gjykata do të vlerësojë më tej nëse kjo ndërhyrje është e ligjshme dhe në respektim të kushteve e kriterëve të përcaktuara në nenet 228, 229 e vijues të KPP-së, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Për këtë qëllim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe parimin e subsidiaritetit, do të verifikojë në nëse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar dhe interpretuar në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sigurimit të caktuar ndaj tij, si dhe nëse kanë mbajtur në konsideratë se ajo përmbush qëllimin për të cilin është caktuar.

94. Në lidhje me të drejtën për t’u zgjedhur, Gjykata eidenton se ajo garantohej nga neni 45 i Kushtetutës dhe, sipas kësaj dispozite, çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t’u zgjedhur shtrihet jo vetëm mbi të drejtën për të kandiduar, por edhe mbi të drejtën për të ushtruar funksionin publik të besuar nga zgjedhësit (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

95. Ndërkohë, Gjykata ripohon se çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave e lirive të tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një “nevoje sociale urgjente” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë që ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të brendshëm; ashpërsia e kufizimit (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

96. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti dhe se ai do të konsiderohet arbitrar, midis të tjerash, në rastet kur nuk është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur. Mosbërja e një hetimi të



vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm do të përbënte cenim të lirisë personale. Në këtë drejtim, Gjykata ka identifikuar disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë personale, siç janë: a) rreziku që i dyshuari/akuzuari në qoftë se do të lihej i lirë do të largohej dhe nuk do të paraqitej përpara gjykatës; b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë do të ndërmernte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë; c) rreziku që i dyshuari/akuzuari nëse do të lihej i lirë do të kryente vepra penale të tjera (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

97. Në lidhje me kriteret që duhet të plotësohen për të justifikuar nga pikëpamja kushtetuese kufizimin e lirisë dhe të të drejtave kushtetuese, Gjykata vëren se lidhur me interesin publik, rregullat procedurale penale që lejojnë vendosjen e masave të sigurimit personal i shërbejnë mbarrëvajtjes së procedimit penal të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj ai është i prezumuar (*shih vendimin nr. 83, datë 5.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e tij kushtetuese është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik.

98. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së. Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis masave të sigurimit personal dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata do të analizojë nevojën për kufizimin e lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë parlamentare në raport me nevojat konkrete për mbarrëvajtjen e procedimit penal. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata rithekson se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

99. Në gjykimin kushtetues lidhur me nevojën e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të kërkuesit,

Gjykata analizon fillimisht nëse masa konkrete e sigurimit e vendosur për të (kërkuesin) është e nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarrëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ajo është vendosur. Më tej, Gjykata vlerëson nëse masa e vendosur është e përshtatshme për të realizuar këtë qëllim. Së fundi, Gjykata vlerëson nëse qëllimi i ligjshëm i mbarrëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra.

100. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 520/2023, ka arsyetuar se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimet që vijnë si rezultat i zbatimit të vendimeve nr. 112/2023 dhe nr. 117/2023 të po asaj gjykate, duke mos u paraqitur asnjëherë përpara Policisë Gjyqësore. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, i KPP-së), se ai është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se nuk ka zbatuar në mënyrë të përsëritur detyrimet që i ngarkohen nga ligji procedural penal, në zbatim të vendimeve gjyqësore për caktimin e masave shtrënguese personale ndaj tij, duke mos u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore/hetuesit dhe duke mos paraqitur asnjë arsye të qenësishme që të justifikojë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në rastin konkret, nevojat e sigurimit vijnë në të njëjtën stad, por duke qenë se nga ana e kërkuesit, në mënyrë të përsëritur, janë shkelur detyrimet për zbatimin e masave të sigurimit personal të caktuara nga gjykata, në raport me parashikimet e nenit 228, pika 3, të KPP-së, është para kushteve kur duhet të zëvendësohen masat e sigurimit të dhëna ndaj tij, me një masë tjetër më të rëndë. Për këtë arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që të justifikojnë masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, për shkak të funksionit që ka ushtruar më parë shtetasi nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, por edhe funksionit të tij aktual si deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në lidhje me rrezikun e ikjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistojnë akoma rrethanat që kërkuesi mund të largohet. Për këto arsye, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke marrë në konsideratë mosrespektimin e urdhërimeve të gjykatës nga kërkuesi, të përcaktuara



në vendimin e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj tij, e shoqëruar edhe me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të normuara në nenin 228 të KPP-së, ka vlerësuar se justifikohet zëvendësimi i masave të sigurimit personal nga “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” në masën “Arresti në shtëpi” (*shih faqet 35-39 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

101. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit në arsyetimin e saj ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka interpretuar dhe zbatuar ligjin procedural penal korrektësisht, se ky zëvendësim i masës së sigurimit personal vjen në zbatim të kombinuar të neneve 231 me 260, pika 3, të KPP-së, që kërkojnë verifikimin e shkeljes së detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit në fuqi të lidhura me rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes së kryer. Edhe sipas GJKKO-së së Apelit, kërkuesi ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij, urdhërime që nisur nga natyra e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në ditë dhe orë të caktuara, e parespektuar asnjëherë nga ai, që prej lindjes së detyrimit përkatës, dëshmon për rëndësinë e shkeljes, ndërsa në vlerësim të motiveve dhe rrethanave të shkeljes së kryer, rezulton se ato nuk janë objektive dhe në lehtësim të pozitës së shkelësit. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar drejt dhe në lidhje elementet provuese që përligjin caktimin e një mase më pak shtrënguese personale dhe aktualisht zëvendësim *in peus* të saj, pasi ka vlerësuar qëndrueshmërinë e kushteve të përgjithshme, nevojat e sigurimit të të hetuarit dhe mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë ose të shuarjes së veprës penale për të cilën dyshohet. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” është në përputhje me kërkesat e nenit 229, pika 2, të KPP-së, që i referohet kriterit të proporcionalitetit ose përzgjedhjes së masës së sigurimit personal në raport të drejtë me rëndësinë së faktit dhe sanksionit vetëm me burgim që parashikohet për veprën penale të atribuuar ose dënimit të mundshëm (*shih faqet 16 e vijues të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

102. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ekzistenca e kushteve të përcaktuara në nenet 231 dhe 260 të KPP-së, për zëvendësimin e masës së sigurimit *in peus* ndaj kërkuesit, është arsyetuar dhe

vlerësuar drejt nga të dyja gjykatat, të cilat kanë verifikuar shkeljen e detyrimeve që burojnë nga masa e sigurimit personal në fuqi në raport me rëndësinë dhe rrethanat e shkeljes së kryer (pranuar si të tillë nga të dyja gjykatat). Në vlerësimin e Kolegjit Penal, masa e sigurimit është zëvendësuar *in peus* ndaj kërkuesit në zbatim të neneve 231 dhe 260, pika 3, të KPP-së, për shkak se ai ka shkelur detyrimet që përmban masa e sigurimit personal në fuqi ndaj tij dhe jo për shkak se nevojat e sigurimit janë rënduar. Kolegji Penal, në vlerësimin e tij, ka arsyetuar se gjykatat kanë vlerësuar me të drejtë vijimësinë e nevojave të sigurimit të evidentuara në gjenezë të caktimit të masës së sigurimit personal, sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së dhe arsytën e zëvendësimit të llojit të masës së sigurimit personal, për shkakun e evidentuar qartësisht në arsyetimin e vendimmarrjes së tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se të dyja gjykatat kanë analizuar dhe evidentuar vijimësinë e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer një vepër penale, kusht ky *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të një mase sigurimi personale. Sipas atij kolegji, gjykatat më të ulëta kanë vlerësuar aktuale nevojat e sigurimit duke evidentuar “shmangien e dëmtimit të hetimeve” dhe “ikjen e kërkuesit” (dy rreziqe të evidentuara që në gjenezë), si dhe kanë arsyetuar përshtatshmërinë e llojit të masës shtrënguese “Arresti në shtëpi” me nevojat e sigurimit sipas rrethanave të rastit konkret. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe në lidhje me ndalimet e urdhëruara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për të mos komunikuar me persona të tjerë përveç atyre që bashkëjetojnë me të në banesë, të cilat, sipas atij kolegji, kanë marrë përgjigje të argumentuar nga GJKKO-ja e Apelit dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 54 e vijues të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

103. Lidhur me nevojën e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të kërkuesit, nëse masa konkrete e sigurimit e vendosur mbi të (kërkuesin) është e nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ajo është vendosur dhe nëse është e përshtatshme për të realizuar këtë qëllim, si edhe nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihet me vendosjen e masave më pak të ashpra, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas



parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

104. Kështu, sipas njërit qëndrim, masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, e caktuar ndaj kërkuesit, nuk ka qenë proporcionale ndaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës për këtë shkak²⁵.

105. Në linjë me këtë qëndrim, dy gjyqtarë²⁶ mbajtën qasjen se në caktimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuesit gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë ekzistencën e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenet 228 dhe 229 të KPP-së për caktimin e masave të sigurimit personal në raport me parashikimet e nenit 260, pika 3, të KPP-së. Sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së, masat e sigurimit personal vendosen kur: *i)* ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; *ii)* i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; *iii)* për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Kurse sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret dhe çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Nga ana tjetër, sipas nenit 260, pika 3, të KPP-së, kur nevojat e sigurimit rëndohen ose personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese. Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite (neni 260), rezulton se në rastin e masave shtrënguese, që është edhe rasti konkret: *së pari*, zëvendësimi i një mase personale sigurimi mund të vendoset si kur bëhet fjalë për rëndimin e nevojave të sigurimit, çka nënkupton se masa e mëparshme nuk u përgjigjet më atyre, ashtu edhe në rastin e mosekzekutimit të detyrimeve që lindin nga masa e sigurimit; *së dyti*, ajo nuk vendos asnjë detyrim për

gjykatën për zëvendësimin ose caktimin e një mase tjetër sigurimi; *së treti*, edhe në rast se gjykata pranon kërkesën e prokurorit ajo vlerëson rast pas rasti nëse nevojat e sigurimit kërkojnë zëvendësimin me një masë tjetër më të rëndë ose caktimin e një mase shtesë. Për rrjedhojë, jo vetëm në kuptim të kësaj dispozite, por edhe në kuptim të dispozitave të tjera procedurale penale që lejojnë caktimin e një mase sigurimi, veçanërisht në rastin kur gjykata investohet për zëvendësimin e një mase për shkak se nuk janë zbatuar detyrimet e saj, nuk kërkohet dhe nuk imponohet caktimi i një mase kufizuese si ajo e arrestit, e cila duhet të mbetet si *ultima ratio*, por nënkuptohet realizimi i një procesi vlerësimi dhe analize nga gjykatat e zakonshme në drejtim të nevojës për zëvendësimin e masës së mëparshme me një më të rëndë, ashtu edhe në drejtim të përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së re me nevojat e sigurimit në momentin e caktimit të saj.

106. Thënë sa më sipër, në rastin konkret gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë se përse masa e arrestit në shtëpi ishte në rastin konkret e vetmja masë që mund të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal dhe mosvënien në rrezik të tij, pavarësisht se ajo është *ultima ratio*. Në kohën e caktimit të masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, gjykatat kanë konkluduar se ajo ishte masa e përshtatshme për plotësimin e nevojave të sigurimit në procedimin penal ndaj kërkuesit, çka do të thotë se ato kanë vlerësuar se nuk ekzistonte në atë moment asnjë rrezik për helmimin e provave ose shmangien e drejtësisë nga kërkuesi, dhe për këtë shkak nuk u caktua masa e arrestit. Zëvendësimi i kësaj mase sigurimi është kërkuar nga prokurori jo për shkak të rëndimit të nevojave të sigurimit, pra për shkak të ndryshimit të tyre krahasimisht me momentin e caktimit të masës së parë, por për shkak se kërkuesi nuk ka ekzekutuar detyrimin për t’u paraqitur përpara oficerit të Policisë Gjyqësore në ditën dhe orën e përcaktuar për të nga gjykata, çka do të thotë se nuk kanë ndryshuar ata faktorë përcaktues, të tillë që vënë në rrezik vetë procedimin penal (helmimi i provave ose rreziku i ikjes). Pavarësisht kësaj, gjykatat, në kuptim të përmbajtjes së nenit 260, pika 3, të KPP-së dhe nenit 231 të po këtij kodi, që përcaktojnë llojet e masave shtrënguese, nuk kanë

²⁵ Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Holta Zaçaj, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini.
Faqe | 5726

²⁶ Ishin të këtij vlerësimi gjyqtarët Holta Zaçaj dhe Genti Ibrahimi.



arsyetuar në drejtim të nevojës së zëvendësimit të masës me një më të rëndë dhe as në drejtim të përshtatshmërisë së masës së arrestit në shtëpi, pra se përse ishte masa e vetme në rastin konkret dhe se përse nuk ishte i përshtatshëm caktimi i një mase sigurimi shtrënguese tjetër ose ndaluese shtesë.

107. Referuar përmbajtjes së vendimeve të gjykatave të zakonshme rezulton se ato kanë analizuar vetëm ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm” se kërkuesi është autor i veprës penale për të cilën dyshohet dhe, sipas tyre, moszbatimi në mënyrë të përsëritur i detyrimeve që i ngarkohen nga ligji procedural penal dëshmon rëndësinë e shkeljes. Po kështu, nga njëra anë, gjykatat kanë pranuar se nevojat e sigurimit vijnë në të njëjtin stad dhe mosrespektimi i detyrimeve që përmban masa e sigurimit personal në fuqi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në ditë dhe orë të caktuara, që prej lindjes së këtij detyrimi, dëshmon për rëndësinë e shkeljes, ndërsa në vlerësim të motiveve dhe rrethanave të shkeljes së kryer, rezulton se ato nuk janë objektive dhe në lehtësim të pozitës së shkelësit. Nga ana tjetër, gjykatat janë shprehur se nevojat aktuale të sigurimit, që janë “shmangia e dëmtimit të hetimeve” dhe “ikja e kërkuesit”, e bëjnë të përshtatshme me nevojat e sigurimit llojin e masës shtrënguese “Arresti në shtëpi” sipas rrethanave të rastit konkret. Këto qëndrime të gjykatave janë kontradiktore, për sa kohë që qartësisht masa e sigurimit në rëndim të pozitës së kërkuesit lidhet vetëm me mosekzekutimin e detyrimeve që kanë lindur nga masa e mëparshme, ndërkohë që qartësisht nevojat e sigurimit nuk kanë ndryshuar që prej momentit kur është caktuar ajo masë, pra nuk kanë ndryshuar duke u rënduar dhe nuk arsyetohet se cilat janë ato rrethana të reja që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave të këtij procedimi (ose helmimin e provave) apo shmangien e drejtësisë. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë në drejtim të proporcionalitetit elementet që duhet të analizohen prej tyre gjatë caktimit të një mase sigurimi, pra se përveçse e nevojshme, masa e arrestit në shtëpi ishte edhe përshtatshme dhe proporcionalisht e ashpër, pra se asnjë masë tjetër shtrënguese nuk do të ishte në gjendje të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal dhe mosvënien në rrezik të tij.

108. Sipas qasjes së gjyqtares tjetër²⁷, që ka mbajtur qëndrimin se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” nuk ka qenë proporcionale, në analizën e kushteve dhe kriterëve për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më rënduese siç është “Arresti në shtëpi”, duhej të analizohej nëse zëvendësimi ishte i nevojshëm, proporcional, i justifikuar, i përshtatshëm dhe nëse masa rrezikonte të ishte më e ashpër kundrejt qëllimit. Ndonëse kërkuesi ka dëshmuar mospërmbushje të masës së sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, përsëri në analizë të nenit 231 të KPP-së vërehet se qëllimi i normës është të parashikojë zëvendësimin me një masë sigurimi më të rëndë, si një *mundësi* dhe jo si një detyrim. Prandaj, Prokuroria e Posaçme mund të kishte treguar një kujdes të shtuar për të nxitur kërkuesin për përmbushjen e detyrimeve ligjore, qoftë edhe duke parë ndonjë alternativë zgjidhjeje për të aplikuar kundrejt një afati të shkurtër me efekt nxitës kombinimin e një mase shtrënguese me një masë ndaluese. Ndonëse në pamje të parë dhe teorikisht rezulton se zëvendësimi i masës është kryer në mbështetje të nenit 228 të KPP-së, përsëri gjykatat e posaçme për të konkluduar për përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin duhet të analizonin *edhe* ndikimin e rrethanave të rastit konkret për mirëfunksionimin e demokracisë në vend. Në këtë këndvështrim, në analizë të: (i) *statusit/cilësive individuale të kërkuesit* të lidhura me rolin e tij në shoqëri, me moshën dhe personalitetin, vërehet lehtësisht se kërkuesi gëzon një status të dyfishtë juridik: si individ dhe si lider i partisë më të madhe opozitare. Ndërkohë, në analizë të: (ii) *kontekstit të situatës aktuale politike e sociale* rezulton se koha kur është caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” përkon me periudhën e përgatitjes për zgjedhje të përgjithshme parlamentare, gjatë së cilës normalisht forcat politike planifikojnë një plan masash për përgatitjen e fushatës elektorale, takime me zgjedhësit, angazhime mediatike etj. Kalimi i drejtpërdrejtë të një masë rënduese që sjell tashmë heqjen e lirisë ndaj kreut të opozitës passjell vënien në dyshim jo vetëm të garantimit të konkurrimit politik dhe procesit të zgjedhjeve, por edhe vetë mirëfunksionimin e pluralizmit politik dhe demokracisë në vend. Ndonëse në vendimin nr. 81/2024 është mbajtur qëndrimi që masa e sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” është

²⁷ Ishte e këtij vlerësimi gjyqtarja Marjana Semini.



proporcionale në drejtim të përshtatshmërisë, sepse nga intensiteti i saj nuk e pengonte kërkuesin të përmbushte detyrimet e tij qytetare dhe politike, në rastin konkret përshkallëzimi në drejtim të masës “Arresti në shtëpi” (*e cila bie nën spektrin e masave që kufizojnë lirinë personale*) ka rënduar pozitën e kërkuesit, duke e “penalizuar” atë në një mënyrë më të ashpër se sa do të ishte e justifikuar, e arsyeshme, e përshtatshme dhe e nevojshme. Në konkluzion, sipas qëndrimit të kësaj gjyqtareje, zëvendësimi i masës me “Arresti në shtëpi” si joproporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj dhe, për rrjedhojë, pretendimin e kërkuesit të bazuar.

109. Ndërkohë, sipas qëndrimit tjetër, neni 27, pika 1, i Kushtetutës kërkon, së pari, që heqja e lirisë të jetë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, që do të thotë se çdo privim i lirisë, nga njëra anë, duhet të bazohet në një normë ligjore substanciale dhe sipas rregullave ligjore procedurale, ndërsa, nga ana tjetër, duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 27, pra të mbrojë individin nga arbitrariteti. Me pak fjalë, në parim, heqja e lirisë është e ligjshme nëse kryhet me vendim gjykatë. Në vijim, neni 27, pika 2, i Kushtetutës përmban një listë shteruese të rasteve të lejueshme të heqjes së lirisë, që janë në të njëjtën linjë me ato të nenit 5, paragrafi 1, të KEDNJ-së. Për këtë të fundit, GJEDNJ-ja ka pohuar se zbatueshmëria e njërit rast nuk e përjashton domosdoshmërisht një rast tjetër; paraburgimi, në varësi të rrethanave, mund të justifikohet sipas më shumë se një shkakut të parashikuar në nënparagrafët e nenit 5 (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.7.2010, §35; Enhorn kundër Suedisë, datë 25.1.2005, § 34; Eriksen kundër Norvegjisë, 27.5.1997, § 76*). Në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete, duhet evidentuar se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” ndaj kërkuesit është caktuar me vendim gjyqësor jo vetëm për shkak të dyshimit të arsyeshëm të kryerjes së veprës penale (neni 27, pika 2, shkronja “c”), por edhe për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës (neni 27, pika 2, shkronja “b”).

110. Neni 27, pika 2, shkronja “b”, i Kushtetutës lejon kufizimin e lirisë kur një urdhër i ligjshëm i gjykatës nuk zbatohet, që do të thotë se gjykata mund të vendosë heqjen e lirisë së individit për të realizuar qëllimin e urdhrit të ligjshëm të gjykatës, që nuk është zbatuar dhe jo për të ndëshkuar individin. Për këtë arsye, është me rëndësi vendimtare gjetja e ekuilibrit të duhur midis rëndësisë që ka në një shtet të së drejtës zbatimi i urdhrave të ligjshëm të gjykatës

dhe lirisë personale. GJEDNJ-ja, në gjykime të ngjashme, ka pohuar se çështja e proporcionalitetit merr rëndësi të veçantë në vlerësimin e përgjithshëm të situatës. Qëllimi i vendimit, mënyra e zbatimit të vendimit dhe kohëzgjatja e paraburgimit janë çështje që duhet të merren në konsideratë (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.7.2010, § 40*). Po ashtu, natyra e detyrimit ligjor që rrjedh nga vendimi gjyqësor, duke përfshirë objektin dhe qëllimin e tij thelbësor, personin që ndalohet, rrethanat e veçanta që çuan në paraburgim dhe kohëzgjatjen e ndalimit janë të rëndësishme (*shih Vasileva kundër Danimarkës, nr. 52792/99, §§ 36-38, 25 shtator 2003*).

111. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, fillimisht vlen të theksohet se objekti i këtij gjykimi kushtetues lidhet *vetëm* me procesin gjyqësor për zëvendësimin e dy masave të sigurimit me atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, pra me caktimin dhe jo me kohëzgjatjen e masës së arrestit në shtëpi. Lidhur me këtë të fundit, kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues dhe as nuk ka treguar që i ka shteruar paraprakisht mjetet juridike në dispozicion, pra duke i ngritur ato paraprakisht të gjykatat e zakonshme. Kërkuesi ka zgjedhur që pretendimet e tij për masat e sigurimit të caktuara në të njëjtin procedim penal t'i paraqesë në Gjykatë përmes ankimeve kushtetuese të veçanta për secilin proces gjyqësor, siç ishte rasti për caktimin e dy masave të sigurimit dhe për zëvendësimin e tyre me atë të arrestit në shtëpi, ndërsa mbetet e hapur mundësia për procesin e tretë gjyqësor për zëvendësimin e masës së arrestit në shtëpi, që është në shqyrtim e sipër në gjykatat e zakonshme.

112. Në vijim, duke analizuar në tërësi të dhënat e çështjes konkrete në raport me standardet kushtetuese, nxirret përfundimi se gjykatat e zakonshme fillimisht kanë caktuar ndaj kërkuesit masat e sigurimit “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, duke mbajtur në konsideratë jo vetëm rëndësinë e lirisë personale, por edhe mundësinë e ushtrimit të funksionit të deputetit në kuadër të së drejtës për t'u zgjedhur. Në këtë kuptim, me vendimin gjyqësor për caktimin e këtyre dy masave, gjykatat kanë nxjerrë urdhrin e ligjshëm që kërkuesi të paraqitej një herë në dy javë në Policinë Gjyqësore, por ky urdhër i ligjshëm u refuzua të zbatohet nga kërkuesi të paktën 4 herë radhazi, në datat 6.11.2023, 20.11.2023, 4.12.2023 dhe 18.12.2024. Duke mos zbatuar këtë urdhër të



gjykatës, kërkuesi vuri në dyshim përmbushjen e qëllimit të ligjshëm, për të cilin ishin caktuar masat e sigurimit – konkretisht atë të mbarëvajtjes së procedimit penal ndaj tij, duke theksuar se mbarëvajtja e procedimit penal i shërben ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Po ashtu, refuzimi publik për të zbatuar vendimin e gjykatës nga kërkuesi, në cilësitë e tij personale të deputetit dhe të drejtuesit të një force të rëndësishme politike, vë në dyshim parimin e shtetit të së drejtës, i cili bazohet në ndarjen e pushteteve dhe kërkon respektimin e vendimeve gjyqësore.

113. Për arsyet e mësipërme, gjykatat e zakonshme kanë zbatuar në mënyrë të saktë dhe me mirëbesim zëvendësimin e dy masave të sigurimit në atë të arrestit në shtëpi ndaj kërkuesit, duke vendosur ekuilibrin e duhur midis qëllimit për zbatimin e urdhrave të gjykatës, si dhe rëndësisë së lirisë personale dhe së drejtës për t'u zgjedhur. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale vazhdon të ekzistonte dhe në shtesë të tij kërkuesi nuk kishte përmbushur urdhrin e ligjshëm të gjykatës 4 herë radhazi, duke lënë pa efekte masën e sigurimit të detyrimit për paraqitje në Policinë Gjyqësore. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se legjislacioni procedural penal (neni 232 i KPP-së) si masë përshkallëzuese përpara asaj të arrestit në shtëpi parashikon dhe atë të garancisë pasurore, por ajo mund të caktohet *vetëm* nëse nga personi nën hetim ose një person tjetër për të ofrohet garanci pasurore (neni 236, pika 1, i KPP-së), që nuk ka ndodhur në rastin konkret. Si përfundim, nisur nga rrethanat konkrete të çështjes në fjalë, kufizimi i lirisë së kërkuesit përmes masës së sigurimit të arrestit në shtëpi ishte proporcional²⁸.

114. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit në drejtim të procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit dhe parimit të paanshmërisë, si aspekte procedurale të të drejtave substanciale, janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit. Kurse për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe të drejtës për të ushtruar veprimtarinë parlamentare, në aspektin e proporcionalitetit të

masës, në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ai konsiderohet i rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.1.2025.

Shpallur, më 6.3.2025.

Kryetare pjesërisht kundër: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja

Anëtarë pjesërisht kundër: Genti Ibrahim, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 33, datë 10.2.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 kV PËR VITIN 2025

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.

²⁸ Votuan për rrëzimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Ilir Toska.



201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 722/1 prot., datë 10.2.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025 dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime për vitin 2025”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 370 prot., datë 27.1.2025, protokolluar në ERE me nr. 722 prot., datë 29.1.2025, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025, për klientët FMF të lidhur në nivelet e tensionit 6/10/20 kV (klientë të rëndësishëm të veçantë), si dhe për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV.

- Në përputhje me VKM-në nr. 456/2022, KESH sh.a. do të vazhdojë të mbulojë sasinë e kërkuar të energjisë elektrike për klientët e FSHU sh.a., të cilët shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit edhe për vitin 2025. FSHU sh.a., në aplikimin e saj të datës 27.1.2025 (shkresa nr. 370 prot.), protokolluar në ERE me nr. 722 prot. më 29.1.2025, ka bashkëngjitur, gjithashtu, korrespondencën e KESH sh.a. (nr. 7349/1 prot., datë 31.12.2024), ku, siç parashikohet në VKM-në 456/2022, evidentohet se KESH sh.a., pas analizave për Programin Ekonomik-Financiar të vitit 2025 dhe parashikimeve për periudhën 2026–2029, ka paraqitur projeksionet e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës. Ky i fundit miratoi Programin Ekonomik-Financiar të KESH sh.a. për vitin 2025 dhe parashikimin për vitet 2026–2029 me vendimin nr. 10121/1, datë 31.12.2024.

- Referuar të dhënave të përcjella nga shoqëria, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar për blerjen e energjisë elektrike për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2025 do të jetë 12.00 lekë/kwh.

- Në vijim, mbështetur në “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë

4.12.2017, të ndryshuar, paraqesim përllogaritjen e kryer për përcaktimin e çmimit FMF për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV. Komponentët e marrë në konsideratë janë:

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027 e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027” prej 0.85 lekësh/kwh.

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV**, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 3.99 lekë/kwh.

- **Kostot administrative**, prej 1.06 lekësh/kwh.

- **Kthimi për riskun prej 3%** (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën 0.36 lekë/kwh për kategorinë e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

- Në zbatim të metodologjisë së sipërcituar, si dhe bazuar në të dhënat e aplikimit, nga përllogaritja e kryer nga ERE rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV është si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr + CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	18.26

- Mbështetur në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimet e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025 do të jetë 18.26 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 1.1.2025–31.12.2025, prej



18.26 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Çdo ndryshim në elementet përbërëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 40, datë 14.2.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EB ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 191/5 prot., datë 12.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EB

Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EB Energy” sh.p.k., me *email*-in e datës 31.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 2659 prot., datë 31.12.2024, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, në format elektronik për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier. Ky dokumentacion është depozituar fizikisht, në përputhje me kërkesat e rregullores në protokollin e ERE-s, më datë 6.1.2025.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 19, datë 20.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EB Energy” sh.p.k., në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 21.1.2025 dhe 22.1.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.1.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 191/2 prot., datë 23.1.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Me shkresën nr. 191/3 prot., datë 23.1.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës, duke i kërkuar, gjithashtu, që të bëjë me dije në rast se nga ana e MIE-s ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së depozituar në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “EB Energy” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga MIE deri në këtë vendimmarrje nuk ka pasur përgjigje.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 191/4 prot., datë 31.1.2025.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas



përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “EB Energy” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 1952 rep., nr. 1263 kol., datë 6.4.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 5595/3 prot., datë 6.9.2024;

- Ka depozituar vendimin për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 18.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit PV Fier EB Energy”, me fuqi të instaluar 2 mw.

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 1952 rep., nr. 1263 kol., datë 6.4.2023, përcaktohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë ripërtëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, dhe të dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të këtij aplikimi, rezulton se shoqëria duhet të vendosë në operim hidrocentralin brenda datës 5.12.2025. Gjithashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kësaj kontrate, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme, deri më datë 18.7.2026, por duke qenë se në referencë të përcaktimeve të kontratës me MIE-n, shoqëria duhet të vendosë në operim centralin brenda datës 5.12.2025, e po ashtu duke marrë në konsideratë një afat 3-mujor që nevojitet për ndërtimin e centralit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve brenda muajit shtator të vitit 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EB Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda muajit shtator 2025.

3. Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 5.12.2025.

4. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të plotësimit të pikave 2 dhe 3, të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “EB Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 42, datë 14.2.2025

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË
ERE-s PËR VENDOSJEN E KUOTAVE
TË SHOQËRISË “KALISI
HYDROPOWER” SHPK SI MJET PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË
TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1114/2 prot., datë 13.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj ‘Raiffeisen Bank’ sh.a.”

konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1” dhe “Veleshica 2”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 212/4 prot., datë 8.3.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën për dhënie e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

- ERE ka kërkuar nga shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. plotësimin e dokumentacionit dhe sqarime mbi statusin e kuotave dhe kredinë bankare. Shoqëria ka depozituar dokumente shtesë,

por nuk ka dhënë përgjigje të plotë mbi kredinë, duke çuar në organizimin e një seance dëgjimore më 18.11.2024 me “Raiffeisen Bank”.

- Pas seancës, banka ka konfirmuar financimin e projektit për HEC “Veleshica” 1 dhe 2 me dy kredi (2020 dhe 2023), të siguruara me marrëveshje siguruese. Meqë të dyja marrëveshjet janë për të njëjtin qëllim dhe bankën si kredidhënës dhe barrëmarrës, kërkohet miratimi nga ERE për të dy marrëveshjet meqënëse bëhet fjalë për të njëjtin projekt.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria ka shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratat datë 26.8.2020 dhe 22.7.2023).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron



shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 43, datë 14.2.2025

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 241, DATË 15.11.2024, “MBI
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË
PUBLIKIMIT TË OFERTAVE TË
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE
NGA TË LICENCUARIT NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT NË
TREGUN E LIRË”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; dhe të neneve 44 dhe 144 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16, pika 2, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.

96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore me nr. 121/3 prot., datë 12.2.2025, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 15.11.2024, “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GEN-I Tiranë” sh.p.k., nëpërmjet shkresës me nr. 2052/8 prot., datë 10.12.2024, ka paraqitur në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 241, datë 15.11.2024, të Bordit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 18, datë 16.1.2025, “Mbi kërkesën e shoqërisë “GEN-I Tiranë” sh.p.k. Për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024”, ka vendosur: 1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “GEN-I Tiranë” sh.p.k., “Për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s”, nr. 241, datë 15.11.2024. 2. Fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ndryshimit të pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024, si më poshtë vijon: - pika 1 propozohet të bëhet: “Vendos detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike për familjet dhe mikrondërmarrjet me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kwh nga të licencuarit, të cilët janë të angazhuar aktivisht në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë në Platformën e Krahasimit të Çmimeve të krijuar nga ERE (PCT)”.

- ERE, nëpërmjet shkresës me nr. 121/2 prot., datë 20.1.2025, ka njoftuar palët e interesit për vendimin nr. 18/2025, si dhe organizimin e një seance dëgjimore në datën 29.1.2025, me qëllim diskutimin në lidhje me propozimet e ngritura nga shoqëria “GEN-I Tiranë” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024, “Mbi vendosjen e detyrimit të publikimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit në tregun e lirë”.

- Palët e pranishme në seancën dëgjimore ranë dakord se të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e tyre kanë detyrimin për të publikuar ofertat e tyre në platformën PCT, me qëllim rritjen e transparencës së tregut dhe përmirësimin e përvojës së konsumatorit në tregun e lirë të



energjisë. Shoqëria “GEN-I Tërana” sh.p.k. deklaroi se nuk ka asnjë pengesë apo kundërshtim për paraqitjen e ofertave në PCT, por theksoi se propozimi për ndryshimin e vendimit të ERE-s synon përafrimin me praktikën më të mirë të disa vendeve evropiane. Të njëjtën qëndrim mbajtën dhe shoqëria GSA sh.p.k. dhe Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES).

- Më datë 10.1.2025, ERE ka kërkuar përmes *e-mail*-it marrjen e opinionit nga Shoqata Rajonale e Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) mbi përvojën e vendeve anëtare të saj, lidhur me praktikën ligjore për përjashtimin nga detyrimi për publikimin e ofertave në PCT për furnizuesit që ofrojnë energji për klientët e lidhur në nivelin e tensionit të lartë.

- Sipas ERRA-së, publikimi i ofertave në Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT) është një e drejtë për konsumatorët fundorë, por mund të jetë e ndërlikuar për publikimin e ofertave për klientët e lidhur në nivelin e tensionit të lartë. Për këtë arsye, neni 14 i direktivës (EU) 2019/944 kufizon detyrimin për ofrimin e aksesit falas në mjetet e krahasimit të çmimeve për shtetet anëtare vetëm për konsumatorët që konsumojnë deri në 100 mwh/vit. Gjithashtu, ERRA evidentoi se rregullatori ka të drejtën të vendosë detyrimin për publikimin e ofertave nga të gjithë furnizuesit, përfshirë ata që furnizojnë konsumatorë të lidhur në nivelin e tensionit të lartë.

- Përafrimi i praktikave legislative në Republikën e Shqipërisë me ato të disa vendeve evropiane, ku furnizuesit që ofrojnë shërbim për konsumatorët e lidhur në nivelin e mesëm dhe të lartë të tensionit nuk kanë detyrimin për të publikuar ofertat e tyre, nuk cenon as funksionimin e tregut, as transparencën dhe as parimin e barazisë.

- Vlerësojmë të nevojshme që kjo vendimarrje të plotësohet duke përcaktuar një dallim mes furnizuesve aktivë dhe atyre joaktivë në lidhje me detyrimin për publikimin e ofertave të energjisë elektrike. Një furnizues aktiv duhet të konsiderohet çdo shoqëri e licencuar në këtë aktivitet, e cila ofron shërbime të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët, si biznese apo familje, dhe është aktivisht e angazhuar në tregun e energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241, datë 15.11.2024, ndryshon dhe bëhet: “Vendos detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike në Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT), të krijuar nga ERE, për të licencuarit, që janë aktivisht të angazhuar në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë, për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë të vegjël me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kwh”.

2. Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë shoqërinë “GEN-I Tërana” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 113/9, datë 6.3.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ajencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, shëtitëria Drilon–Tushemisht”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.



Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në

Bashkinë Pogradec, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimit.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,674,162.48 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë e dyzet e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT SHËTTTORJA DRILON–TUSHEMISHT”

Nr.	PRONARI										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						VLERA TOTALE (leke)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasuritë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z. kadastrele	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Shpërndajta totale	Tnall (m²)	Ndërtësi	Volumi	Faqe	Shpërndajta (m²)	Cmimi (leke/m²)	Vlera (leke)	Shpërndajta (m²)	Cmimi (leke/m²)	Vlera (leke)	
1	Kristaq	Çaq	Mullan	3664	Nr. 4/88	Are	750.00	0.00	0.00	6.00	179.00	33.00	192.00	6,336.00			6,336.00	
2	“RES-HOT L&G” SHPK			3664	Nr. 4/83	Tnall	600.00		0.00	6.00	81.00			28.00	1,640.00	45,920.00	45,920.00	
3	“RES-HOT L&G” SHPK			3664	Nr. 4/54	Tnall	1300.00	1300.00		4.00	82.00			85.70	1,640.00	140,548.00	140,548.00	
4	“RES-HOT L&G” SHPK			3664	Nr. 4/77	Tnall	1012.00	1012.00		5.00	88.00			8.00	1,640.00	13,120.00	13,120.00	
5	“RES-HOT L&G” SHPK			3664	Nr. 4/85	Are	500.00	0.00		6.00	85.00	24.10	192.00	4,627.20			4,627.20	
6	HOTEL GREEN GARDEN			3664	Nr. 4/86	Tnall	500.00			6.00	86.00			25.80	1,640.00	39,032.00	39,032.00	
7	HOTEL GREEN GARDEN			3664	Nr. 4/75	Tnall	1000.00	1000.00		7.00	89.00			39.10	1,640.00	64,124.00	64,124.00	
8	HOTEL GREEN GARDEN			3664	Nr. 4/6	Tnall	984.00			2.00	210.00			30.90	1,640.00	50,676.00	50,676.00	
9	HOTEL GREEN GARDEN			3664	Nr. 4/7	Tnall	993.00			1.00	175.00			14.30	1,640.00	23,452.00	23,452.00	
10	BREGU			3664	Nr. 4/81	Tnall	2905.00	2905.00	1059.00	5.00	186.00			101.40	1,640.00	166,296.00	166,296.00	E-Leje ndërtimi nr. 9/2, datë 20.4.2011. Objekt: Kompleks turistik, bar-restorant, hotel 4 kate + 1 kat parkim nëntokë. Kati i nëntokës s=1214 m²; kati i parës s=1059 m²; kati i parës s=1207 m²; kati i dytës s=1183 m²; kati i tretës s=1183 m²; kati i katër s=946 m² shitesë kati në objekt turistik eksistues, s e kati të katër s=316 m² (barrë), s e kati pesë s=868 m².
11	Ina 2024			3664	Nr. 4/87	Tnall	3213.00	3213.00	1123.00	6.00	87.00			165.00	1,640.00	270,600.00	270,600.00	E-Lloji informacioni: Të tjera. Emërtimi i aktit: Informacion mbi posedimin e pronës nr. 0793, datë 19.12.2016. Regjistruar: nr. 0793, datë 19.12.2016. Përshkrimi: - Cert. përdorimi, vendim nr. 516, datë 7.10.2016. Vendim KRRT, Kom. Bujqësis nr. 10/1, datë 14.5.2010. Objekt: Kompleks Turistik 4 kate +1 kat parkim nëntokë. 1. Sip. e kat. nëntokë = 1446 m². 2. Sip. e k. përdhës 1123+415.4, 3. Sip. e k. të parës = 1358 m². 4. Sip. e k. të dytës = 1322 m². 5. Sip. e k. të tretës = 1330 m².
12	“Mars” shp.k., “Harizi Konstruktion” shp.k., Risto Gohani			3664	Nr. 4/82	Tnall	4765.00	4765.00	1728.00	5.00	195.00			131.40	1,640.00	215,496.00	215,496.00	E-Përshkrimi: Leje ndërtimi nr. 26/3, datë 29.10.2010, leje ndërtimi nr. 11/17, datë 26.9.2011, për objektin ngjirje kati në një seksion të objektit eksistues “Residence turistike dhe shërbime: 4 kate + 1 kat nëntokë: kati nëntokë = 2703 m²; kati përdhës = 1728 m²; kati i parës, shk. 1=535.82 m², shk. 2 + shk. 3 = 829 m², shk. 4 = 535.82 m², kati i tretës, shk. 1 = 535.82 m², shk. 2 + shk. 3 = 829 m², shk. 4 = 535.82 m², kati i katër, shk. 2 + shk. 3 = 829 m².
13	Vasil	Koco	Ilakmani	3664	Nr. 4/20	Tnall	883.00	883.00		2.00	134.00			19.60	1,640.00	32,144.00	32,144.00	G- nr. regjistrimi 1340, datë 15.11.2022. Emërtimi: Mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar nr. 4/100-nd. vol. 7, f. 121.
14	Efimi	Lia	Ilakmani	3664	Nr. 4/21	Are	543.00			2.00	88.00	19.00	192.00	3,648.00			3,648.00	
15	Arian	Gjergj	Mihili	3664	Nr. 4/22	Are	1095.00			1.00	88.00	22.10	192.00	4,243.20			4,243.20	
16	Aurel	Recep	Dikellan	3664	Nr. 4/71	Are	989.00			5.00	65.00	13.50	192.00	2,592.00			2,592.00	
17	Mankela	Përram	Dikellan	3664	Nr. 4/64	Are	1012.00			5.00	31.00	30.70	192.00	5,894.40			5,894.40	E-Përshkrimi: Sipas urdhrit ASHK Pogradec u bë aktive pasuria nr. urdhri 245 datë 29.8.2024.
18	Nesti	Piro	Mihili	3664	Nr. 4/25	Are	846.00			1.00	100.00	29.10	192.00	5,587.20			5,587.20	
19	Zisi	Llazi	Tasellari	3664	Nr. 4/26	Are	740.00			1.00	35.00	23.00	192.00	4,416.00			4,416.00	
20	Engjell	Shaban	Shaban	3664	Nr. 4/89	Are	685.00			6.00	193.00	30.79	192.00	5,911.68			5,911.68	
21	Bip	Vangel	Turshinka	3664	Nr. 4/28	Are	772.00			2.00	174.00	23.00	192.00	4,416.00			4,416.00	E-Lloji i informacionit: Të tjera. Emërtimi i aktit: Akti të tjera sipas legjislacionit në fuqi, nr. 0654, datë 18.7.2013. Regjistruar: nr. 0654, datë 18.7.2013. Përshkrimi: Rrëzuesim pasurie datë 18.7.2013. Ref. 0654, vlera 154,400 lekë
22	Dhamir	Vangel	Turshinka															
	Nastase	Vangel	Turshinka															
23	Todi	Tushi	Ilakmani	3664	Nr. 4/29	Are	820.00			2.00	94.00	22.00	192.00	4,224.00			4,224.00	E-Përshkrimi: Pronar Todi Tushi Ilakmani, F; në mungesë të ID-së u bë shënimet të përshkrimit i veçantë.
24	Llazi	Kopi	Turshinka	3664	Nr. 4/30	Are	814.00			2.00	168.00	19.60	192.00	3,763.20			3,763.20	
25	Lajeta	Feja	Seita	3664	Nr. 4/31	Are	1052.00			1.00	203.00	27.45	192.00	5,270.40			5,270.40	E-Përshkrimi: në mungesë të ID-së u bë shënimet Llazi Kopi Turshinka.
26	Dorian	Fahri	Hoxhallari	3664	Nr. 4/58	Are	1007.00			4.00	214.00	22.70	192.00	4,358.40			4,358.40	
27	Thoma	Kopi	Turshinka	3664	Nr. 4/33	Are	1156.00			2.00	202.00	23.00	192.00	4,416.00			4,416.00	E-Përshkrimi: Pronar Thoma Kopi Turshinka, F; sipas KPP fakte, u bë shënimet të përshkrimit i veçantë në mungesë të ID-së
28	Bashkim	Kapllan	Ganoli	3664	Nr. 4/52	Tnall	500.00	500.00	100.00	4.00	118.00			28.40	1,640.00	46,576.00	46,576.00	E-Përshkrimi: Në mungesë të ID-së u bë shënimet të përshkrimit i veçantë, bashkëpronar Bashkim Kapllan Ganoli dhe Kasrat Kapllan Ganoli.
29	Kastriot	Kapllan	Ganoli	3664	Nr. 4/35	Are	820.00			2.00	229.00	10.80	192.00	2,073.60			2,073.60	E-Përshkrimi: Sipas urdhrit të DVASHK Pogradec, u bë aktive pasuria nr. urdhri 430, datë 16.10.2023.
30	Pandeli	Kristaq	Bardhi	3664	Nr. 4/36	Are	2017.00			1.00	203.00	106.30	192.00	20,409.60			20,409.60	
31	Simon	Vangel	Shyta	3664	Nr. 4/37	Are	776.00			1.00	110.00	64.20	192.00	12,326.40			12,326.40	E-Përshkrimi: Pronar Thoma Mite Mithan mbi ka ID.
32	Ilie	Vangel	Shyta	3664	Nr. 4/38	Are	679.00			1.00	168.00	54.90	192.00	10,540.80			10,540.80	E-Përshkrimi: Bashkëpronar Policeni Nikolla Kapobardhi, Nikoleta Stasi Kapobardhi, Konstandin Stasi Kapobardhi, Klli Stasi Kapobardhi, B; në mungesë të ID-së u bë shënimet të përshkrimit i veçantë.
33	Nikoleta	Nikolla	Kapobardhi	3664	Nr. 4/39	Are	202.00			1.00	167.00	19.00	192.00	3,648.00			3,648.00	E-Përshkrimi: Bashkëpronarët e pasurisë Policeni Nikolla Kapobardhi, Nikoleta Stasi Kapobardhi, Konstandin Stasi Kapobardhi, Klli Stasi Kapobardhi, B; në mungesë të ID-së u bë shënimet të përshkrimit i veçantë.
34	Nikoleta	Nikolla	Kapobardhi	3664	Nr. 4/40	Are	616.00			2.00	202.00	52.90	192.00	10,156.80			10,156.80	
35	Konstandin	Stasi	Kapobardhi	3664	Nr. 4/79	Are	912.00			5.00	108.00	36.80	192.00	7,065.60			7,065.60	
36	Klin	Stasi	Kapobardhi	3664	Nr. 15/21	Tnall	300.00	300.00	54.00	6.00	185.00			35.20	1,640.00	57,728.00	57,728.00	E-Përshkrimi: Bashkëpronarët e pasurisë Stasi Ligor Tasellari, Anërie Nazif Tasellari, Ervin Stasi Tasellari, B; në mungesë të ID-së u bë shënimet të përshkrimit i veçantë.
37	Alban	Gezim	Zeka	3664	Nr. 15/3	Tnall	232.00	232.00	61.00	3.00	80.00			18.30	1,640.00	30,012.00	30,012.00	
38	Mimela	Ardije	Kaçoni	3664	Nr. 15/24	Tnall	300.00	300.00	118.00	6.00	240.00			31.20	1,640.00	51,168.00	51,168.00	
39	Vjollanda	Iovan	Kaçoni															
40	Dorian	Mimela	Kaçoni															
41	Pandeli	Nasi	Terezu	3664	Nr. 15/5	Tnall	331.00	331.00		3.00	82.00			25.50	1,640.00	41,820.00	41,820.00	E-Përshkrimi: Sipas kartelës fizike pronar i pasurisë është Pandeli Nas Terezu, F; në mungesë të ID-së u bë shënimet të përshkrimit i veçantë.



39	Vasil	Ilija	Terezi	3664	Nr. 15/6	Tfuall	239.00	239.00	59.00	3.00	83.00			-	13.20	1,640.00	21,648.00	21,648.00	E-Pershkrimi: Përfuttes për herë të parë brenda familjes me kontratë dhurimi nr. 3223 rep. nr. 1739 kol., datë 30.10.2020, sipas udhëzimit të Min. së Financave nr. 15, datë 3.4.2020.
40	Dhimitër	Thoma	Llakmani	3664	Nr. 15/7	Tfuall	300.00	300.00	113.00	3.00	177.00			-	25.80	1,640.00	42,512.00	42,512.00	
41	Rajmonda	Vangel	Pendavimp	3664	Nr. 15/8	Tfuall	300.00	300.00	113.00	3.00	179.00			-	20.90	1,640.00	34,276.00	34,276.00	
	Evelina		Kove																
	Ivana	Vangel	Shylla																
	Albana	Vangel	Gusho																
	Leonard	Vangel	Llakmani																
42	Vasil	Koco	Llakmani	3664	Nr. 15/9	Tfuall	183.00	183.00	80.00	3.00	84.00			-	13.70	1,640.00	22,468.00	22,468.00	E-Pershkrimi: Pronari i pasurisë Vasil Koco Llakmani, F; në mungesë të ID-së u bë shënim në përshkrimin e veçantë.
43	Giorgi	Koco	Llakmani	3664	Nr. 15/10	Tfuall	248.00	248.00	80.00	3.00	85.00			-	16.00	1,640.00	26,240.00	26,240.00	
44	Kopi	Koco	Llakmani	3664	Nr. 15/19	Tfuall	283.00	283.00	56.00	5.00	283.00			-	11.65	1,640.00	19,106.00	19,106.00	Sipas kartelës së pasurisë të datës 12.2.2025, Kodi Unik 3664005077.
45	Rolandi	Sotir	Llakmani	3664	Nr. 15/20	Tfuall	255.00	255.00	36.00	5.00	78.00			-	14.90	1,640.00	24,436.00	24,436.00	
46	Sotir	Tushi	Llakmani	3664	Nr. 17/4	Tfuall	922.00	922.00		4.00	158.00			-	36.00	1,640.00	59,040.00	59,040.00	E-Pershkrimi: Bashkëpronarët e pasurisë Sotir Tushi Llakmani 1/4, Vasil Tushi Llakmani 1/4, Vangel Tushi Llakmani 1/4, Elivert Naum Llakmani 1/12, Roza Jovan Llakmani 1/12, Pandi Llakmani 1/12; në mungesë të ID-së u bë shënim në përshkrimin e veçantë. Ka shënimin kujdes të përshkrimi i veçantë i kartelës fizike.
	Vasil	Tushi	Llakmani																
	Vangel	Tushi	Llakmani																
	Elivert	Naum	Llakmani																
	Roza	Jovan	Llakmani																
	Pandi		Llakmani																
SHUMA PARAPRAKE												-		135,924.48		-	1,538,238.00	1,674,162.48	

**KËRKESË**

Shtetasi Petrit Mulla kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Raik Mulla, i datëlindjes 9.12.1964, duke caktuar si datë zhdukjeje datën 17.12.1995, si dhe caktimin e tij si kujdestar për administrimin e pasurisë së shtetasit Arben Mulla.

KËRKUES
Petrit Mulla

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 400 lekë